



BANKA QENDRORE E REPUBLIKES SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 18

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 18

Janar-Dhjetor 2021

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Departamenti i Analizave Ekonomike dhe i Stabilitetit Financiar
33 Garibaldi, Prishtinë 10000
Tel: +383 38 222 055
Fax: +383 38 243 763

Faqja e internetit

www.bqk-kos.org

Adresa elektronike

economic.analysis@bqk-kos.org

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

SHKURTESAT:

AJN	Asetet e Jashtme Neto
APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATM	Bankomatë (anglisht: Automated Teller Machines)
ATP	Agjensionet për Transferimin e Parave
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CIS	Commonwealth of Independent States
DST	Të Drejtat Speciale të Tirazhit
EJL	Evropa Juglindore
EQL	Evropa Qendrore dhe Lindore
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
FKGK	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikro-Financiare
ISSB	Indeksi i Stabilitetit të Sektorit Bankar
KJP	Kreditë jo-performuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
KNK	Kthimi në Kapital
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MeF	Ministria e Financave
MNI	Margjina Neto e Interesit
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
OJSHEF	Organizatata Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
POS	Pika të Shitjes (anglisht: Point of Sales)
pp	Pikë Përqindje
PPT	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë
PTK	Posta dhe Telekomit i Kosovës
RLI	Indeksi i Sundimit të Ligjit (angl.: Rule of Law Index)
TMK	Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Vërejtje:

Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2022),
Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 18, Prishtinë.
Çdo korrigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

PËRMBAJTJA:

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit -----	11
2. Përmbledhja e rreziqeve dhe zhvillimeve kryesore të stabilitetit financiar-----	13
Kutia 1. Harta e Stabilitetit Financiar -----	23
3. Mjedisi i jashtëm dhe zhvillimet në ekonominë e brendshme -----	25
3.1. Ekonomia e brendshme-----	26
Kutia 2. Ndikimi i luftës në Ukrainë në aktivitetin ekonomik të Kosovës sipas skenarit bazë dhe dy skenarëve alternativë -----	28
3.2. Pozicioni financiar i ndërmarrjeve -----	31
3.3. Pozicioni financiar i ekonomive familjare -----	34
Kutia 3. Ngarkesa me Borxh e Ekonomive Familjare në Kosovë -----	36
4. Zhvillimet në sistemin financiar -----	42
4.1. Aktiviteti bankar -----	45
Kutia 4. Anketa e Kreditimit Bankar -----	50
5. Rreziqet e sektorit bankar -----	55
5.1. Rreziku kreditor -----	56
5.2. Qëndrueshmëria e profitit dhe rreziku i normave të interesit -----	61
5.3. Rreziku nga pozicioni në valuta të huaja -----	65
5.4. Kapitali-----	65
5.5. Financimi dhe Rreziku i Likuiditetit -----	68
5.6. Kapacitetit absorbues i goditjeve - analiza Stress-Test-----	73
Kutia 5. Ndryshimet klimatike dhe rëndësia e tyre në stabilitetin financiar -----	80
6. Institucionet financiare jo-bankare -----	86
6.1 Sektori Pensional-----	86
6.2 Sektori i Sigurimeve-----	88
6.3. Sektori mikrofinanciar dhe ndihmësit financiar -----	93
7. Infrastruktura financiare në Kosovë-----	98
7.1. Sistemi i pagesave -----	98
8. Korniza për Makroprudencë -----	101
9. Shtojca Statistikore -----	104

LISTA E GRAFIKËVE DHE FIGURAVE

Grafik 1. Indekset e çmimeve të ndërtimit, prodhimit dhe inputeve bujqësore -----	16
Grafik 2. Borxhi i ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare -----	17
Grafik 3. Ndryshimi vjetor i kredive të reja -----	18
Grafik 4. Tregues të përzgjedhur të shëndetit financiar -----	19
Grafik 5. Harta e stabilitetit financiar -----	23
Grafik 6. Harta e stabilitetit financiar -----	24
Grafik 7. Norma e rritjes së BPV-së reale dhe kontribuesit në rritje -----	26
Grafik 8. Indekset e shitjeve dhe të punësuarëve në sektorin e shërbimeve -----	26
Grafik 9. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor -----	27
Grafik 10. Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial -----	31
Grafik 11. Indeksi i qarkullimit në tregtinë me pakicë -----	31
Grafik 12. Ndryshimi vjetor në numrin e ndërmarrjeve të reja -----	32
Grafik 13. Borxhi i ndërmarrjeve -----	32
Grafik 14. Kreditë e aprovuara dhe të garantuara nga FKGK -----	33
Grafik 15. Normat e interesit për ndërmarrjet -----	33
Grafik 16. Borxhi i ekonomive familjare -----	33
Grafik 17. Depozitat e ekonomive familjare -----	34
Grafik 18. Normat e interesit për ekonomitë familjare -----	34
Grafik 19. Peshat e sektorëve të sistemit financiar ndaj BPV-së -----	42
Grafik 20. Pjesëmarrja në gjithsej asetet e sistemit financiar -----	42
Grafik 21. Pronësia e sektorëve përbërës të sistemit financiar -----	43
Grafik 22. Pjesëmarrja në strukturën e asetëve -----	46
Grafik 23. Pjesëmarrja në strukturën e detyrimeve dhe burimeve vetanake -----	46
Grafik 24. Stoku i gjithsej depozitave dhe depozitave të reja -----	46
Grafik 25. Pozicioni neto ndaj jo-rezidentëve -----	47
Grafik 26. Kontributi i zërave në ndryshimin vjetor të aktiviteteve me jorezidentët -----	47
Grafik 27. Rritja vjetore e kredive për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare -----	48
Grafik 28. Stoku i gjithsej kredive dhe kredive të reja për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare -----	48
Grafik 29. Stoku i kredive sipas sektorëve të ekonomisë -----	48
Grafik 30. Kreditë e aprovuara dhe të garantuara në FKGK -----	49
Grafik 31. Kreditë e ndërmarrjeve, pjesëmarrja sipas maturitetit -----	49
Grafik 32. Kreditë e ekonomive familjare, pjesëmarrja sipas maturitetit -----	49
Grafik 33. Indeksi i agreguar i stabilitetit të sektorit bankar -----	55
Grafik 34. Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar, sipas kriterëve të rreziqeve -----	56
Grafik 35. Rritja vjetore e kredive dhe kredive jo-performuese -----	57
Grafik 36. Kreditë e ristrukturuara, sipas kategorive -----	58
Grafik 37. Kreditë sipas klasifikimit të ri kreditor në tri shtylla -----	58
Grafik 38. Struktura e kredive sipas klasifikimit të vonesave -----	58
Grafik 39. Kreditë joperformuese -----	59

Grafik 40. Raporti i KJP-ve ndaj stokut të kredisë, sipas sektorëve-----	59
Grafik 41. Pjesëmarrja e kredive të ristrukturuara ndaj gjithsej kredive në sektorët pëkratës ---	60
Grafik 42. Raporti KJP/gjithsej kreditë në vende të rajonit -----	60
Grafik 43. Ndryshimi vjetor i stokut të KJP-ve dhe mbulueshmëria me provizione -----	60
Grafik 44. Koncentrimi i rrezikut kreditor -----	61
Grafik 45. Struktura e profitit të sektorit bankar -----	62
Grafik 46. Kontribuuesit kryesor në rritjen/zvogëlimin e profitit -----	62
Grafik 47. Të hyrat dhe shpenzimet e interesit -----	62
Grafik 48. Të hyrat dhe shpenzimet e jo-interesit -----	62
Grafik 49. Struktura e të hyrave të sektorit bankar -----	63
Grafik 50. Struktura e shpenzimeve të sektorit bankar -----	63
Grafik 51. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	63
Grafik 52. Asetet dhe detyrimet e ndjeshme ndaj normave të interesit -----	64
Grafik 53. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë -----	65
Grafik 54. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj -----	65
Grafik 55. Kapitalizimi i sektorit bankar -----	66
Grafik 56. Kontributi i Kapitalit Rregullator dhe APR-ve në Raportin e Kapitalizimit -----	66
Grafik 57. Struktura e kapitalit rregullator -----	66
Grafik 58. Norma e levës -----	67
Grafik 59. Raporti i APR-ve ndaj gjithsej asetëve të sektorit -----	67
Grafik 60. Asetet e peshuara me rrezik kreditor -----	68
Grafik 61. Klasat e asetëve sipas peshës së rrezikut -----	68
Grafik 62. Struktura e APR-ve për rrezik kreditor -----	68
Grafik 63. Struktura e financimit -----	69
Grafik 64. Rritja e kredive dhe depozitave të sektorit bankar -----	69
Grafik 65. Struktura e depozitave -----	70
Grafik 66. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit -----	70
Grafik 67. Struktura e afateve të maturimit të depozitave dhe kredive -----	71
Grafik 68. Indikatorët e likuiditetit -----	71
Grafik 69. Rezervat e likuiditetit -----	72
Grafik 70. Hendeku i likuiditetit -----	73
Grafik 71. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit -----	75
Grafik 72. Rezultatet e stres testit për rrezikun kreditor-humbjet dhe rikapitalizimi -----	76
Grafik 73. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit -skenari 1 -----	79
Grafik 74. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit -skenari 2 -----	79
Grafik 75. Asetet e sektorit pensional -----	86
Grafik 76. Struktura e investimeve të sektorit pensional -----	86
Grafik 77. Kontributet e arkëtuara sipas fondeve pensionale -----	87
Grafik 78. Performanca financiare e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës -----	87
Grafik 79. Performanca financiare e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve -----	87

Grafik 80. Indikatorët e zhvillimit të sektorit të sigurimeve-----	88
Grafik 81. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve, sipas pronësisë -----	88
Grafik 82. Asetet e sektorit të sigurimeve-----	89
Grafik 83. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve -----	89
Grafik 84. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve -----	90
Grafik 85. Primet bruto të arkëtuara -----	90
Grafik 86. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara-----	91
Grafik 87. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	93
Grafik 88. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar -----	93
Grafik 89. Kreditë e sektorëve ekonomik sipas maturitetit -----	94
Grafik 90. Struktura e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve ekonomik -----	94
Grafik 91. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj korporatave jofinanciare-----	94
Grafik 92. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar-----	95
Grafik 93. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	95
Grafik 94. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik-----	95
Grafik 95. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	96
Grafik 96. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar-----	96
Grafik 97. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditorë -----	96
Grafik 98. Kapitali shtesë kundër-ciklik -----	102
Grafik 99. Shkalla e rëndësisë sistemike dhe alokimi i kapitalit shtesë 1 -----	103
Figura 1. Ndërlidhjet institucionale të Sistemit Financiar të Kosovës-----	44
Figura 2 . Ndërlidhjet bankare të sektorit bankar të Kosovës-----	45

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Rreziqet kryesore dhe qëndrueshmëria e sektorit bankar -----	15
Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomikë -----	25
Tabela 3. Borxhi ndaj bankave dhe performanca e ekonomive familjare -----	35
Tabela 4. Numri i institucioneve financiare -----	43
Tabela 5. Supozimet për skenarët e rrezikut kreditor-----	77
Tabela 6. Koeficienti i elasticitetit të normës së KJP-ve -----	78
Tabela 7. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik kreditor -----	78
Tabela 8. Supozimet për skenarët e rrezikut të likuiditetit-----	79
Tabela 9. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik të likuiditetit-----	80
Tabela 10. Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit -----	91
Tabela 11. Dëmet e paguara, sipas klasave të biznesit -----	91
Tabela 12. Rezultati financiar -----	93
Tabela 13. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SPN-së-----	99
Tabela 14. Rrjeti i sektorit bankar -----	99
Tabela 15. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela-----	100
Tabela 16. Objektivat, indikatorët vlerësues të rrezikut sistemik dhe instrumentet e politikës makroprudenciale -----	101

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) i prezanton publikut numrin e 18-të të Raportit të Stabilitetit Financiar (RSF). Përmes një perspektive të analizës së bazuar në rrezik, RSF synon të informoj publikun mbi gjendjen e sistemit financiar dhe të rrisë transparencën e nxisë debatin profesional mbi zhvillimet dhe sfidat e sistemit financiar dhe infrastrukturës së tij.

Dinamikat pozitive që e karakterizuan ekonominë globale në vitin 2021 me përmirësimin e gjendjes pandemike dhe hapjen e ekonomive, u përmbysen në muajt e parë të vitit 2022 me shpërthimin e luftës në Ukrainë. Në vitin 2021, eurozona dhe Ballkani Perendimor u rikuperuan nga pasojat pandemike, megjithë problemet e mbetura në zinxhirët e furnizimit si pasojë e pandemisë. Rritja e shpejtë e kërkesës së përgjithshme, mbështetur nga politikat mbështetëse fiskale dhe monetare, u përballë me ofertë më të frenuar kryesisht si pasojë e problemeve të mbetura në zingjirët e furnizimit dhe rritjes së kostove të energjisë dhe mallrave. Këto dinamika, plotësuar me rritjen e ndjeshme të rreziqeve me fillimin e luftës në Ukrainë në shkurt të vitit 2022, kanë krijuar pasiguri të larta për prospektet makroekonomike në vitet në vijim. Lufta në Ukrainë përkeqësoi presionet inflacioniste duke ndikuar në rritjen e mëtejme të çmimeve (energjisë, naftës dhe ushqimit), thellimin e problemeve në tregti (ofertë) dhe rënien e besueshmërisë së konsumatorëve. Për pasojë, parashikimet e indikatorëve kryesor makroekonomik për vitin 2022 janë rishikuar për poshtë, si për eurozonën ashtu edhe për Ballkanin Perendimor dhe Kosovën.

Rikuperimi i shpejtë ekonomik në vitin 2021, i ndikuar nga masat mbështetëse financiare e

fiskale dhe veçanërisht, nga mbështetja e paprecedent e diasporës me lirimin e masave për kontroll të pandemisë, rezultoi në rritje të lartë të BPV-së në vend. Megjithatë, ngjashëm me dinamikat në nivel global, rimëkëmbja e ekonomisë nga shoku pandemik dhe rritja e çmimeve në nivel global është përkthyer në presione të larta inflacioniste edhe në Kosovë, veçanërisht në tremujorin e fundit të vitit 2021. Këto presione u përkeqësuan tutje me fillimin e luftës në Ukrainë, përmes ndikimit indirekt në shkallën e inflacionit dhe efektit në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik.

Lufta në Ukrainë, përveç se ndërpreu trendin e shpejtë të rritjes post-pandemike, rriti konsiderueshëm rreziqet e përgjithshme ndaj stabilitetit financiar. Sfidat makroekonomike, me theks të veçantë në sektorë të caktuar, janë rritur për shkak të rritjes së kostos së inputeve dhe rënies së besueshmërisë, faktorë që pritet të reflektohen në rënie të kërkesës së përgjithshme. Shkalla e lartë e inflacionit në vitin 2022 po ndikon në rënien e fuqisë blerëse të ekonomive familjare, me theks të veçantë të atyre me të ardhura më të ulëta. Në rrethana të tilla të inflacionit të lartë, rritjes më të ngadalësuar ekonomike, rritjes së normave të interesit në nivel global si dhe hapësirës më të kufizuar fiskale të mbështetjes së ekonomisë së Kosovës, rreziku kreditor dhe rreziku i likuiditetit të sektorit bankar janë në rritje dhe do të monitorohen më për së afërmi. Përderisa ecuria e këtyre zhvillimeve është duke u shoqëruar me pasiguri të larta, sistemi financiar në Kosovë ka adaptuar qasje prudente të operimit përkitazi me rrethanat, si dhe ka krijuar rezerva të kënaqshme të kapitalit dhe likuiditetit për t'u përballuar me rreziqet e rritura të funksionimit të tij në periudhën në vijim.

Fehmi MEHMETI

Guvernator

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

2. Përmbledhja e rreziqeve dhe zhvillimeve kryesore të stabilitetit financiar

Sistemi financiar përballoi suksesshëm sfidën më të madhe në historinë e funksionimit të tij, të shkaktuar nga kriza pandemike. Si rezultat i përmirësimit të përgjithshëm të situatës pandemike, lehtësimit të masave kufizuese të lëvizjes si dhe masave mbështetëse qeveritare dhe rregullative, ekonomia, respektivisht sistemi financiar në Kosovë shënuan rikuperim të hovshëm në vitin 2021. Sidoqoftë, rritja e çmimeve të energjisë dhe mallrave, e nxitur nga rrethanat e krijuara nga pandemia si dhe shpërthimi i luftës në Ukrainë në vitin 2022 kanë krijuar pasiguri të mëdha për të ardhmen duke rritur ndjeshëm rreziqet e funksionit për ekonominë dhe sektorin financiar për periudhën vijuese. Ekspozimi i drejtpërdrejtë i sistemit financiar të Kosovës ndaj Ukrainës dhe Rusisë është tejet i kufizuar; sidoqoftë, rreziqet nga rrethanat e krijuara pritet të barten në mënyrë indirekte përmes efektit në inflacion, efektit në rritjen e kostos së financimit, si dhe përmes efektit në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik. Përderisa ecuria e këtyre zhvillimeve është duke u shoqëruar me pasiguri të larta, sektori bankar në Kosovë ka adaptuar qasje prudente të operimit përkitazi me rrethanat si dhe ka krijuar rezerva të kënaqshme të kapitalit dhe likuiditetit për t'u përballuar me rreziqet e rritura të funksionimit të tij në periudhën në vijim.

Rikuperimi i shpejtë ekonomik në vitin 2021, i ndikuar nga mbështetja e paprecedent e diasporës dhe masave mbështetëse financiare e fiskale, i dha hov zhvillimeve në sistemin financiar i cili u karakterizua me zgjerim dyshifror të aseteve. Përmirësimi i gjendjes pandemike si dhe lehtësimi i masave kufizuese ndikoi në përmirësimin e performancës së bizneseve, gjë që ndikoi që kualiteti i

përgjithshëm i kredive të mos përkeqësohet përkundër përfundimit të masave rristrukturuese.

Sidoqoftë, shpërthimi i luftës në Ukrainë ndërpreu trendin e shpejtë të rritjes post-pandemike dhe rriti rreziqet e përgjithshme ndaj stabilitetit financiar. Tutje, rreziku kryesor për stabilitetin financiar në Kosovë vjen nga ambienti makroekonomik. Sfidat e operimit për bizneset, me theks të veçantë në sektorë të caktuar, janë rritur për shkak të rritjes së kostos së inputeve por dhe rënies së besueshmërisë që pritet të reflektohet me rënie të kërkesës. Në anën tjetër, inflacioni i lartë në vazhdimësi po ndikon në rënie e fuqisë blerëse të ekonomive familjare, me theks të veçantë të atyre me të ardhura më të ulëta. Në rrethana të tilla të inflacionit të lartë, rritjes më të ngadalësuar ekonomike me mundësi recesioni, rritjes së normave të interesit në nivel global si dhe hapësirës më të kufizuar fiskale të mbështetjes së ekonomisë së Kosovës, rreziku kreditor dhe rreziku i likuiditetit të sektorit bankar janë në rritje dhe kërkojnë monitorim të afërt.

Ambienti makroekonomik i jashtëm shënoi përmirësim në vitin 2021. Ekonomia globale dhe ajo e eurozonës shënoi trend të shpejtë të rikuperimit nga kriza pandemike si rezultat i përmirësimit të gjendjes së pandemisë, lehtësimit të masave kufizuese, dhe politikave mbështetëse fiskale dhe monetare. Eurozona, partneri kryesor tregtar i Kosovës dhe njëkohësisht rajoni me origjinën më të lartë të remitencave, në vitin 2021 shënoi rritje ekonomike prej 5.3 përqind. Sektori privat në eurozonë rezultoi më rezistent se parashikimet, duke u karakterizuar me humbje më të ulëta se vlerësimet fillestare, që njëkohësisht u reflektua në shkallë më të ulët të përkeqësimit të portfolios kreditorë të sektorit financiar. Edhe vendet e Ballkanit Perëndimor shënuan rikuperim të aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2021, me rritje mesatare prej 8.1 përqind sipas vlerësimeve të FMN-së. Sidoqoftë, shenjat e rikuperimit të ekonomisë në eurozonë dhe

Ballkanin Perëndimor u zbehën në tremujorin e fundit të vitit për shkak të përhapjes së variantit të ri të koronavirusit “Omicron”, krizës energjetike dhe problemeve në zinxhirët e furnizimit të nxitura nga pandemia. Këto sfida u thelluan ndjeshëm me fillimin e luftës në Ukrainë, e cila ndikoi në rritjen e mëtejme të çmimeve (energjisë, naftës dhe ushqimit), thellimin e probleme në tregti (ofertë) dhe rënien e besueshmërisë së konsumatorëve. Këto zhvillime pritet të ndikojnë negativisht aktivitetin ekonomik, me efekte indirekte negative edhe në zhvillimet në sistemin financiar.

Ekonomia e Kosovës u karakterizua me rritje të lartë të aktivitetit në vitin 2021, pas rënies më të thellë të shënuar në vitin 2020. Kontributin kryesorë në rritje e kishin rritja rekorde e eksportit dhe kërkesa e brendshme, të ndikuara nga ardhja rekorde e diasporës në vend si rezultat i lehtësimit të masave kufizuese ndaj pandemisë. Megjithatë, gjysma e dytë e vitit 2021 u shoqërua me rritje të presioneve inflacioniste, duke dobësuar perspektivën ekonomike për vitin vijues.

Vlerësimet preliminare të ASK-së sugjerojnë se rritja e BPV-së vjetore ishte 10.5 përqind. Sektorët që shënuan rritjen më të lartë të vlerës së shtuar ishin pikërisht sektorët që u afektuan më së shumti nga masat kufizuese, siç janë hotelet dhe restorantet si dhe transporti dhe magazinimi. Performanca e ekonomisë, përkatësisht sektorit të ndërmarrjeve, tejkaloi dukshëm pritjet, duke reduktuar kështu ndjeshëm materializimin e rreziqeve të pritura në portfolion kreditorë dhe duke ndikuar në rritjen e aktivitet kreditues. Por, rritja e kërkesës së përgjithshme në vend, e veçanërisht dinamikat në çmimet e mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare u reflektuan në presione të shtuara inflacioniste në Kosovë. Të gjitha indekset e çmimeve shënuan rritje. Norma mesatare vjetore e inflacionit, e shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK), u rrit në 3.4 përqind (nga 0.2 përqind në vitin 2020), me trend më të theksuar rritës në muajt e fundit të vitit. Dinamikat që po vazhdojnë të shoqërojnë ekonominë globale dhe çmimet e

mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare, si pasojë e problemeve evidente në anën e ofertës që ndërlidhen me pandeminë, problemet në porte, dështimet/rënia e rendimentit në të korra si pasojë e ndryshimeve klimatike dhe pasojave nga lufta në Ukrainë, sinjalizojnë për presione të shtuara inflacioniste edhe përgjatë gjysmës së dytë të vitit 2022. Sipas skenarit bazë të parashikimeve aktuale të BQK-së, shkalla mesatare e inflacionit pritet të jetë 11.0 përqind në vitin 2022. Ndikimi i luftës së Ukrainës dhe sanksionet ekonomike ndaj Rusisë pritet të reflektohet në rritje të mëtejme të çmimeve të energjisë, naftës dhe ushqimit, me efekte negative në besueshmërinë e konsumatorëve dhe fuqinë blerëse të tyre. Marrë parasysh që lufta në Ukrainë po vazhdon dhe nën supozimin se kriza e shkaktuar gjeopolitike nuk do të përmbyllet shpejtë, probabiliteti i materializimit të skenarëve më të rënduar të indikatorëve makroekonomik është rritur. Nën skenarët më të rënduar, ku shkalla e inflacionit shënon rritje më të lartë se skenari bazë, perspektiva ekonomike për Kosovën do të jetë më pesimiste se pritjet fillestare për rritje ekonomike prej 3.0 përqind në vitin 2022.

Rritja e lartë ekonomike ka ndikuar në rritjen e të hyrave buxhetore dhe përmirësimin e bilancit buxhetor në vitin 2021, përkundër rritjes vjetore të shpenzimeve buxhetore. Borxhi publik, në anën tjetër, shënoi rritje, si rezultat i masave mbështetëse fiskale për rimëkëmbjen nga kriza pandemike. Përderisa përfundimi i pakove mbështetëse të Rimëkëmbjes ekonomike nga pandemia do të lehtësoj barrën buxhetore, realizimi i pakos së Ringjalljes Ekonomike si dhe rrethanat e reja të inflacionit të lartë dhe rritjes së normave të interesit pritet të shtojnë presionin mbi sektorin fiskal në vitin 2022. Deficitit buxhetor në vitin 2021 ishte shumë i ulët, duke rënë në 0.9 përqind të BPV-së nga 7.2 në vitin 2020. Borxhi publik shënoi rritje vjetore prej 13.1 përqind dhe arriti në 23.3 përqind të BPV-së, nga 22.4 përqind sa ishte në vitin 2020. Borxhi publik u financua si nga burimet e brendshme, rritje vjetore prej 15.0 përqind,

ashtu edhe nga burimet e jashtme me rritje prej 9.6 përqind. Dinamikat e sektorit fiskal gjatë vitit vijues pritet të ndikohen nga rritja e lartë e inflacionit, që do të reflektohen si në rënien e të hyrave për shkak të ngadalësimit të aktivitetit ekonomik, ashtu edhe rritjen e shpenzimeve buxhetore për shkak të skemave mbështetëse ndaj qytetarëve më të prekur nga

inflacioni i lartë. Në veçanti, rritja e kostos së energjisë dhe shpenzimeve buxhetore për subvencionimin e tyre do të shtojnë barrën buxhetore. Njëkohësisht, rritja e normave të interesit në nivel global pritet të ndikoj në tkurrjen e likuiditetit dhe rritjen e kostos së financimit të borxhit.

Tabela 1. Rreziqet kryesore dhe qëndrueshmëria e sektorit bankar*

Rreziqet	2019	2020	TM1 2021	TM2 2021	TM3 2021	TM4 2021	Trendi i rrezikut
Rreziqet							
Rreziku makroekonomik							
Rreziku kreditor							
Rreziku në të hyrat (profitabiliteti)							
Qëndrueshmëria e sektorit							
Kapitalizimi							
Likuiditeti dhe financimi							
Qëndrueshmëri e lartë Q. Mesatare Q. e ulët Q. e shumë e ulët Rrezik i ulët Rrezik i mesëm Rrezik mbimesatar Rrezik i lartë							

Burimi: BQK.

*Metodologjia e ndërtimit të tabelës së rrezikut dhe qëndrueshmërisë së sektorit bankar bazohet pjesërisht në metodologjinë e Hartës së Stabilitetit Financiar të Kosovës (sipas së cilës vlera e treguesve kryesorë përkatës notohet në relacion me historikun e tij) si dhe në vlerësimin e gjykimit të analistëve.

Kahja e shigjetës sugjeron për tendencën e rrezikut/qëndrueshmërisë në periudhën e fundit (tremujorin e fundit), si dhe pritjet për zhvillimet në periudhën vijuese një vjeçare

Rritja e lartë e kërkesës në vend në vitin 2021 ndikoi në rritje të importeve dhe zgjerim të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Komponentët të cilët zbutën efektin negativ të rritjes së lartë të importeve ishin eksportet e shërbimeve dhe remitencave, komponentë këto të cilat u karakterizuan me rritjen më të lartë historike.

Përmirësimi i gjendjes pandemike si dhe lehtësimi i masave kufizuese të ndërmarra për të menaxhuar me krizën shëndetësore mundësoi ardhjen e numrit të madh të vizitave të diasporës, pas një periudhe të izolimit gjatë së cilës diaspora ka akumuluar kursime të shtuara. Kjo ndikoi në rritjen rekorde të komponentës së neto eksportit të shërbimeve në 1.1 miliardë euro, përkatësisht 25.0 përqind të vlerës së BPV-së. Remitencat gjithashtu

shënuan rritje të konsiderueshme vjetore prej 17.7 përqind, duke arritur në 14.8 përqind të BPV-së. Flukset hyrëse të remitencave janë karakterizuar me rritje të lartë gjatë gjithë vitit, me përjashtim të tremujorit të fundit kur shënuan një ngadalësim të rritjes. Kontributi i diasporës ishte i lartë gjithashtu në sektorin e investimeve të huaja direkte (IHD-të), përmes blerjes së patundshmërive. Si rezultat, IHD-të në sektorin e patundshmërisë pothuajse dyfishuan pjesëmarrjen në gjithsej IHD-të nga 58.2 përqind në 92.6 përqind në vitin 2021. Sektorët tjerë me kontribut në rritjen vjetore të IHD-vë prej 20.1 përqind ishin sektori i informacionit dhe komunikimit, si dhe ndërtimtarisë.

* Metodologjia e ndërtimit të tabelës së rrezikut bazohet në metodologjinë e Hartës së Stabilitetit Financiar të Kosovës. Ndërtimi i kësaj table përfshinë shtesë treguesin e Zhvillimeve kreditorë dhe atë të Ekspozimeve. Treguesi i Zhvillimeve kreditorë përfshinë nën-treguesit si: Hendeku i kreditimit ndaj BPV-së, Rritja e kreditimit të sektorit privat, Raporti i kreditit të sektorit privat ndaj BPV-së, si dhe rritjen në sektorët e veçantë si ai i ndërmarrjeve dhe atë të ekonomive familjare. Përderisa, në llogaritjen e Qëndrueshmërisë së sektorit bankar, përveç treguesve të hartës së Stabilitetit Financiar është shtuar edhe treguesi i Ekspozimeve, i cili matë ekspozimet e sektorit bankar ndaj letrave me vlerë të qeverive, kreditit në valutë, pjesëmarrjen e detyrimeve të jorezidentëve si dhe pozicionet e hapura në valutë.


Pozicioni financiar i ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare u përmirësua në vitin 2021, por rritja e lartë e inflacionit rrezikon përkeqësimin e gjendjes financiare, në veçanti për sektorin e ndërtimit dhe bujqësisë - të cilët po përballën me rritjen më të lartë të çmimit të inputeve - si dhe për ekonomitë familjare.

Treguesit ekonomik dhe financiarë të ndërmarrjeve sugjerojnë për rritje të konsiderueshme të vëllimit të prodhimit industrial dhe të qarkullimit në tregtinë me pakicë gjatë vitit 2021, pas rënies që i karakterizoi në vitin 2020. Mesatarja e indeksit të shitjeve neto në sektorin e shërbimeve ka shënuar rritje prej 68.3 përqind pas rënies së theksuar prej 36.2 përqind në vitin 2020, ndërsa indeksi mesatar i numrit të punësuarve është rritur për 14.5 përqind (6.4 përqind rënie në vitin 2020). Rikuperimi i shpejtë ekonomik u karakterizua edhe me rritje të iniciativës ndërmarrëse, ku numri neto i bizneseve të hapura shënoi rritje. Pozicioni financiar i ekonomive familjare u përmirësua gjithashtu. Përderisa të dhënat zyrtare të tregut të punës nuk janë në dispozicion përtej TM1 2021, treguesit indirekt si tatimi në të ardhura dhe kontributet pensionale², remitancat, si dhe kursimet sugjerojnë për rritje të burimeve të financimit. Por, rritja e lartë e inflacionit, veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit 2021 dhe e përshpejtuar në vitin 2022, pritet të ndikoj në dobësimin e poizitës financiare të ekonomive familjare, sidomos të pjesës së tyre me të ardhura më të ulëta. Të dhënat zyrtare në TM1 2021 sugjeruan që shkalla e papunësisë ishte 25.8 përqind, ndërsa shkalla e punësimit në raport me popullsinë ishte 29.3 përqind. Paga mesatare neto rezulton të jetë rreth 400-500 euro në muaj, një nivel pothuajse i pandryshueshëm në më shumë se pesë vitet e fundit. Rrethanat e reja në kontekst të rritjes së çmimeve jo vetëm të produkteve bazë por edhe produkteve dhe shërbimeve tjera, japin sinjale për rënie të fuqisë blerëse, me pasoja potenciale në përkeqësim të kapacitetit ripagues të borxhit dhe rritje të rrezikut

kreditor në sektorit bankar. Përderisa ndërmarrjet në përgjithësi pritet të bartin efektin e rritjes së çmimeve të konsumatorët, rreziku megjithatë i'u kanoset përmes kanalit të rënies së kërkesës dhe presionit për rritje të pagave. Sektori i ndërtimitarisë është ndër sektorët me rritjen më të lartë të rrezikut kreditor, për shkak të rritjes së lartë të kostos së inputeve si dhe pasigurive për lëvizjen e çmimeve, faktor që kanë ndikuar në ndërprerjen e pjesëshme apo ngadalësimin e punimeve dhe shitjeve.

Shkalla e bartjes së efekteve të përkeqësimit të pozicionit financiar të sektorit privat (në veçanti sektorit të ndërtimit dhe patundshmërive) në sektorin bankar do të jetë më e evidente pas tremujorit të tretë të vitit 2022, për shkak të pasigurive rreth sjelljes së diasporës Kosovare dhe efektit të tyre të lartë në ekonominë e vendit.

Grafik 1. Indekset e çmimeve të ndërtimit, prodhimit dhe inputeve bujqësore




Burimi: BQK.

Sektori i ekonomive familjare, përkundër rritjes më të lartë të kreditimit të shënuar në vitet e fundit, ka rezultuar më pak i ndjeshëm ndaj krizës së pandemisë, gjykuar në bazë të nevojës për ristrukturim të kredive si dhe ecurisë së KJP-ve. Kjo për faktin se një pjesë e madhe e ekonomive familjare nuk kanë borxh në sektorin financiar (gjykuar nga niveli relativisht i ulët i kredive të ekonomive familjare ndaj BPV-së prej 20.5 përqind, si dhe nga përgjigjet e ekonomive familjare në një anketë për qëllime të brendshme të porositur nga BQK në muajin mars 2021, sipas së cilës 60.3 përqind e repodentëve kanë deklaruar se nuk kanë kredi). Pjesa që posedojnë kredi është më e koncentruar drejtë punëtorëve me

² Raporti-i-Punes-Janar-Dhjetor-2021.pdf (atk-ks.org)

të ardhura në sektorin publik dhe punëmarrësve më stabil. Kjo, së bashku me ndihmat nga remitencat, mendohet se kanë ulur ndjeshmërinë e sektorit të ekonomive familjare ndaj mospagesës së kredive si rezultat i krizës pandemike. Sidoqoftë, vazhdimi i luftës dhe zgjatja e krizës përtej vitit 2022 mund të dobësoj aftësinë paguese të borxhit me efekte në rritjen më të lartë të rrezikut kreditor.

Grafik 2. Borxhi i ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare, në milionë euro



Burimi: BQK.


Në vitin 2021, rritja e aktivitetit ekonomik u shoqërua me rritje të nevojës për financim dhe rritje të nivelit të borxhit për sektorin privat dhe ekonomitë familjare. Financimi i kreditimit u bë kryesisht nga depozitat, të cilat shënuan rritje të qëndrueshme. Borxhi i ndërmarrjeve ndaj institucioneve financiare vendore dhe të jashtme përshpejtoi trendin rritës dhe arriti në 43.3 përqind të vlerës së BPV-së. Stoku i kredisë së ndërmarrjeve nga sektori bankar shënoi rritje vjetore prej 13.6 përqind. Kreditë e ndërmarrjeve nga ndërmjetësit tjerë financiar, të cilat kanë peshë të ulët në gjithsej kreditë, shënuan rritje vjetore prej 17.8 përqind. Borxhi i jashtëm i ndërmarrjeve shënoi rritjen vjetore më të lartë prej 36.9 përqind dhe rriti pjesëmarrjen në strukturën e borxhit të ndërmarrjeve në 28.6 përqind nga 25.0 përqind sa ishte në vitin 2020. Borxhi i ekonomive familjare, sikurse ai i ndërmarrjeve, është rritur me ritëm të përshpejtuar. Gjithsej vlera e borxhit shënoi rritje prej 17.9 përqind në vitin 2021 dhe arriti në 20.5 përqind të BPV-së. Përderisa borxhi i jashtëm i ekonomive familjare ka pjesëmarrje të ulët, ishte kryesisht borxhi i brendshëm

ndaj sektorit bankar dhe ai ndaj sektorit mikrofinanciar që shënuan rritje prej 18.5 përqind, respektivisht 15.8 përqind. Kreditimi i ekonomisë në vitin 2021 vazhdoi të mbështetet nga masa lehtësuese operative dhe rregullative nga BQK, si dhe masa mbështetëse për qasje në financa. Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike - e lansuar në vitin 2020 vazhdoi deri në fund të vitit 2021 – mundësoi qasjen në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme përmes garantimit të kredive në shkallë prej 80%. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mbështeti kreditimin e sektorit privat në fushën e energjisë dhe agrikulturës, edhe përmes dritares Agro, dritares për mbështetjen e bizneseve të reja (Sart-up) si dhe dritares së rregullt të garancive. Në vitin 2022, mbështetja e qasjes në financa do të vazhdoj përmes pakos së Ringjalljes ekonomike, përkatësisht masës së subvencionimit të kredive investuese të sektorit të prodhimit dhe garantimit të kredive për rritje të qasjes në financa.

Dinamika e aktivitetit kreditues gjatë pjesës më të madhe të vitit 2021 u përcaktua kryesisht nga lëvizjet në kërkesën kreditore. Sidoqoftë, sentimentimi i bankave tregon një kërkesë kreditore të përgjysmuar në tremujorin e dytë të vitit 2022, si dhe pasiguri për dinamikat gjatë gjysmës së dytë të vitit. Normat e interesit në kredi vazhduan trendin rënës si rezultat i konkurrencës së shtuar, por rritja e pritshme e kostos së financimit mund të ndryshoj këtë trend në vitin 2022. Rritja e theksuar e kërkesës kreditore nga ndërmarrjet u nxit nga kërkesa për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues dhe investimeve fikse, përderisa për ekonomitë familjare, kërkesën për kredi e ndikoi kërkesa për financimin e shpenzimeve të konsumit. Stoku i kredive aktive në bankat e vendit arriti në 3.75 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore dyfish më të lartë kundrejt vitit paraprak prej 15.5 përqind. Bankat gjatë gjysmës së dytë të vitit 2022 presin si kërkesë të përgjysmuar, ashtu edhe vigjiliencë të shtuar në procedurat e brendshme për analizimin e kërkesave për kredi. Normat mesatare të interesit për kredi

të reja për ndërmarrjet si dhe ekonomitë familjare shënuan rënie të lehtë krahasuar me vitin paraprak, kryesisht si rezultat i rritjes së presioneve të konkurrencës në treg. Në anën tjetër, norma mesatare e interesit në depozitat e afatizuara shënoi rritje, duke sugjeruar për konkurrencë të shtuar në mbajtjen e depozitave në kushtet e kreditimit të lartë. Shtuar kësaj rritjen e normave të interesit në nivel global në vitin 2022, pritjet janë që normat e interesit në depozita të vazhdojnë rritjen, me ndikim të mundshëm në bartjen e kësaj kosto të shtuar tek konsumatorët, përkatësisht në rritje të normave të interesit në kredi.

Grafik 3. Ndryshimi vjetor i kredive të reja



Burimi: BQK.

Lirimi i provizione si dhe rritja e aktivitetit si në aspekt të kreditimit ashtu edhe të transaksioneve në sektorin bankar ndikuan në rritjen e profitit të sektorit dhe përmirësimin e tregueseve të performancës. Sektori bankar i Kosovës këtë vit shënoi rritjen më të lartë të profitit që nga viti 2015. Zvogëlimi i rrezikut nga pandemia ndikoi në lirimin e një pjese të provizioneve të ndara në vitin e kaluar. Kjo, së bashku me rritjen më të shpejtë të hyrave në raport me shpenzimet ndikoi në rritjen vjetore të profitit prej 47.1 përqind. Kontributin më të madh në rritje të të hyrave e kishin të hyrat nga jo-interesi, përkatësisht tarifatat dhe komisionet. Kthimi mesatar në asete dhe kapital i sektorit bankar të Kosovës u rrit në 2.3 përqind, përkatësisht 19.5 përqind nga 1.8 përqind dhe 15.6 përqind një vit më parë. Rritja në nivelin e profitit dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit ishte më e lartë se rënia në vendet e rajonit, duke rritur dallimin mbi mesataren e rajonit që ka sektori bankar i Kosovës. Në

vijim, të hyrat e sektorit bankar pritjet të ballafaqohen me presionin e shkaktuar nga shkalla e lartë e inflacionit të shënuar përgjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2022. Dobësimi i aftësisë paguese të klientëve si dhe rritja e nevojës për ndarje të provizioneve për të mbuluar humbjet e mundshme, mund të ndikojnë si në rënien e të hyrave të sektorit, ashtu edhe në rritje të shpenzimeve. Gjithashtu, rritja e normave të interesit në nivel global, dhe ritmi më i ngadalësuar i rritjes së depozitave, në kushtet e kreditimit të lartë, do të rrisë presionet e konkurrencës që do të transmetohen me presion të shtuar në margjinën e interesit së sektorit.


Cilësia e portfolios kreditore filloi përmirësimin pas tremujorit të parë të vitit 2021, duke iu atribuuar rritjes së aktivitetit ekonomik dhe performancës së mirë të sektorëve ekonomik. Stoku i kredive jo-performuese shënoi rënie që nga tremujori i dytë, për të dy segmentet e kreditimit: ekonomitë familjare dhe pothuajse për të gjithë sektorët ekonomik. Por, optimizmi i gjysmës së parë të vitit, u godit me rritje të inflacionit dhe rritje të tensioneve gjeopolitike, situatë që u përcoll menjëherë me rritje të shqetësimeve rreth aktivitetit të bizneseve në sektorët më të ndjeshëm ndaj rrethanave të tilla dhe dobësimit të fuqisë blerëse të konsumatorit e përkeqësimit të standardit jetësor, zhvillime këto që kanë ndikuar në rritjen e menjëhershme të rrezikut kreditor për vitin 2022. Norma e KJP-ve të sektorit në vitin 2021 u rikthye në trendet rënëse para-pandemike: në fund të vitit, norma e KJP-ve zbriti në 2.3 përqind nga 2.7 përqind një vit më parë. Rënia e normës së KJP-ve i atribuohet kryesisht rritjes së lartë të kreditimit, efektit të shlyerjeve nga disa kredimarrës të mëdhenj, si dhe rënies së kredive të reja jo-performuese, me theks të veçantë në muajt e verës. Perceptimi më i favorshëm për rrezikun kreditor nga ana e bankave ndikoi gjithashtu në riklasifikimin e ekspozimeve kreditore drejt kategorisë me rrezik më të ulët, që së bashku me rritjen e kredive të reja ndikoi në zvogëlimin e pjesëmarrjes së kredive të Shtyllës së dytë

drejt rritjes së pjesëmarrjes së kategorisë së kredive të Shtyllës së parë të klasifikimeve kreditore. Rimëkëmbja e shpejtë ekonomike në vitin 2021, së bashku me masat ristrukturose ndikuan në materializim shumë më të ulët të rrezikut kreditor se pritjet fillestare. Por, cilësia e portfolios kreditorë të kredive të ristrukturuara përcillet ende me pasiguri, për shkak të rrezikut më të lartë kreditor të këtyre kredive të cilat në fund të vitit përbënin pothuajse gjysmën e kredive jo-performuese të sektorit. Për më tepër, ngjarjet e fundvitit si rritja e vazhdueshme e inflacionit e nxitur fillimisht nga ndërprerjet në zinxhirët e furnizimit si pasojë e pandemisë dhe e përforcuar nga konflikti Rusi-Ukrainë, shtojnë nevojën për mbikëqyrje të shtuar dhe ndërmarrje të masave mbrojtëse kundrejt materializimit të këtij rreziku në pozitën e kapitalit të sektorit. Në vitin 2021, përkundër zvogëlimit gradual të rrezikut kreditor, sektori ka vazhduar me ndarje të provizioneve që rezulton me rritje vjetore të raportit të mbulueshmërisë me provizione në 151.0 përqind nga 139.5 përqind në dhjetor 2020.

Sektori bankar tejkaloi krizën pandemike pa vështirësi të theksuara, si dhe me aftësi për të përballuar shkallë të lartë të kreditimit në mbështetje të rimëkëmbjes ekonomike falë pozitës së mirë kapitale të ndërtuar ndër vite. Sidoqoftë, rritja e lartë e kreditimit ka ndikuar në rënien e nivelit të kapitalit të sektorit, dhe vazhdimi i ritmit të tillë të rritjes kreditorë do të paraqesë nevojën për rritje të kapitalit në disa nga bankat. Aktiviteti i lartë kreditor përgjatë vitit 2021 ka rritur asetet e peshura me rrezik në bilancet e bankave, duke rezultuar që raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (TMK) të jetë më i ulët për 2.1 pikë përqindje, në nivelin 15.3 përqind nga 17.4 përqind në vitin e kaluar. Norma e kapitalit ndryshon ndërmjet bankave, me ç'rast kryesisht bankat me rëndësi sistematike kanë normë më të lartë të kapitalizimit. Në nivel sektori, varianca midis TMK-së së bankave individuale ndaj mesatares së sektorit bankar ka shënuar rënie (përafrim të TMK-së ndaj mesatares së sektorit). Pozita e kapitalizimit të sektorit

reflektohet të jetë në nivel adekuat edhe nga treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit të klasit të parë ndaj aseteve të peshuara me rrezik, i cili qëndroi në 13.6 përqind: megjithëse më e ulët se në vitin e kaluar, për arsyen e njejtë, të rritjes së aseteve të peshuara me rrezik që konsistojnë kryesisht kreditë afatgjata. Vazhdimi i kreditimit të ekonomisë me këtë ritëm të përshpejtuar në vijim, sidoqoftë, do të paraqes nevojën për shtim të nivelit të kapitalit nga disa banka që aplikojnë strategji më agresive të kreditimit. Për më tepër, inflacioni i lartë si dhe rritja e normave të interesit në nivel global, pritet të shtojnë presionin në të hyrat e sektorit, profitabilitetin e tij dhe nivelin e kapitalit, përmes efektit të rritjes së kostos së financimit si dhe rritjes së rrezikut kreditor që do të rrisë nevojën për provizionim. Analiza stres test sugjeron që sektori në përgjithësi do të ishte në gjendje për përballimin e humbjeve të mundshme në dy nga tre skenarët e dizajnuar të zhvillimeve makroekonomike (skenarin bazë si dhe skenarin e moderuar me rënie ekonomike prej 4.7 përqind dhe shkallë inflacioni prej 14.2 përqind).

Grafik 4. Tregues të përzgjedhur të shëndetit financiar



Burimi: BQK.

Ndërsa në skenarin e rënduar të stagflacionit (i cili sipas definicionit është i mundshëm, por ka probabilitet shumë të ulët të ndodhjes), përkatësisht rënies ekonomike prej 11.6 përqind dhe inflacionit 20.0 përqind, sektori do të ballafaqohet me probleme në pozitën e tij kapitale. Pothuasje të gjitha bankat do të përballeshin me nevojën për rikapitalizim si rezultat i humbjeve të mëdha dhe nivelit të lartë të provizionit të kërkuar.

Rritja e lartë e depozitave nga sektori privat në vitin 2021 si dhe likuiditeti i akumuluar i bankave mundësoi rritjen e lartë të kreditimit, duke ruajtur njëherit pozitën e qëndrueshme të likuiditetit të sektorit. Treguesit kryesorë të likuiditetit, përkundër tendencës rënëse, qëndruan në nivele të larta në fundvit. Sidoqoftë, presionet në kosto të financimit pritët të rriten si pasojë e zhvillimeve globale në norma të interesit të cilat do të ndikojnë direkt dhe indirekt koston e financimit për sektorin bankar të Kosovës. Pozita e mirë e likuiditetit u mbështet përgjatë vitit 2021 nga rritja e vazhdueshme e depozitave, dhe në veçanti depozitave të ekonomive familjare. Si burim kryesor i financimit të sektorit, depozitat e ekonomive familjare kryesisht u mbështetën nga remitencat përmes kanaleve formale por edhe joformale (fluksi i lartë i diasporës me hapjen e mundësive për udhëtime). Raporti i asetëve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra në dhjetor 2021 zbriti në 37.4 përqind krahasuar me 39.6 përqind në vitin 2020. Mirëpo, raporti i ngushtë i likuiditetit, i cili përfshinë vetëm asetet shumë likuide (paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj, llogaritë rrjedhëse dhe plasmanet), në raport me detyrimet afatshkurtra, u ngrit lehtësisht në 30.6 përqind nga 30.5 përqind një vit më parë, për shkak të rritjes më të lartë të asetëve shumë likuide prej 13.2 përqind. Rezervat e likuiditetit të bankave komerciale vazhdojnë të jenë në nivele të larta, duke tejkaluar rezervën e obliguar të mbajtur në BQK për 68.3 përqind. Sidoqoftë, rritja e inflacionit ka rritur pasigurinë për ecurinë e zhvillimeve ekonomike si dhe ka ndikuar në shtrëngimin e politikës monetare në shumë vende në vitin 2022, që do të reflektohet në rritjen e koston të financimit të bankave amë, e që indirekt do të bartet edhe në koston të shtuar të financimit për sektorin bankar të Kosovës. Për më tepër, trendi i rritjes së depozitave është ngadalësuar dhe mund të ngadalësohet tutje në rrethanat e reja të rritjes së koston të jetesës dhe rënies së aktivitetit ekonomik, gjë që do të shtojë presionin në financimin e sektorit bankar dhe pozitën e likuiditetit, si në aspekt të mirëmbajtës së

nivelet të depozitave ashtu edhe në aspekt të koston për mirëmbajtjen e tyre.

Sektori pensional në vitin 2021 shënoi rritje të përshpejtuar të aktivitetit duke tejkaluar rritjen e periudhës parapandemike, pas goditjes së lartë që pësoi në vitin 2020 pikërisht si rezultat i krizës pandemike si dhe tërheqjes së parakohshme të 10 përqind të mjeteve të trustit prej kontribut-dhënësve. Rritja e shkallës së vaksinimit dhe rikuperimi i shpejtë i ekonomisë globale ndikuan në performancën e mirë të tregjeve, që u reflektua në rritjen e kthimit në investime të sektorit. Arkëtimet e reja po ashtu shënuan rritje, të ndikuar nga rikuperimi i shpejtë i aktivitetit ekonomik në vend. Sidoqoftë, tensionet e reja gjeopolitike në vitin 2022 kanë rritur pasigurinë rreth performancës së ekonomisë dhe tregjeve globale financiare. Shtuar kësaj dhe shtrëngimin e pritshëm të politikës monetare nga shumica e bankave qendrore të vendeve të zhvilluara, sfidat e performancës së sektorit pensional të Kosovës janë shtuar theksueshëm për vitin 2022. Vlera e asetëve të sektorit arriti në 2.36 miliardë euro në fund të vitit 2021, që përkon me një rritje vjetore prej 18.2 përqind. Kthimi bruto nga investimet arriti vlerën rekorde që prej fillimit të funksionimit prej 228.4 milionë euro, dhe rritje rekorde të çmimit për njësi. Arkëtimet e reja u rritën për 9.8 përqind, duke kaluar nivelin e rritjes së periudhës parapandemike. Dinamikat pozitive në tregjet globale ndikuan që të rritet pjesëmarrja e investimeve në tregje të jashtme, e cila u zvogëlua në vitin e kaluar në favor të rritjes së investimeve në vend, por që megjithatë është më e ulët në raport me gjendjen para pandemike. Në fillim të tremujorit të dytë të vitit 2021, përfundoi afati i masës mbështetëse të tërheqjes së parakohshme të 10 përqind të kursimeve pensionale nga kontribut-dhënësit. Shuma e mjeteve të tërhequra ishte 198.1

milionë euro, nga të cilat 101.7 milionë euro do të kompensohen nga Qeveria e Kosovës.³

Sektori i sigurimeve u karakterizua me zgjerim të aseteve në vitin 2021, si dhe rritje të primeve të shkruara dhe dëmeve të paguara në nivele më të larta se nivelet para-pandemike. Fitimi i sektorit shënoi rritje krahasuar me mesataren historike, pavarësisht rritjes së nivelit të dëmeve të paguara. Vlera e primeve të shkruara nga siguruesit në vitin 2021 shënoi rritje vjetore prej 18.2 përqind. Dëmet e paguara, përfshirë dëmet e Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), shënuan rritje për 24.4 përqind. Si rrjedhojë e rritjes më të lartë të dëmeve të paguara në raport primet e arkëtuara, raporti dëme/prime u rrit për 2.6 pikë përqindje, në 52.0 përqind. Sektori e mbylli vitin me rezultat pozitiv financiar prej 6.9 milionë euro, krahasuar me 2.3 milionë euro vitin e kaluar, si rrjedhojë e rritjes së konsiderueshme të primeve të arkëtuara si dhe zvogëlimit të shpenzimeve operative. Në nivel të sektorit, gjatë vitit 2021 kishte ngritje në treguesit e shëndetit financiar siç janë niveli i përgjithshëm i kapitalizimit, treguesit e likuiditetit, si dhe vlera e provizioneve teknike për primet dhe dëmet. Sidoqoftë, problemet me nivel kapitalizimi në dy kompani vazhdojnë, probleme këto të trashëguara nga vite më parë. Këto kompani vazhdojnë të jenë nën kërkesat minimale ligjore për kapital dhe asete të pranueshme në mbulim të provizioneve teknike.

Sektori mikrofinanciar shënoi përshpejtim të rritjes, të ndikuar nga rikuperimi i aktivitetit kreditor dhe të lizingjeve. Përmirësimi i gjendjes pandemike dhe rritja e kërkesës në vend ndikuan në rritjen e financimit të jashtëm të sektorit. Por, varësia e sektorit nga burimet e jashtme të financimit e bënë atë të ndjeshëm ndaj zhvillimeve në tregjet globale financiare. Lufta në Ukrainë dhe shtrëngimi i politikave monetare për

kontrollimin e inflacionit pritet të ndikojnë në rritjen e kostos së financimit të këtij sektori. Huazimet nga sektori i jashtëm, që paraqesin 60.1 përqind të detyrimeve dhe kapitalit të sektorit, shënuan rritje vjetore prej 3.6 përqind (rënie për 0.4 përqind një vit më parë). Kreditimi si për ekonomitë familjare dhe korporatat jofinanciare shënoi rritje të theksuar në vitin 2021 (16.7 përqind, respektivisht 17.8 përqind). Normat e interesit, në mesatare shënuan rënie në 19.4 përqind nga 20.3 përqind një vit më parë. Sektori realizoi fitimin më të lartë vjetor që nga fillimi i operimit të tij, në vlerë prej 14.1 milionë euro, si rezultat i rënies së përshpejtuar të shpenzimeve si rezultat i lirimimit të provizioneve, si dhe rritjes së të hyrave, kryesisht të hyrave nga jointerisi. Niveli i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive mbetet i ulët dhe është zvogëluar tutje për 0.6 pikë përqindje, në 2.4 përqind. Ndërsa niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione në dhjetor 2021 qëndroi në 141.6 përqind, për 1.4 pikë përqindje.

Përmirësimi i gjendjes pandemike si dhe lehtësimi i masave kufizuese të lëvizjes si rezultat i rritjes së vaksinimit ndikoi në rritjen e turizmit të diaposrës dhe rrjedhimisht rënien e pjesëmarrjes së remitencave të dërguara përmes ndihmësve financiar, gjë që ndikoi në rënien e profitit të këtij sektori i cili në vitin e kaluar, kur mundësia e udhëtimit të diasporës ishte e kufizuar, ishte sektori me rritjen më të lartë. Ky sektor, me peshë të ulët prej vetëm 0.3 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar, përbëhet nga byrotë e këmbimit dhe agjensionet për transferim të parave (ATP). Asetet e sektorit shënuan rritje vjetore më të lartë, 16.5 përqind krahasuar me 13.2 përqind, por neto fitimi zbriti në 3.2 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 24.4 përqind krahasuar me rritjen për 34.2 përqind vitin e kaluar.

³ Sipas planit të Rimëkëmbjes ekonomike, është mundësuar lejimi i tërheqjes së shumës prej 10 përqind të mjeteve të kursyera në fondet pensionale për kontribut-paguesit, bazuar në nevojat e tyre, e cila

mundësi mund të shfrytëzohet për një periudhë 4-mujore. Për kontribut-paguesit me kursime të përgjithshme nën shumën 10,000 euro, qeveria do të kompensoj shumën e tërhequr prej 10 përqind në afat prej pesë viteve.

Mbikëqyrja makroprudenciale e sektorit financiar nga BQK ka vazhduar, krahas vazhdimit të përpjekjeve për plotësimin e bazës ligjore për ushtrimin e mandatit të politikës makroprudenciale dhe ngushtimit të hendekut të të dhënave për vlerësim më kualitativ të rrezikut sistemik. Me qëllim të përforcimit të bazës ligjore të BQK-së në ushtrimin e mandatit për makroprudencë, draft ligji i ri për banka që pritet të procedohet për aprovim, përcakton BQK-në si autoritetin e vetëm përgjegjës për mbikëqyrje makroprudenciale të bankave dhe i delegon autoritet BQK-së të nxjerrë instrumente rregullative përkatëse. Në ndërkohë, komiteti këshillëdhënës për makroprudencë, si trupë e brendshme e BQK-së, ka mbajtur takimet e rregullta tremujore, duke shqyrtuar tregues të përzgjedhur për vlerësimin e rrezikut sistemik, të cilët në përgjithësi në vitin 2021 kanë sugjeruar për stabilitet të sektorit. Vlerësimi i rrezikut sistemik, ndër tjera, është subjekt i mungesës së theksuar të dhënave, dhe përpjekjet për mbylljen e hendekut të të dhënave kanë vazhduar. Në këtë aspekt, është rishikuar rregullorja për raportim në regjistrin e kredive të Kosovës, në të cilën janë shtuar kërkesat për raportim të treguesve shtesë.

BQK në vitin 2021 ka vazhduar monitorimin e përafërt të efekteve të gjendjes pandemike në sektorin financiar, duke vazhduar masa të caktuara rregullative për lehtësimin e tejkalimit të vështirësive të hasura nga sektori privat, siç janë ristrukturimet. Ndërsa, përkitazi me rrethanat e rikuperimit të aktivitetit ekonomik dhe performancës së sektorit bankar, është larguar kufizimi i shpërndarjes së dividendës. Udhëzuesi i fundit për ristrukturim të kredive të afektuara nga gjendja pandemike është publikuar në muajin shkurt 2021, sipas së cilit është vazhduar afati për ristrukturime dhe është përcaktuar që ristrukturimet të maturojnë në tërësi në fund të vitit 2021. Në dhjetor 2021, pjesëmarrja e kredive aktive që janë ristrukturuar rezultoi në 19.3 përqind të gjithsej kredive.

Infrastruktura financiare ka vazhduar avancimin. Iniciativat për digjitalizim janë intensifikuar dukshëm, të nxitura nga kriza pandemike. Me rritjen e digjitalizimit është rritur njëtrajtshëm edhe ekspozimi ndaj rrezikut operacional/kibernetik, që rritë nevojën për investim në mbikëqyrje pro aktive për mbrojtje ndaj këtij rreziku. Sistemi i pagesave, pavarësisht mbylljes së ekonomisë dhe kufizimit të lëvizjes së rezultatit të pandemisë, ka operuar pa ndërprerje duke ofruar sigurinë, efikasitetin dhe fleksibilitetin e duhur për pjesëmarrësit, në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar dhe identifikimit dhe adresimit të hershëm të problemeve të mundshme. Trendi i shpejtë i zhvillimit të infrastrukturës virtuale ka vazhduar, i nxitur edhe nga rrethanat e krijuara nga gjendja pandemike. Bankat kanë rritur përpjekjet e përgjithshme për digjitalizim dhe automatizim të shërbimeve, në funksion të ofrimit të mundësive për realizim të shërbimeve duke ruajtur shëndetin e klientëve. Shumica e bankave kanë rritur limitin e pagesave pa kontakt që mund të bëhet përmes kartelave bankare. Llogaritë bankare E-banking, përmes të cilave shërbimet bankare kryhen 'online', kanë vazhduar rritjen. Infrastruktura bankare është zgjeruar edhe në kontekst të rrjetit të numrit të bankomatëve dhe numrit të paisjeve për pagesë përmes kartelave – POS. Rritja e përdorimit të shërbimeve të digjitalizuara ka rritë njëkohësisht edhe shkallën e rrezikut ndaj gabimeve në sisteme të teknologjisë informative apo dhe sulmeve të mundshme kibernetike, duke rritur kështu ekspozimin ndaj rrezikut operacional si dhe nevojën për mbikëqyrje pro aktive për mbrojtje ndaj këtij rreziku.

Kutia 1. Harta e Stabilitetit Financiar⁴

Harta e stabilitetit financiar⁵ paraqet zhvillimet në treguesit kryesorë të rrezeve ndaj stabilitetit financiar të Kosovës (grafik 4). Në mesatare, viti 2021 është karakterizuar me ulje të rrezikut ndaj stabilitetit financiar në pothuajse të gjitha dimensionet e rrezikut dhe treguesit përbërës përkatës, si rezultat i rikuperimit të aktivitetit ekonomik nga kriza pandemike. Rreziku nga ambienti makroekonomik i jashtëm dhe i brendshëm shënoi rënie të theksuar. Me rënie rreziku u karakterizua edhe veprimtaria e agjentëve ekonomikë: sektori i ndërmarrjeve shënoi përgjysmim të notës së rrezikut, ndërsa sektori qeveritar dhe ai i ekonomive familjare u karakterizuan me rënie, por në nivel më të ulët. Treguesit e qëndrueshmërisë së sektorit bankar kanë reflektuar rrezik në rënie. Përkatësisht, treguesi i Kapitalizimit dhe profitabilitetit, si dhe treguesi i Likuiditetit dhe financimit të sektorit janë karakterizuar me rrezik më të ulët, ndërsa treguesi i Strukturës së sektorit bankar ka shënuar rritje të lehtë, duke ndërruar kahun e rënies graduale që ka shënuar ndër vite.


Për dallim nga viti 2020 kur pesë nga treguesit qëndruan në nivel të rrezikut mbi mesataren historike, në vitin 2021, vetëm treguesi i Qeverisë, dhe ai i Likuiditetit dhe Financimit, qëndruan mbi këtë mesatare, përkundrazi që gjatë vitit shuënuan rënie rreziku (grafik 5).⁶

Rikuperimi i theksuar i aktivitetit ekonomik dhe rritja e punësimit në Evropë në vitin 2021, përkatësisht në ekonomitë e partnerëve kryesor tregtar të Kosovës dhe vendet me prezencën më të lartë të diasporës kosovare, ka kontribuar në rënie e rrezikut të përgjithshëm **nga treguesi i ekonomisë së jashtme**. Rritja e sentimentit pozitiv të ndërmarrjeve si dhe rënia e normave të interesit si rezultat i masave lehtësuese për tejkalimin e krizës pandemike kontribuan gjithashtu pozitivisht në rënie rreziku. Kontribut negativ kishte nëntreguesi i çmimit të naftës, i cili u karakterizua me rritje përgjatë gjithë vitit. Dinamikat në nëntreguesit e ekonomisë së jashtme për vitin 2022 sugjerojnë për rritje të rrezikut në të gjithë nëntreguesit e kësaj kategorie, si rezultat i

efekteve negative të presioneve të theksuara inflacioniste të shkaktuara nga kriza pandemike si dhe lufta në Ukrainë.

Rikuperimi i aktivitetit ekonomik në Kosovë në vitin 2021 ndikoi në rritjen e hendekut pozitiv të prodhimit duke dhënë kontributin kryesorë në rënie e përgjithshme të rrezikut **në treguesin e ekonomisë së brendshme**. Rritja e borxhit të jashtëm në raport me BPV-në, zgjerimi negativ i deficitit të llogarisë rrjedhëse si dhe rritja e çmimeve të konsumit kontribuan negativisht në notën e rrezikut të ekonomisë së brendshme. Ecuria e këtyre nëntreguesve për vitin 2022, si dhe pritjet për rritje më të ngadalësuar ekonomike, sugjerojnë për rritje të rrezikut të përgjithshëm nga ekonomia e brendshme për vitin 2022.

Grafik 5. Harta e stabilitetit financiar



Burimi: BQK.

Sektori i ndërmarrjeve u karakterizua me rënie më të lartë të rrezikut, të ndikuar nga ecuria pozitive në të gjithë treguesit, ecuri kjo e nxitur nga lehtësimi i masave kufizuese të përhapjes së pandemisë, si dhe masave mbështetëse për bizneset të cilat ndikuan në rikuperimin e aktivitetit ekonomik në sektorët kryesorë me peshën më të madhe në ekonominë e vendit. Rritja e kreditimit për sektorin e ndërmarrjeve si dhe masat lehtësuese për kthimin e kredive nga bizneset (ristrukturimet) ndikuan në përmirësimin/rënie e rrezikut nga nëntreguesi i hendekut të kreditimit të bizneseve dhe cilësisë së portfolios kreditore. Nëntreguesit tjerë, njëkohësisht me peshë më të madhe në rënie e rrezikut, ishin rritja e indeksit të qarkullimit industrial, rritja e indeksit të qarkullimit në sektorin e shërbimeve, rritja e vlerës së shtuar në

⁴ Kalkulimi i treguesve bazohet në vlerën e BPV-së deri në muajin mars 2021, dhe nuk përfshinë revidimin e fundit të BPV-së në prill 2021.

⁵ Harta e Stabilitetit Financiar (HSF) prezanton në mënyrë grafike lëvizjen e shkallës së rrezikut në kategoritë kryesore të rrezikut ndaj stabilitetit financiar në sektorin bankar të Kosovës, si dhe mundëson krahasimin me notën mesatare historike të rrezikut për kategoritë përkatëse. Rritja e distancës nga qendra e hartës për treguesit reflekton rritje të rrezikut dhe

zvogëlim të aftësisë për përballimin e goditjeve ndaj stabilitetit financiar, dhe anasjelltas. Metodologjia e plotë e modelit të HSF-së për Kosovën, i cili ka pësuar revidime të vazhdueshme në tregues dhe mënyrën e tyre të llogaritjes, paraqitet në Materialin Studimor të BQK-së Nr. 6.

⁶ Ecuria e rrezikut nga treguesit e Hartës së Stabilitetit Financiar dhe kontributi i komponentëve përbërëse në nivelin përkatës të rrezikut paraqitet në Shtojcën 1.

BPV nga sektori i tregtisë si dhe bilanci neto pozitiv i hapjes së bizneseve të reja.


Rreziku nga **ekonomitë familjare** shënoi rënie të lehtë, i ndikuar krejtësisht nga rritja e theksuar e dërgesave të emigrantëve. Nëntreguesit si hendeku i kreditimit ndaj BPV-së dhe cilësia e portfolios kreditore shënuan rritje të lehtë rreziku, përderisa informatat për nëntreguesit tjerë të rëndësishëm si tregu i punës/papunësia dhe përballueshmëria e shpenzimeve ishin të mangëta për vitin 2021. Ecuria e inflacionit në vitin 2022 paraqet rrezik të shtuar për aktivitetin e sektorit privat dhe gjendjen financiare të ekonomive familjare, ndaj dhe pritjet janë për rritje të rrezikut nga këta tregues për vitin 2022.

Rreziku nga **sektori qeveritar** shënoi rënie, kryesisht si rezultat i rritjes së të ardhurave tatimore të cilat arritën në nivelin më të lartë historik, dhe ndikuan në përmirësimin e raportit së të ardhurave tatimore ndaj BPV-së. Nëntregues tjetër me kontribut në rënieën e rrezikut nga sektori qeveritar ishte përmirësimi i bilancit buxhetor ndaj BPV-së, si dhe kosto e borxhit. Ndërsa, nëntreguesi i vetëm që kishte kontribut në rritje të rrezikut ishte zgjerimi i borxhit publik. Në vitin 2022, borxhi publik pritet të zgjerohet tutje si rezultat i masave ndihmëse për tejkalimin e sfidave nga rritja e lartë e çmimeve. Rritja e normave të interesit në nivel global pritet të ndikoj gjithashtu në rritjen e koston së borxhit. Ngadalësimi i rritjes ekonomike mund të ndikoj në nivel më të ulët të të ardhurave tatimore. Rrjedhimisht, pritjet për ecurinë e këtyre treguesve sugjerojnë që rreziku nga sektori qeveritar për vitin 2022 mund të shënoj rritje.

Në kuadër të treguesve të brendshëm të qëndrueshmërisë së sektorit, **treguesi i kapitalizimit dhe profitabilitetit** ka shënuar rënieën më të theksuar të rrezikut, të ndikuar kryesisht nga rritja e profitit të sektorit që rezultoi në rritje të raportit të profitit ndaj asetëve të sektorit. Rritja e profitit ndikoi gjithashtu në rritjen e raportit të kapitalit aksionar ndaj asetëve të sektorit. Nëntreguesit tjerë si Mjaftueshmëria e Kapitalit, ekspozimet e mëdha si dhe kualiteti i portfolios kreditore kontribuan gjithashtu në rënie të rrezikut, ndërsa rënia e të hyrave neto nga interesi në raport me asetet ishte treguesi i vetëm me kontribut në rritje të rrezikut.

Treguesi i likuiditetit dhe financimit të sektorit shënoi rënie rreziku në pothuajse të gjithë nëntreguesit përbërës. Kontributin kryesor në rënie e kishte rritja e depozitave të ekonomive familjare. Nëntreguesi i vetëm me kontribut në rritje të rrezikut ishte zgjerimi i hendekut të likuiditetit si rezultat i rritjes së lartë të kreditimit, i cili u financua kryesisht nga rritja e burime afatshkurtra të kreditimit (depozitave). Rënia e ntës mesatare të rrezikut të treguesit të likuiditetit dhe financimit në këtë periudhë, ngushtoi devijimin më të theksuar mbi nivelin e mesatares historike që ky tregues e kishte ndër vite, i cili në masë të madhe reflekton natyrën e komponentëve të përfshirë në tregues.⁷

Grafik 6. Harta e stabilitetit financiar



Burimi: BQK.

Struktura e sektorit bankar ndërroi kahjen e përmirësimit gradual ndër vite, duke shënuar rritje të lehtë të rrezikut. Nëntreguesi i përgjithshëm i konkurrencës, përkatësisht asetet e 3 bankave më të mëdha ndaj asetëve të sektorit, shënoi përmirësim duke kontribuar në ulje rreziku. Me zhvillime pozitive u karakterizuan edhe nëntreguesi i diversifikimit të portfolios së përgjithshme kreditore si dhe ai i divesifikimit të porfolios së kredive të bizneseve. Ndërsa, nëntreguesit që kontribuan në rritje të rrezikut ishin ai i devijimit negativ të normës së kapitalizimit ndaj normës mesatare të kapitalizimit të sektorit si dhe rënia e shkallës së diversifikimit të burimeve të financimit të bankave.

⁷ Treguesi i normës kredi/depozita ka përcjellë trend natyreshëm rritës që nga fillimi i funksionimit të sektorit, dhe periudhat e fundit reflektojnë raport më të lartë (notë më të lartë rreziku). Ngjashëm, trendi i normës së rritjes së depozitave të ekonomive familjare është karakterizuar me fluktuime të

theksuara përgjatë viteve, duke qenë më i lartë në fillimet e funksionimit të sektorit dhe natyreshëm ka filluar të bie si rezultat i zhvillimit të sektorit, por që përsëri është rritur në periudhat e fundit.

3. Mjedisi i jashtëm dhe zhvillimet në ekonominë e brendshme

Eurozona është karakterizuar me rimëkëmbje të aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2021, si rezultat i përmirësimit të situatës pandemike, lehtësimit të masave kufizuese si dhe politikës mbështetëse fiskale dhe monetare. Shenjat e rikuperimit janë zbehur në tremujorin e fundit të vitit si pasojë e përhapjes së variantit të ri të koronavirusit “Omicron”, krizës energjetike dhe problemeve evidente të vazhdueshme në zingjirët e furnizimit që rezultuan në presione inflacioniste.

Ngjashëm me Eurozonën, edhe vendet e Ballkanit Perëndimor shënuan rikuperim të aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2021, rikuperim që rezultoi në këtë humbur ritmin në tremujorin e fundit të vitit 2021.

Përderisa rreziqet në lidhje me pandeminë u zvogëluan në fund të vitit 2021, prospektet për vitin 2022 dhe tutje në periudhë afatmesme sugjerojnë për rritje të rreziqeve, që për burim kanë luftën në Ukrainë. Këto rreziqe, pasqyruar kryesisht përmes rritjes së çmimeve të energjisë, naftës dhe ushqimit, problemeve në tregti (ofertë) dhe rënies së besueshmërisë së konsumatorëve, priten të ndikojnë negativisht aktivitetin e përgjithshëm ekonomik.

Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomikë

Përshkrimi	BPV-ja reale				Inflacioni			
	2019	2020	2021	2022	2019	2020	2021	2022
Eurozona	1.6	-6.4	5.3	2.8	1.2	0.3	2.6	5.3
Gjermania	1.1	-4.6	2.8	2.1	1.4	0.4	3.2	5.5
Franca	1.8	-8.0	7.0	2.9	1.3	0.5	2.1	4.1
Italia	0.5	-9.0	6.6	2.3	0.6	-0.1	1.9	5.3
Spanja	2.1	-10.8	5.1	4.8	0.7	-0.3	3.1	5.3
Kosova	4.8	-5.3	10.5	2.5	2.7	0.2	3.4	8.1
Mali i Zi	4.1	-15.3	12.4	3.8	0.4	-0.2	2.4	6.8
Maqedonia e Veriut	3.9	-6.1	4.0	3.2	0.8	1.2	3.2	6.9
Bosnja dhe Hercegovina	2.8	-3.1	5.8	2.4	0.6	-1.1	2.0	6.5
Serbia	4.3	-0.9	7.4	3.5	1.9	1.6	4.1	7.7
Shqipëria	2.1	-3.5	8.5	2.0	1.4	1.6	2.0	5.5

Burimi: FMN, WEO prill 2022, ASK dhe BQK për Kosovën.

Eurozona ka shënuar rritje të aktivitetit ekonomik prej 5.3 përqind në vitin 2021 (tabela 2). Rimëkëmbja e ekonomisë është mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme, si rezultat i përmirësimit të situatës pandemike, lehtësimit të masave kufizuese si dhe politikës mbështetëse fiskale dhe monetare. Ekonomitë e eurozonës u karakterizuan me një ringjallje të shpejtë në nëntë muajt e parë të vitit 2021, dinamikë që pësoi ngadalësim në tremujorin e fundit të vitit si pasojë e përhapjes së variantit të ri të koronavirusit “Omicron” dhe rikthimit të masave në vende të ndryshme. Gjithashtu, rikuperimi i shpejtë ekonomik i nëntë muajve të parë të vitit rezultoi me rritje të lartë të kërkesës së përgjithshme, dinamikë që nuk arriti të shoqërohet nga oferta, gjë që rezultoi në rritje të çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare. Prospektet afatshkurtëra për ekonominë e eurozonës u përkeqësuan tutje në

tremujorin e parë të vitit 2022, me fillimin e luftës në Ukrainë, konflikt që pritet të ketë dëme të rënda ekonomike me pasoja në aktivitetin ekonomik global. Lufta në Ukrainë dhe pasojat ekonomike janë përhapur shpejtë përmes tregjeve ndërkombëtare të mallrave dhe ndërlidhjeve financiare, gjë që ka vështirësuar koordinimin e politikave kundrejt adresimit të dy sfidave kyçe në muajt në vijim: presioneve inflacioniste dhe mbështetjes së rimëkëmbjes ekonomike. Përmes pasojave direkte që ka si në besueshmërinë e konsumatorëve ashtu edhe në çmimet e mallrave kryesore si gazi dhe nafta, gruri, misri, fertilizuesit, etj., lufta në Ukrainë, sanksionet ndaj Rusisë si dhe problemet ende evidente në zingjirët e furnizimit rezultuan në përkeqësim të projeksioneve për prospektet e ardhshme ekonomike si në vendet e zhvilluara ashtu edhe ato në zhvillim. Për vitin 2022,

FMN ka rishikuar projeksionin e rritjes reale të BPV-së për më ulët në 2.8 përqind, ndërsa projeksionin për inflacionin për më lartë në 5.3 përqind.

Në linjë me dinamikat e ndryshuara të rreziqeve, BQE ka vendosur të reduktoj gradualisht blerjet e neto aseteve, që mund të përfundojnë në tremujorin e tretë, dhe ka sinjalizuar për shtërngim të politikës monetare përkundër rrezikut që një hap i tillë do të ndikoj në dobësim të mëtejshëm të aktivitetit ekonomik.

Edhe vendet e Ballkanit Perëndimor shënuan rikuperim të aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2021, me përjashtim të tremujorit të fundit të vitit kur u evidentua ngadalësim i rritjes. Vlerësimet e FMN-së sugjerojnë se aktiviteti ekonomik në rajon ka shënuar rritje mesatare prej 8.1 përqind në vitin 2021. Me pasiguritë e rritura si pasojë e luftës në Ukrainë dhe masave të ndërmarra në formë të sanksioneve, ngjashëm me eurozonën, edhe rajoni pritet të përballet me ngadalësim të rritjes ekonomike prej vetëm 2.9 përqind, ndërsa inflacioni pritet të arrijë në 6.9 përqind nga 2.9 përqind sa ishte në vitin 2021.


3.1. Ekonomia e brendshme

Kosova ka shënuar rritje të lartë të aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2021, pas tkurrjes me të cilën u karakterizua në vitin pandemik 2020. **Vlerësimet preliminare të ASK-së sugjerojnë se ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje prej 10.5 përqind në vitin 2021 (grafik 7).**

Rritja e lartë e aktivitetit ekonomik ishte si rezultat i përmirësimit të krizës shëndetësore, efekteve të politikave stimuluese financiare dhe fiskale dhe shkallës së lartë të të hyrave të gjeneruara nga diaspora, të hyra që mbështetën konsumin dhe investimet. Përmirësimi i krizës shëndetësore mundësoi lehtësim gradual të masave të kontrollit të pandemisë duke mbështetur kështu lëvizjen e lirë, dinamike që u shoqërua me rritje të lartë të kërkesës së brendshme dhe eksporteve. Kontributi i eksportit të mallrave dhe shërbimeve në rritjen e BPV-së ishte 17.0 pikë

përqindje, konsumit 7.7 pikë përqindje si dhe investimeve 3.4 pikë përqindje.


Grafik 7. Norma e rritjes së BPV-së reale dhe kontribuesit në rritje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Në anën tjetër, rritje shumë e lartë është shënuar edhe tek importi i mallrave dhe shërbimeve, me një kontribut negativ në rritjen e BPV-së prej 17.6 pikë përqindje, duke bërë që eksportet neto megjithatë të kenë një kontribut të lehtë negativ prej 0.6 pikë përqindje.

Grafik 8. Indekset e shitjeve dhe të punësuarëve në sektorin e shërbimeve (2015=100)



Burimi: ASK.

Në baza sektoriale, sektorët që shënuan rritjen më të lartë të vlerës së shtuar ishin sektori i hoteleve dhe restoranteve, transportit dhe magazinimit, tregtisë, industrisë përpunuese, ndërtimtarisë, etj. Rritja e theksuar e aktivitetit ekonomik në këta sektorë është paraqitur edhe tek statistikat afatshkurtra të shërbimeve, ku është vërejtur rritje e theksuar e aktivitetit dhe rritje e shkallës së punësimit, dinamika të ndikuara kryesisht nga lehtësimi i masave kufizuese. **Mesatarja e indeksit të shitjeve neto në sektorin e shërbimeve ka shënuar rritje prej 68.3 përqind në vitin 2021 (36.2 përqind rënie në vitin 2020), ndërsa indeksi mesatar i numrit të**


punësuarve është rritur për 14.5 përqind (6.4 përqind rënie në vitin 2020) (grafik 8).

Të gjithë sektorët raportuan rritje të shitjeve. Rritja më e lartë është shënuar tek hotelet (174.5 përqind), pasuar nga agjencitë e udhëtimit (133.0 përqind), bar-restoranet (120.4 përqind), transporti dhe magazinimi (53.3 përqind) si dhe tregtia (35.2 përqind).

Stabilizimi i pritur i aktivitetit ekonomik në vitin 2022, nga rritja e paprecedent pas-pandemike e shënuar në vitin 2021, u vështirësua si pasojë e fillimit të luftës në Ukrainë. Rreziqet e rritura si pasojë e luftës ndikuan prospektet për rritjen ekonomike, nivelin e inflacionit dhe kushtet financiare në rajon, eurozonë dhe më gjerë. Projektionet e BQK-së sugjerojnë për një rritje të BPV-së prej rreth 3.0 përqind, një ngadalësim që i atribuohet kryesisht rritjes më të ulët të kërkesës së brendshme.

Në skenar tjerë më të rënduar, ku kriza gjeopolitike nuk përmyllet shpejtë dhe presionet inflacioniste shtohen tutje, perspektiva ekonomike për Kosovën do të jetë më pesimiste dhe viti mund të përmyllet me stagflacion.

Grafik 9. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor



Burimi: ASK.

Rritja e kërkesës së përgjithshme si rezultat i rikuperimit ekonomik si dhe dinamikat në çmimet e mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare gjatë vitit 2021 u reflektuan në presione inflacioniste në Kosovë. Norma mesatare vjetore e inflacionit në vitin 2021, e shprehur nëpërmjet indeksit të

çmimeve të konsumit (IÇK), ishte 3.4 përqind (0.2 përqind në vitin 2020) (grafik 9). Komponentët kryesorë që kontribuuan në këtë rritje ishin çmimet e transportit dhe ushqimit me 1.2 përqind dhe 1.0 pikë përqindje.

Rikuperimi ekonomik që u shoqërua me hapjen e ekonomisë, siç edhe pritej, u përcoll me rritje të vazhdueshme të çmimeve përgjatë tërë vitit. Gjithashtu, faktor tjetër përcaktues në dinamikat inflacioniste gjatë vitit 2021 ka qenë edhe rritja e lartë e çmimeve të mallrave bazë dhe inuteve të ndërmjetme dhe energjisë në tregjet globale, duke bërë që ndikimi i presioneve të jashtme inflacioniste të reflektohet në të gjitha indekset tjera të çmimeve në vend. Indeksi i çmimeve të prodhimit shënoi rritje prej 4.9 përqind, pasuar nga indeksi i kostos së ndërtimit me 10.9 përqind si dhe indeksi i çmimeve të importit, i cili shënoi rritjen më të lartë prej 11.1 përqind. Perspektiva e zhvillimeve potenciale në nivelin e çmimeve përcjellët me pasiguri të shumta, subjekt kryesisht i vazhdimit të luftës në Ukrainë: magnitudës së ndikimit të kësaj krize në çmimet e mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare si nafta, gazi dhe ushqimet; mekanizmave transmetues të politikave më të shtrënguara monetare; ndikimit të sanksioneve ekonomike ndaj Rusisë si bojkoti i importit të gazit nga vendet e eurozonës – varësisht sa do arrihet të sigurohet mbulueshmëri e varësisë së lartë që kanë nga gazi rus. Këto dinamika që pritet të përcaktojnë trajektoren e inflacionit në eurozonë do të reflektohen edhe në ekonominë e Kosovës. Sipas parashikimeve të BQK-së, bazuar në skenarin bazë, shkalla mesatare vjetore e inflacionit në vitin 2022 pritet të jetë 10.4 përqind, ndërkohë që edhe pritet të bankave komerciale⁸ sugjerojnë nivel më të lartë të inflacionit krahasuar me vitin paraprak. Marrë parasysh pasiguritë e larta që mbartë kriza e luftës në Ukrainë, BQK ka realizuar dizajnuar edhe dy skenar shtesë për shkallën e BPV-së reale dhe shkallën e inflacionit, skenar të paraqitur në kutinë 1.

⁸ Bankat raportojnë në BQK për pritjet e tyre lidhur me inflacionin në frekuencë tremujore dhe për tërë vitin.

Kutia 2. Ndikimi i luftës në Ukrainë në aktivitetin ekonomik të Kosovës sipas skenarit bazë dhe dy skenarëve alternativë

Lufta në Ukrainë ka ndikuar në rritjen e rreziqeve për perspektivën ekonomike si për eurozonën, ashtu edhe për rajonin dhe Kosovën. Kosova ka ekspozim shumë të ulët ndaj vendeve të përfshira në konflikt, ndaj edhe ndikimi direkt i luftës në ekonominë tonë mbetet i kufizuar. Megjithatë, pasojat që po prodhon lufta veçanërisht në aspekt të amplifikimit të presioneve inflacioniste dhe çekuilibrit të kërkesës së përgjithshme janë reflektuar edhe në ekonominë e vendit. Marr parasysh pasigurinë e larta që ka shkaktuar lufta në Ukrainë, si në aspekt të sjelljes së tregjeve ndërkombëtare ashtu edhe të politikave të pritura monetare për të evituar stagflacionin e pritur, BQK ka rishikuar parashikimet ekonomike përkitazi dhe ka dizajnuar dy skenar shtesë më të rënduar që do të analizohen në vazhdim.

Skenari bazë është ndërtuar mbi supozimet se ndikimet negative të kësaj lufte janë të përkohshme dhe se zinxhirët e furnizimit global nuk preken ndjeshëm. Në projeksionet e realizuara në fillim të vitit 2022 është parashikuar ngadalësim i rritjes së aktivitetit ekonomik dhe normalizim në rritjen mesatare pesëvjeçare prej 3.3 përqind për vitin 2022 (10.5 përqind në 2021). Megjithatë, rritja e rreziqeve të përgjithshme makroekonomike me fillimin e luftës dhe pasojat që ajo ka prodhuar veçanërisht përmes presioneve të rritura inflacioniste, kanë rezultuar në rishikim të projeksionit bazë në 3.0 përqind. Sa i përket inflacionit, fillimisht BQK ka parashikuar një shkallë inflacioni prej 5.1 përqind për vitin 2022. Ndryshimi i dinamikave dhe rritja e vazhdueshme e të gjitha indekseve të çmimeve në vend ka detyruar BQK-në që të rishikoj skenarin bazë në 11.0 përqind për vitin 2022 dhe 6.2 përqind për vitin 2023.

Rritja e çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare në magnitudë që në vijimësi ka tejkaluar pritjet e BQE-së dhe bankave të vendeve të Ballkanit Perëndimor ka rritur ndjeshëm perceptimin mbi rrezikun e përgjithshëm makroekonomik në vend. Për pasojë, BQK ka dizajnuar dy skenarë alternativ të perspektivës ekonomike për vitet 2022 dhe 2023 (skenari i moderuar dhe skenari i rënduar). Në këta skenarë është supozuar se lufta do të zgjasë më shumë se në skenarin bazë, duke u shtrirë edhe në vitin 2023.

Skenari i moderuar. Ndikimi i luftës në Ukrainë i kombinuar me sanksionet shtesë ndaj Rusisë dhe embargoja e gazit dhe naftës ruse nga vendet e BE-së pritet të krijoj kufizime të theksuara të furnizimit. Një mungesë e tillë e furnizimit pritet të ndikoj në rritjen shumë më të lartë të çmimeve të mallrave bazë në muajt në vijim (ushqimit, naftës dhe gazit), me pasojë negative edhe në prodhimin industrial. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në eurozonë, përveç ndikimit të drejtpërdrejtë në kërkesën e jashtme, do të reflektohet edhe në kërkesën e brendshme meqenëse pritet të ndikojë një ndër burimet kryesore të financimit të aktivitetit ekonomik – të ardhurat nga diaspora⁹.

Sa i përket projektimit të çmimeve, simulimet janë realizuar duke marrë për bazë supozime të mbështetura në komunikimin e bankave qendrore, institucioneve financiare ndërkombëtare dhe raportimeve të agjencioneve tjera relevante si Agjencia e Ushqimit dhe Bujqësisë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (FAO). Në Kosovë, janë marrë për bazë edhe intervista të akterëve relevant për çmimin e bukës, vajit të lulediellit dhe të naftës, si produktet më të ndikuara nga pasojat e luftës në Ukrainë. Sipas skenarit të moderuar, çmimi i bukës do të ishte për 9.3 pikë përqindje më i lartë krahasuar me skenarin bazë në vitin 2022. Tutje, Ukraina dhe Rusia janë prodhuesit kryesor të vajit të lulediellit në botë. Kufizimet në ofertë nga vendet tjera prodhuese apo ndërmjetësuese në këto produkte për të mirëmbajtur kërkesën e përgjithshme në vendet e tyre ka ndikuar në rritje të mëtejme të këtyre produkteve bazë. Sipas skenarit të moderuar, çmimi i vajit ushqimor do të ishte për 58.2 pikë përqindje më i lartë krahasuar me skenarin bazë. Sa i përket derivateve të naftës, çmimi do të ishte për 23.2 pikë përqindje më i lartë krahasuar me skenarin bazë. Planet e administratës amerikane janë që të inkurajoj rritjen e prodhimit vendas dhe derisa kjo rritje të ndodhë, ka vendosur që të furnizoj tregun me rreth 1 milionë barel naftë në baza ditore nga rezervat strategjike. Kjo sasi e liruar e rezervave shtetërore, që është sasia më e madhe historikisht, do të realizohet deri në fund të vitit dhe pritet të frenoj rritjen e çmimit të naftës. Duke pasur parasysh vazhdimin e luftës në Ukrainë, bujqit atje do të kenë rendimente më të dobëta edhe në vitin e ardhshëm andaj është supozuar se çmimi i bukës, vajit të lulediellit por edhe i naftës në vitin 2023 do të rritej akoma më shumë (tabela 1).

⁹ Të ardhurat nga diaspora janë në formë të remitencave, investimeve (kryesisht në patundshmëri) por edhe shpenzimet që diaspora i bënë gjatë qëndrimit në Kosovë.

Tabela 1. Supozimi i çmimeve të caktuara në skenarin e moderuar (vlerat janë në euro)

Përshkrimi	Bukë e bardhë e zakonshme, 500 gr	Vaj ushqimor luledielli - Floil, 1 lit	Dizel, 1 lit
2021	0.45	1.75	1.20
2022	0.55	3.10	2.00
2023	0.70	3.30	2.50

Burimi: BQK.

Skenari i rënduar. Përveç supozimeve të përfshira në skenarin e moderuar, në skenarin e rënduar është simuluar një rritje më e madhe dhe e vazhdueshme e çmimeve si pasojë e luftës dhe intensifikimit të rreziqeve. Skenari i reduktimit të vazhdueshëm të stoqeve dhe rezervave në vitet e përfshira në skenarë si pasojë e rrezikut të mosarritjes së zëvendësimit të produkteve bazë nga Rusia dhe Ukraina në muajt në vazhdim (gazit, naftës dhe inputeve kryesore në bujqësi) po duket i mundshëm gjithnjë e më shumë. Si rezultat, tregu do të balancohet në nivele më të larta të çmimeve dhe në një mjedis të përgjithshëm inflacionist materializohen edhe efekte më të mëdha të raundit të dytë të inflacionit. Në kuadër të këtij skenari është supozuar se çmimi i bukës do të ishte për 27.9 pikë përqindje më i lartë krahasuar me skenarin bazë ndërsa çmimi i vajit ushqimor dhe naftës do të ishte për 66.9 përkatësisht 43.5 pikë përqindje më i lartë se sa në skenarin bazë (tabela 2).

Tabela 2. Supozimi i çmimeve të caktuara në skenarin e rënduar (vlerat janë në euro)

Përshkrimi	Bukë e bardhë e zakonshme, 500 gr	Vaj ushqimor luledielli - Floil, 1 lit	Dizel, 1 lit
2021	0.45	1.75	1.20
2022	0.60	3.30	2.70
2023	0.90	3.60	4.00

Burimi: BQK.

Nëse këto supozime do të materializoheshin, inflacioni do të arrinte nivele shumë të larta në vitin 2022 në dy skenarët, por do të ulëj në mënyrë progresive në vitin 2023 në nivelin prej 3.2 përqind në skenarin e moderuar dhe në nivelin prej 4.3 përqind në skenarin e rënduar. Niveli i inflacionit është dukshëm më i lartë krahasuar me skenarin bazë pasi që shporta e konsumatorit kosovar ka një pjesëmarrje të lartë të kategorive të cilat janë duke shënuar rritje më të lartë të çmimeve. Më shumë se gjysma e shportës së konsumatorit kosovar përbëhet nga dy kategoritë më shumë të ndikuara nga kriza - ushqimi (41%) dhe transporti (18%), andaj pesha që kanë këto kategori në shportën e përgjithshme të konsumit ka ndikuar që shkalla e inflacionit në Kosovë të jetë më e lartë krahasuar me vendet të cilat kanë një pjesëmarrje më të ulët të këtyre produkteve. Në këtë mënyrë, efektet inflacioniste për shkak të rritjes së çmimeve arrijnë të jenë më të larta për 8.5 pikë përqindje në vitin 2022 në

skenarin e moderuar dhe 13.3 pikë përqindje në skenarin e rënduar krahasuar me skenarin bazë. Në vitin 2023, presionet inflacioniste janë më të ulëta se në skenarin bazë kryesisht për shkak të bazës më të lartë në vitin 2022. Tutje, rritja e çmimeve pritet të ndikoj në dobësimin e kërkesës së përgjithshme në vend dhe për pasojë në dobësimin e aktivitetit ekonomik.

Tabela 3. Skenarët alternativë makroekonomikë (ndryshimet vjetore në përqindje)

Përshkrimi	2021	2022	2023
Skenari bazë			
Inflacioni	3.35	11.02	6.16
BPV	10.53	3.02	4.07
Skenari i moderuar			
Inflacioni	3.35	19.53	3.22
BPV	10.53	-6.28	6.52
Skenari i rënduar			
Inflacioni	3.35	24.33	4.31
BPV	10.53	-11.04	5.51

Burimi: BQK.

Ndikimi i përgjithshëm në rritjen reale të BPV-së është dukshëm negativ në të dy skenarët, me një efekt më të madh në skenarin e rënduar (tabela 3). Nën skenarin e moderuar, ku kërkesa e jashtme është më e dobët ndërkohë që rreziqet që shoqërojnë prodhimin dhe çmimet e mallrave bazë janë të larta, rënia e BPV-së reale do të ishte rreth 6.3 përqind në 2022 apo 9.3 pikë përqindje më e ulët krahasuar me skenarin bazë. Në vitin 2023, rritja e BPV-së sipas këtij skenari do të ishte rreth 6.5 përqind apo 2.5 pikë përqindje më e lartë se në skenarin bazë. Në skenarin e rënduar, shtesë supozimeve në skenarin e moderuar, çmimet më të larta çojnë në një rënie dukshëm më të lartë të BPV-së reale në vitin 2022 (-11.0 përqind) ndërsa në vitin 2023, BPV do të rikthehej në një rritje prej 5.5 përqind.

Megjithatë, këta skenarë nuk marrin parasysh faktorë të tjerë me rëndësi që mund të kenë ndikim të rëndësishëm në aktivitetin ekonomik dhe në nivelin e inflacionit. Në veçanti, këta skenarë janë përgatitur sipas të njëjtave supozime fiskale. Përveç mallrave të përfshira në skenarë, çmimet e mallrave të tjera dhe disa çmime të metaleve gjithashtu mund të ndikohen nga konflikti duke pasur parasysh rolin e Rusisë dhe Ukrainës në furnizimet globale të këtyre mallrave.

Sektori fiskal gjatë vitit 2021 u karakterizua me rritje të të hyrave buxhetore për 27.1 përqind dhe rritje të shpenzimeve buxhetore për 2.3 përqind. Si pasojë e rritjes shumë të lartë të të hyrave buxhetore, deficitit buxhetor ishte shumë i ulët, duke rënë në 0.9 përqind të BPV-së nga 7.2 përqind sa ishte në vitin 2020. Me rritje prej 13.1 përqind u karakterizua edhe borxhi publik, që arriti vlerën prej rreth 1.7 miliardë euro. **Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 23.3 përqind nga 22.4 përqind sa ishte në vitin 2020.** Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 15.0 përqind (i cili ka arritur në 1.1 miliardë euro), si dhe rritjes së borxhit të jashtëm publik prej 9.6 përqind duke arritur në 576.4 milionë euro. Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së nevojave të buxhetit për të përballuar rritjen e shpenzimeve të shkaktuara nga pandemia Covid-19.

Rikuperimi i aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2021 ka ndikuar në rritjen e deficitit të llogarisë rrjedhëse të bilancit të pagesave për 42.5 përqind, duke arritur vlerën prej 673.0 milionë euro. Në raport me BPV-në, deficitit i llogarisë rrjedhëse ka arritur në 8.6 përqind (7.0 përqind në vitin 2020). Rritja e deficitit të llogarisë rrjedhëse ishte si rezultat i rritjes së lartë të deficitit të mallrave, ndërkohë që bilanci i shërbimeve dhe ai i të ardhurave parësore dhe dytësore janë përmirësuar.

Rritja e importit të mallrave, si pasojë e rritjes së kërkesës së përgjithshme në vend ka ndikuar në rritjen e deficitit të mallrave prej 38.3 përqind (9.4 përqind rënie në vitin 2020), përderisa vlera e shënuar e deficitit ishte rreth 3.9 miliardë euro. Vlera e importit të mallrave ishte 4.7 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 41.1 përqind (5.7 përqind rënie në 2020). Me rritje janë karakterizuar të gjitha kategoritë e importit, ndërsa rritja më e lartë është shënuar tek importi i produkteve minerale (kryesisht derivate të naftës), metaleve bazë, mjeteve të transportit, makinerive të ndryshme si dhe artikujt ushqimor. Të gjitha këto kategori u karakterizuan me rritje të theksuar të

çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Eksporti i mallrave shënoi rritje për 57.8 përqind duke arritur vlerën prej 749.7 milionë euro. Rritja e eksportit të mallrave ishte më e theksuar tek metalet bazë, plastika dhe goma – si kategori që dominojnë strukturën e eksporteve, pasuar nga produktet minerale, artikujt ushqimor, pijet dhe duhani, etj.

Në kuadër të bilancit të pagesave, tregtia me shërbime ishte komponenta që shënoi rritjen më të madhe si pasojë e lehtësimit të masave kufizuese të ndërmarra për të menaxhuar me krizën shëndetësore. Komponenta e shërbimeve kishte një bilanc prej 1.1 miliardë euro (në vitin 2020 dhe 2019 bilanci i shërbimeve ishte 391.6 përkatësisht 926.0 milionë euro). Vlera e shërbimeve të eksportuara ishte 2.0 miliardë euro gjegjësisht 96.4 përqind më e lartë krahasuar me vitin 2020 (16.7 përqind më e lartë krahasuar me vitin 2019), përderisa vlera e shërbimeve të importuara ishte 870.7 milionë euro apo 44.3 përqind më shumë krahasuar me vitin 2020 (16.2 përqind më e lartë krahasuar me vitin 2019). Eksporti i shërbimeve ka një pjesëmarrje prej 25.0 përqind në BPV-në e vendit dhe përbëhet kryesisht nga shpenzimet e diasporës gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë. Rritja e vizitave të diasporës në Kosovë me lehtësimin e masave kufizuese ka ndikuar që eksporti i shërbimeve të udhëtimit të arrijë vlerën prej 1.5 miliardë euro, një rritje vjetore prej 137.3 përqind (12.8 përqind rritje kundrejt vitit 2019). Gjithashtu, edhe eksporti i shërbimeve të transportit, eksporti i shërbimeve kompjuterike si dhe eksporti i shërbimeve të ndërtimit u karakterizuan me rritje të lartë. Dinamika të ngjashme karakterizuan edhe importin e shërbimeve, ku rritjen më të madhe e shënuan shërbimet e udhëtimit, shërbimet e transportit, shërbimet e sigurimit si dhe shërbimet kompjuterike.

Për të minimizuar pasojat e krizës pandemike në ekonomi, vendet ku është e koncentruar diaspora kosovare ndërmorën politika monetare, financiare e fiskale, që rezultuan në ruajtën e mirëqenies dhe performancës së përgjithshme të këtyre ekonomive. Impakti që

kishin lehtësirat financiare në vendet e BE-së u përkthyen jo vetëm në ardhje më të madhe të diasporës Kosovare në vitin 2021, por edhe në rritje të të hyrave të dërguara nga këto vende. **Remitencat arritën vlerën prej rreth 1.15 miliardë euro në vitin 2021 dhe shënuan rritje vjetore prej 17.7 përqind (35.4 përqind rritje kundrejt vitit 2019) duke arritur në 14.8 përqind të BPV-së.** Flukset hyrëse të remitencave janë karakterizuar me rritje të lartë gjatë gjithë vitit, me përjashtim të tremujorit të fundit kur shënuan një ngadalësim të rritjes. Duke pasur parasysh fluksin më të madh të diasporës që e vizituan Kosovën, remitencat që vijnë përmes “kanalit jo-formal” kanë shënuar rritjen më të lartë prej 86.3 përqind. Remitencat përmes bankave shënuan rritje prej 26.5 përqind, ndërsa remitencat përmes operatorëve që transferojnë para shënuan rënie për 1.2 përqind.


IHD-të në Kosovë arritën vlerën prej 415.3 milionë euro në vitin 2021, që përkon me një rritje vjetore prej 20.1 përqind (63.1 përqind rritje kundrejt vitit 2019). Rritja e IHD-ve u evidentua kryesisht tek sektori patundshmërive si sektori me pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej strukturën e IHD-ve, pastaj në sektorin e informacionit dhe komunikimit, ndërtimtarisë, etj., ndërsa IHD-të në sektorin e energjetikës, aktivitetëve financiarë, etj., shënuan rënie. IHD-të në sektorin e patundshmërisë rezultojnë të kenë rritur pjesëmarrjen në 92.6 përqind të gjithsej IHD-ve në vitin 2021, nga 58.2 përqind sa e kishin në vitin 2020. Në anën tjetër, pjesëmarrja e aktivitetëve financiarë në gjithsej IHD-të është zvogëluar në 6.0 përqind nga 24.6 përqind në vitin 2020. Rënia e investimeve në këtë sektor kryesisht ndërlihdjet me shpërndarjen e dividendës.

3.2. Pozicioni financiar i ndërmarrjeve

Treguesit ekonomik dhe financiarë të ndërmarrjeve sugjerojnë për rritje të konsiderueshme të vëllimit të prodhimit industrial dhe të qarkullimit në tregtinë me pakicë gjatë vitit 2021, pas rënies që i karakterizoi në vitin 2020.

Indeksi i peshuar i vëllimit të prodhimit industrial, që paraqet ecurinë e prodhimit të ndërmarrjeve në katër sektorë të industrisë, ka shënuar rritje për 19.3 përqind në vitin 2021. Rritja më e lartë është shënuar tek furnizimi me ujë (44.5 përqind), pasuar nga industria përpunuese (21.7 përqind), industria nxjerrëse (14.3 përqind) dhe sektori i furnizimit me rrymë (10.4 përqind) (grafik 10).


Grafik 10. Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial (2017=100)



Burimi: ASK.

Edhe indeksi i qarkullimit në tregtinë me pakicë ka shënuar rritje dyshifrore prej 10.4 përqind. Pothuajse të gjithë sektorët shënuan rritje të lartë, me përjashtim të tregtisë me pakicë të produkteve ushqimore dhe karburantit për automjete që shënuan rënie prej 7.0 përkatësisht 0.4 përqind (grafik 11).

Grafik 11. Indeksi i qarkullimit në tregtinë me pakicë (2015=100)




Burimi: ASK.

Si rezultat i përmirësimit të aktivitetit ekonomik, iniciativa ndërmarrëse është rritur. Në vitin 2021 u regjistruan 10,649 ndërmarrje apo 8.6 përqind më shumë krahasuar me vitin 2020, ndërsa u mbyllën 1,608 ndërmarrje apo 21.3 përqind më shumë krahasuar me vitin 2020. Sektorët të cilët shënuan rritjen më të lartë në numrin e ndërmarrjeve të regjistruara ishin kryesisht sektorët të cilët u ndikuan më

së shumti nga lehtësimi i masave kufizuese të qeverisë, masa që mundësuan lëvizjen e lirë. Numri i ndërmarrjeve të regjistruara në sektorin e tregtisë shënoi rritje për 19.4 përqind, hotelarisë për 17.9 përqind, aktivitete profesionale për 5.9 përqind, etj., ndërkohë që kishte edhe sektorë në të cilët është shënuar rënie e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara (grafik 12).

Borxhi i ndërmarrjeve ndaj institucioneve financiare vendore dhe të jashtme është rritur me ritëm të përshpejtuar. Gjithsej borxhi i ndërmarrjeve shënoi rritje vjetore prej 19.6 përqind në vitin 2021 (grafik 13) dhe arriti në 43.3 përqind të BPV-së.

Grafik 12. Ndryshimi vjetor në numrin e ndërmarrjeve të reja




Burimi: ASK.

Borxhi i brendshëm, përkatësisht borxhi i ndërmarrjeve ndaj institucioneve kredidhënëse në vend është rritur për 13.8 përqind (6.8 përqind rritje në vitin 2020), si rezultat i rritjes së kredive bankare prej 13.6 përqind por edhe rritjes prej 17.8 përqind të kredive të lëshuara nga ndërmjetësit tjerë financiarë, të cilat kanë peshë të vogël (3.4 përqind) në gjithsej borxhin e ndërmarrjeve ndaj sektorit financiar. Borxhi i jashtëm i ndërmarrjeve ka shënuar rritje edhe më të lartë (36.9 përqind), kryesisht për shkak të rritjes kredive tregtare, dhe ka arritur në 28.6 përqind të gjithsej borxhit nga 25.0 përqind sa ishte në vitin 2020.

Rritja e kreditimit të ndërmarrjeve nga sektori bankar ka kontribuar në rritjen shkallës së ndërmjetësimin financiar. Raporti i kreditimit të ndërmarrjeve nga institucionet kredidhënëse në vend ndaj BPV-

së arriti në 30.9 përqind në vitin 2021 (28.2 përqind në 2019, si vit parapandemik). Kjo rritje e raportit të kreditimit ndaj BPV-së ka bërë që hendeku i kredisë ndaj BPV-së të jetë pozitiv.¹⁰

Grafik 13. Borxhi i ndërmarrjeve



Burimi: BQK.

Pozicioni neto debitor i ndërmarrjeve ndaj sektorit bankar shënoi rritje prej 10.3 përqind (4.2 përqind rritje në vitin 2020). Depozitat e ndërmarrjeve shënuan normë të rritjes prej 19.3 përqind, ndërsa norma e rritjes së kreditimit për sektorin e ndërmarrjeve ishte 13.8 përqind. Pra, përkundër rritjes më të lartë të depozitave, volumi shumë më i madh i kredive për ndërmarrjet ka ndikuar në rritjen e pozicionit debitor të ndërmarrjeve ndaj sektorit bankar. Në aspektin valutor, sektori i ndërmarrjeve ka pozicion neto kreditor ndaj sektorit bankar, si rezultat i nivelit më të lartë të depozitave në valutë krahasuar me kreditë. Sidoqoftë, pozicioni në valutë mbetet i ulët pasi që pjesëmarrja e depozitave në valutë ndaj gjithsej depozitave ishte vetëm 2.9 përqind ndërsa kreditë në valutë për ndërmarrjet ishin jo-ekzistente gjatë vitit 2021.


Kreditë e reja për ndërmarrjet shënuan rritje për 10.4 përqind në vitin 2021 (4.4 përqind rritje në vitin 2020). Sipas qëllimit, kreditë e reja jo-investuese shënuan rritje prej 41.9 përqind dhe rritën pjesëmarrjen në strukturë nga 33.2 përqind në 42.6 përqind të gjithsej kredive të reja për ndërmarrjet. Kreditë e reja investuese shënuan rënie prej 6.6 përqind dhe e zvogëluan pjesëmarrjen në strukturë nga 64.6 përqind në 54.7 përqind të gjithsej kredive të reja për ndërmarrjet. Në

¹⁰ Hendeku i kreditimit i kalkuluar me filterin Hodrick-Prescott.

aspektin e maturimit, kreditë me maturitet mbi 5 vite përbëjnë rreth 24.2 përqind të kredive të reja, kategori që shënoi rënie prej 2.1 përqind. Kreditë mbi 2 vite deri në 5 vite, si kategoria kryesore, rritën pjesëmarrjen nga 44.7 përqind në 48.5 përqind në strukturën e përgjithshme të kredive të reja për ndërmarrjet.

Huamarrja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme është mbështetur edhe nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), i cilit ka shënuar trend të vazhdueshëm të rritjes. Në dhjetor 2021, numri i kredive të garantuara nga FKGK ishte 10,064 ndërsa shuma e miratuar e garancive arriti në 221.8 milionë euro (grafik 14). Struktura e kredive të garantuara është përfaqësimit i strukturës së përgjithshme të kredive të sektorit bankar, ku dominojnë kreditë për sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, pasuar nga sektori i shërbimeve dhe ai i prodhimit. Sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë kishte përfaqësimit prej 8 përqind në gjithsej portfolion e kredive të garantuara.

Grafik 14. Kreditë e aprovuara dhe të garantuara nga FKGK




Burimi: FKGK.

Dinamikat e ndryshuara gjatë këtyre viteve të pandemisë kanë fuqizuar rolin e FKGK-së në mbështetjen e rimëkëmbjes ekonomike përmes lehtësimit të qasjes në financa, ku në vitin 2020, FKGK në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës dhe donatorë ndërkombëtar lansuan Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike, e cila përfundoi me 31 dhjetor 2021. Kjo pako përbënte një linjë të re garantuuese për mbështetjen e qasjes në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme përmes garantimit të kredive.

Kjo pako i ka mundësuar FKGK-së rritjen e mbulueshmërisë me garanci kreditore nga 50 përqind në 80 përqind, duke ofruar më shumë siguri bankave që në këtë mënyrë të rrisin kreditimin dhe ta zvogëlojnë mungesën e likuiditetit në treg. Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike kryesisht ka mbështetur kreditimin në sektorin e prodhimit, agrobiznesit, shërbimeve, tregtisë, me fokus të veçantë gratë në biznes, bizneset e reja dhe investimet në efikasitet të energjisë. Gjithashtu, gjatë vitit 2021 janë nënshkruar disa marrëveshje financiare për mbështetje të sektorit privat. Me Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW) është nënshkruar marrëveshja në vlerë prej 6.0 milionë euro për të mbështetur sektorin privat veçanërisht në efikasitetin e energjisë, efikasitetin e burimeve dhe investimet në energjinë e rinovueshme. Gjithashtu, janë nënshkruar marrëveshje të garancisë me tri institucione mikrofinanciare për garantimin e kredive bujqësore, të cilat do të jenë një shtysë e madhe në rritjen e kreditimit për bujqit dhe fermerët dhe në këtë mënyrë rritjen e përfshirjes financiare në Kosovë.

Grafik 15. Normat e interesit për ndërmarrjet




Kostoja e huamarrjes për ndërmarrjet ka shënuar rënie krahasuar me vitin paraprak. Norma mesatare e interesit në kreditë e reja të sektorit bankar për ndërmarrjet ishte 5.9 përqind në vitin 2021, që paraqet një rënie të lehtë krahasuar me normën prej 6.0 përqind në vitin 2020, kryesisht si rezultat i rritjes së presioneve të konkurrencës në treg. Në anën tjetër, norma mesatare e interesit në depozitat e afatizuara

ka shënuar rritje prej 1.7 përqind në vitin 2020 në 1.8 përqind në vitin 2021 (grafik 15).

3.3. Pozicioni financiar i ekonomive familjare

Borxhi i ekonomive familjare, sikurse ai i ndërmarrjeve, është rritur me ritëm të përshpejtuar. Gjithsej borxhi i ekonomive familjare shënoi rritje prej 17.9 përqind në vitin 2021 dhe arriti në 20.5 përqind të BPV-së. Borxhi i brendshëm ndaj sektorit bankar ka shënuar rritje prej 18.5 përqind, ndërsa borxhi ndaj institucioneve mikrofinanciare shënoi rritje për 15.8 përqind. Në anën tjetër, borxhi i jashtëm i ekonomive familjare, i cili ka një pjesëmarrje të ulët në gjithsej borxhin e ekonomive familjare (2.8 përqind), ka shënuar rritje prej 5.7 përqind (grafik 16).

Grafik 16. Borxhi i ekonomive familjare




Burimi: BQK.

Kreditë e reja të lëshuara nga sektori bankar për ekonomitë familjare shënuan rritje të lartë. Gjithsej rritja e borxhit të ri ndaj bankave ishte më e lartë për 45.0 përqind krahasuar me vitin 2020. Sipas qëllimit, kreditë e reja hipotekare shënuan rritje për 56.5 përqind, kreditë konsumuese (68.3 përqind e gjithsej kredive të reja ndaj ekonomive familjare) shënuan rritje për 40.3 përqind dhe kreditë investuese për 24.4 përqind.

Neto pozicioni kreditor i ekonomive familjare ndaj sektorit bankar shënoi rritje si rezultat i përshpejtimit të rritjes së depozitave.


Grafik 17. Depozitat e ekonomive familjare



Burimi: BQK

Depozitat e ekonomive familjare arritën vlerën prej 3.4 miliardë euro¹¹, që paraqet rritje vjetore prej 14.6 përqind (grafik 17). Gjithashtu, kreditë vazhduan rritjen prej 18.5 përqind dhe arritën vlerën 1.4 miliardë euro. Si rezultat, pozicioni kreditor që tradicionalisht e kanë ekonomitë familjare ndaj sektorit bankar shënoi rritje prej 12.0 përqind. Sa i përket neto pozicionit në valutë, sektori i ekonomive familjare ka shënuar rritje të pozicionit të tij kreditor për 13.7 përqind, si rezultat i rritjes së depozitave në valutë prej 13.3 përqind, përderisa kreditimi në valutë që ka një pjesëmarrje prej vetëm 0.2 përqind të gjithsej kredive për ekonomitë familjare shënoi rënie prej 7.7 përqind.

Grafik 18. Normat e interesit për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Kursimet e ekonomive familjare në formë të depozitave të transferueshme, depozitave të afatizuara dhe depozitave të kursimit shënuan rritje. Rritja e depozitave të ekonomive familjare, mund t'i atribuohet ndër të tjera, rritjes së të hyrave në

¹¹ Përfshirë depozitat në valutë, të konvertuara në vlerë ekuivalente në euro.

ekonomi (rritjes së remitencave, tërheqjes së 10 përqindëshit të kursimeve pensionale në FKPK-së në fund të vitit 2020, etj.). Në anën tjetër, gjatë vitit 2021 norma e interesit në depozita ka shënuar një rënie të lehtë dhe kjo mund të ketë ndikuar negativisht kursimet dhe afatizimin e mjeteve (grafik 18).

Gjithsej depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje prej 14.6 përqind (12.9 përqind rritje në vitin 2020). Depozitat e afatizuara shënuan rritje prej vetëm 1.1 përqind, ku norma mesatare e interesit në depozitat e afatizuara ishte 1.19

përqind apo 0.24 pikë përqindje më e ulët krahasuar me vitin 2020. Depozitat e kursimit shënuan rritje prej 13.8 përqind ndërkohë që norma e interesit në depozita të kursimit ishte 0.29 përqind (0.35 përqind në vitin 2020). Kostoja e borxhit të ri të ekonomive familjare shënoi rënie të lehtë, ndikuar nga presionet konkurruese. Norma mesatare e interesit në kreditë e reja konsumuese prej 6.7 përqind në vitin 2020 zbriti në 6.4 përqind në vitin 2021. Ndërsa, norma e interesit tek kreditë investuese u rrit në 9.8 përqind nga 9.7 përqind sa ishte në vitin 2020.

Tabela 3. Borxhi ndaj bankave dhe performanca e ekonomive familjare

Përshkrimi	2018	2019	2020	2021
Borxhi i ekonomive familjare ndaj bankave (në milionë)	1,001.1	1,104.7	1,182.2	1,401.2
prej të cilave në valutë	2.6	2.6	2.3	2.2
Depozitat e ekonomive familjare në banka (në milionë)	2,334.2	2,601.9	2,937.1	3,366.1
prej të cilave në valutë	140.4	138.5	155.4	176.1
Neto pozicioni ndaj bankave (Pozicioni kreditor) në milionë	1,333.1	1,497.3	1,754.9	1,964.9
Mesatarja e vlerës së kredisë për të punësuar	2,900.8	3,041.6	3,406.3	4,037.3
Shkalla e varësisë ekonomike	268.0%	253.0%	275.0%	264.0%

Burimi: BQK.

Burimet e të ardhurave të ekonomive familjare treguan tendencë rritëse, ku remitencat u rritën për 17.7 përqind ndërsa kompensimi i punëtorëve¹² shënoi një rritje të lehtë prej 0.2 përqind. Deri në mars të vitit 2021, paga mujore neto, sipas Anketës së Fuqisë Punëtore¹³, ishte në intervalin 400 deri në 500 euro. Sa i përket tregut të punës, shkalla pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ishte 39.5 përqind deri në mars 2021 apo 0.7 pikë përqindje më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020.

Shkalla e punësimit është rritur në 29.3 përqind që është për 0.2 pikë përqind më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020. Edhe treguesi i varësisë ekonomike, që paraqet raportin në mes të popullsisë së përgjithshme joaktive (mbi 15 vjeç) dhe punësimit, deri në mars 2021 është zvogëluar në 264 përqind, nga 275 përqind sa ishte në vitin 2020. Në anën tjetër, shkalla e papunësisë është rritur (25.8 përqind) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020.

¹² Të ardhurat nga kompensimi i punëtorëve - të ardhurat e punëtorëve sezonal jashtë vendit si dhe punëtorëve kosovarë jashtë kufirit për një periudhë më pak se një vit.

¹³ Agjencia e Statistikave të Kosovës, <https://ask.rks.gov.net/media/6354/afp-tm1-2021.pdf>

Kutia 3. Ngarkesa me Borxh e Ekonomive Familjare në Kosovë¹⁴

Ngarkesa me borxh e ekonomive familjare paraqet rrezik të drejtpërdrejtë për qëndrueshmërinë e borxhit të ekonomive familjare dhe stabilitetin e sistemit financiar si tërësi, dhe si e tillë gjithnjë e më shumë po zgjon vëmendjen e politik-bërësve. Andaj, me qëllim të sigurimit të një mjedisi të favorshëm për rritjen dhe zhvillimin e sistemit financiar, si dhe për të siguruar

stabilitet financiar, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) në mars 2022, ka publikuar studimin e dytë me radhë për vlerësimin e ngarkesës me borxh të huamarrësve dhe ekonomive familjare respektive, që do të jetë mjet i rëndësishëm për informim të politik-bërjes dhe vendimmarrjes.

Përmes këtij studimi është tentuar të adresohen çështjet e mëposhtme:

Karakteristikat socio-demografike dhe socio-ekonomike të huamarrësve me kredi aktive në institucione bankare dhe mikrofinanciare;

Modelet më të shpeshta të huamarrjes (lloji dhe qëllimi i kredive, vlera e aprovuar e kreditë, kohëzgjatja, përdorimi i kolateralit, bashkë-huamarrja, huamarrja e shumëfishtë në disa institucione);

Karakteristikat e performancës ripaguese dhe faktorët e mundshëm ndikues;

Niveli i ngarkesës me borxh të huamarrësve individual dhe të ekonomive familjare;

Ndikimi i shpërthimit të krizës pandemike COVID-19 në të hyrat dhe nivelin e ngarkesës së huamarrësit dhe ekonomisë së tij familjare.

Studimi është bazuar në mostër që është përzgjedhur nga popullimi i klientëve individual nga të gjitha institucioneve bankare dhe mikrofinanciare në Kosovë, që kishin së paku një kontratë kreditore aktive në RKK në fund të muajit mars 2021. Duke respektuar nivelin e besueshmërisë prej 99% dhe me marginën e gabimit, mostra përfshinte 1,991 klientë individual me 10,738 kontrata kreditore (nga të cilat 5,014 kontrata aktive kreditore).

Burimi kryesor i të dhënave është RKK, platformë në të cilën raportojnë të gjitha institucionet financiare kredidhënëse në baza të rregullta. Megjithatë sigurimi i informacioneve për gjendjen financiare të ekonomisë familjare të huamarrësit respektiv siç janë të hyrat dhe shpenzimet është realizuar përmes kërkesës nga institucionet kredidhënëse. Në të njëjtën kohë janë siguruar gjithashtu të dhëna shtesë socio-demografike të huamarrësve si dhe të dhëna për kreditë, me

qëllim të plotësimit ndërmjet dy databazave (RKK, IF) si dhe krahasimit/vlerësimit të kualitetit të informacionit.

Ngarkesa me borxh e ekonomive familjare nuk ka definicion dhe mënyrë standarde të vlerësimit. Duke theksuar mungesën e konsensusit për indikatorin më të 'mirë', tregues të ndryshëm përdorën për të vlerësuar aspekte specifike të ngarkesës, në mënyrë që të arrihet te një pasqyrë më reale e problematikës. Indikatorët të cilët respektojnë shumicën e parimeve të elaboruara në studime të ndryshme, reflektojnë katër aspekte të ngarkesës si: pjesëmarrjen e lartë të borxhit në raport me të hyrat, vonesat në pagesë, përdorimin e shpeshtë të kredive dhe aspektin subjektiv të konsiderimit të borxhit si barrë e rëndë. Prandaj në këtë studim është bërë vlerësimi i ngarkesës përmes disa prej këtyre treguesve objektiv dhe subjektiv, si dhe është testuar dhe analizuar ndërlidhja mes tyre (tabela 1).

¹⁴ Kutia është pjesë përbleshëse e studimit të realizuar nga BQK "Ngarkesa me borxh e ekonomive familjare në Kosovë", Mars 2022, <https://bqk-kos.org/publikimet/ngarkesa-me-borxh-e-klienteve-bankare-ne-kosove/>

Tabela 1. Treguesit objektiv dhe subjektiv të ngarkesës me borxh

Kategoria	Treguesi	Vlerësimi/Treguesi	Rezultati
Kosto e servisimit të borxhit: Borxhi ndaj të hyrave	Ekonomitë familjare që shpenzojnë më shumë se 50% të hyrave bruto mujore në pagesën e borxhit (të siguruar dhe të pasiguruar)	a) Indeksi i Ngarkesës me Borxh (shuma e kësteve mujore të huave aktive =>50% e të hyrave mujore bruto të huamarrësit); (mostra 1,805) b) Indeksi i Ngarkesës me Borxh (shuma e kësteve mujore të huave aktive =>50% e të hyrave mujore bruto të ekonomisë familjare); (mostra 1,751)	27.4% e huamarrësve shfrytëzojnë mbi 50% të të hyrave në pagesën e kësteve kreditore 11.7% e ekonomive familjare shfrytëzojnë mbi 50% të të hyrave në pagesën e kësteve kreditore
	Ekonomitë familjare që shpenzojnë më shumë se 50% të hyrave bruto mujore në pagesën e borxhit (të siguruar dhe të pasiguruar)	Anketa me ekonomitë familjare (mostra prej 1068 ekonomive familjare)	a) 60.3 përqind e ekonomive familjare nuk posedojnë fare kredi aktive, ndërsa vetëm 1.9 përqind shfrytëzojnë më shumë se 50% të hyrave në pagesën e kredive, ndërsa 4.7 përqind nuk kanë dhënë përgjigje. b) Në kuadër të ekonomive familjare që kishin kredi aktive, 4.8 përqind e tyre shfrytëzojnë më shumë se 50 përqind të të hyrave familjare në pagesën e kësteve kreditore, ndërsa 11.7 përqind nuk kanë dhënë përgjigje.
Vonesat	Ekonomitë familjare me vonesa më shumë se 2 muaj në pagesën e kontratave kreditore	Huamarrësit me vonesa më shumë se 60 ditë (mostra 1,984)	8.5% e huamarrësve kanë vonesa më shumë se dy muaj në pagesën e kësteve kreditore. Shumica e tyre (74.4 %) janë në vonesë mbi 2 muaj në vetëm një kontratë kreditore.
	Ekonomitë familjare me vonesamë shumë se 2 muaj në pagesën e obligimeve të rregullta mujore për shpenzime komunale (uji, energjia elektrike, mbeturinat, tatimi në pronë),	Anketa me ekonomitë familjare (mostra prej 1,068 ekonomive familjare)	9% e ekonomive familjare shpeshherë kanë vonesa më të gjata se 2 muaj në pagesën e këtyre obligimeve; ndërsa 45.7 përqind, kanë deklaruar se vonohen ndonjëherë
Numri i kontratave kreditore	Ekonomitë familjare =>4 kontrata aktive kreditore	Huamarrësit =>4 kontrata aktive kreditore (mostra 1,984)	17.7% e huamarrësve kanë 4 apo më shumë se 4 kontrata aktive kreditore

Burimi: BQK.

Indikatori kryesor i ngarkesës me borxh të huamarrësve dhe ekonomive familjare (rezultatet e të cilit janë elaboruar në vijim) është konsideruar indeksi që mbeshitet vetëm në këstet e huave, duke eliminuar këstet e produkteve tjera kreditore si kreditkartelat dhe mbitërheqjet, për shkak të vështirësive në kuantifikimin e këstit mujor të këtyre produkteve. Kreditkartelat dhe mbitërheqjet, megjithëse mund të jenë burim i vazhdueshëm i borxhit për huamarrësit, me efekt të konsiderueshëm në rritjen e mbingarkesës së tij, kanë mundësi që gjithashtu të reflektojnë gjendje të përkohshme të borxhit (shfrytëzim i njëhershëm i produktit). Në mungesë të informacionit mbi këstet kreditore, vlerësimi i ngarkesës me borxh kur përfshihen pagesat e këtyre produkte kreditore është realizuar nën supozimin se gjithsej borxhit i mbetur në kreditkartelë dhe mbitërheqje është këst mujor. Për shkak të këtij supozimi konservativ, shkalla e huamarrësve të mbingarkuar rezulton shumë më e lartë, dhe konsiderohet e mbiulerësuar (grafik 1).

Rezultatet e studimit sugjerojnë që 27.4 përqind e huamarrësve¹⁵ janë të mbingarkuar me borxh të huave.¹⁶ Ndërsa, kur merren për

bazë të hyrat e tërë njësisë familjare, pjesëmarrja e rasteve të mbingarkesës zbrit në 11.7 përqind.¹⁷

¹⁵ Indeksi kryesor i ngarkesës me borxh për huamarrësin individual është llogaritur për 90.7 përqind të klientëve të mostrës së përzgjedhur, përkatësisht për 1,805 observime.


¹⁶ Mbingarkesa përfshinë rastet kur niveli i borxhit mujor vetëm për huatë (shuma e kësteve mujore të huave, duke mos përfshirë

produktet tjera kreditore si mbitërheqjet dhe kreditkartelat) tejkalon 50 përqind së të hyrave mujore.

¹⁷ Indeksi kryesor i ngarkesës me borxh për ekonomitë familjare është llogaritur për 87.9 përqind të mostrës së huamarrësve, përkatësisht 1,751 observime.

Mbingarkesa me borxh bazuar vetëm në të hyrat e huamarrësit mund të reflektoj mbivlerësim të gjendjes së ngarkesës, për shkak të bashkë-huamarrjeve dhe faktit se ekonomitë familjare bashkojnë të hyrat për të mbuluar shpenzimet. Në anën tjetër, në vlerësimin e mbingarkesës me të hyra të ekonomisë familjare, për shkak të mungesës së informacionit për borxhin e mundshëm të huave të anëtarëve tjerë të familjes, mund të kemi pasqyrë të nënvlerësuar të nivelit të ngarkesës. Andaj, rezultatet e mbingarkesës nuk duhet të interpretohen si vlerësim absolut i gjendjes faktike, por si indikacion i nivelit të përafërt të ekonomive familjare të mbingarkuara me hua në sektorin financiar në Kosovë, i cili konsiderohet të jetë në intervalin ndërmjet 27.4 përqind dhe 11.7 përqind e mostrës së huamarrësve, respektivisht në intervalin e rezultateve nga të dy indikatorët – bazuar në të hyra të huamarrësit dhe atij në të hyra të njësisë familjare.

Grafik 1. Niveli i ngarkesës së huamarrësve dhe ekonomive të tyre familjare



Burimi: BQK.

Në fazën e parë të mbingarkesës - në rrezik për mbingarkesë ngase kësti mujor i huasë përbën 50% deri në 75% së të hyrave mujore - **janë 21.8 përqind të huamarrësve**. Ndërsa, kur merren parasysh të hyrat e gjithë njësisë familjare, në rrezik për mbingarkesë janë 8.2 përqind të ekonomive familjare. **Në fazën kritike** - me raport të borxhit ndaj të hyrave në intervalin 75 deri 100%- **rezultojnë 3.8 përqind e huamarrësve** dhe 2.0 përqind e ekonomive familjare. Rastet kur shpenzimet e kësteve të huamarrësit tejkalojnë plotësisht të hyrat mujore bruto duke kaluar në **gjendje jo-solvente**, paraqiten në **1.8 përqind të mostrës së**

huamarrësve dhe 1.4 përqind të ekonomive familjare (grafik 2a dhe 2b).

Ngarkesa me borxh e huamarrësve dhe ekonomive familjare rezulton më e lartë në periudhën **pas shfaqjes së pandemisë COVID-19**, mesatarisht për nga 2 pikë përqindje për secilën prej kategorive të ngarkesës. Sidoqoftë, këto rezultate nuk reflektojnë plotësisht ndikimin e pandemisë dhe përgjithësisht duhet të merren me rezervë për shkak të mos-konsistencës së periudhës kohore që të dhënat reflektojnë.¹⁸ Gjithashtu, të dhënat pas andemisë nuk janë të plota¹⁹ dhe në shumë raste


¹⁸ Koha e regjistrimit të të hyrave para pandemisë nuk është konsistente ndërmjet institucioneve financiare. Përderisa disa prej tyre kanë raportuar të dhënat në muajin e fundit para shpërthimit të pandemisë, të tjerat kanë raportuar të hyrat e huamarrësve të datës së dhënies/aprovimit të kredisë.

¹⁹ Ndryshimet në këstet kreditore, përkatësisht ristrukturimet, nuk janë të plota. Këstet e ristrukturuara si pasojë e Covid-19 janë

pranuar nga Institucionet Financiare për kreditë aktive të klientëve të tyre (klientëve të përzgjedhur si mostër për institucionin përkatës). Mirëpo, për llogaritjen e borxhit të përgjithshëm të klientit, përkatësisht ekonomisë familjare, janë marrë (mbledhur) të gjitha këstet e të gjitha produkteve kreditore aktive që kanë figuruar në RKK. Andaj, ristrukturimet tjera që huamarrësit mund të kenë pasur në institucione tjera financiare mund të mos jenë reflektuar në RKK.

janë mbledhura në formë të anketimit, që krijojnë hapësirë për subjektivitet. Nga **karakteristikat socio-demografike** që kishin dallime të theksueshme (statistikisht të rëndësishme) në tendencat për mbingarkesë apo vonesë në pagesë të kredive ishin profesioni, grup-mosha, numri i të punësuarve në ekonomi familjare dhe niveli i të ardhurave.

Grafik 2a. Shpërndarja e huamarrësve sipas indeksit kryesor të ngarkesës (produkti hua)




Burimi: BQK.

Në kuadër të modeleve të huamarrjes, të rëndësishme statistikisht rezultuan numri i kontratave kreditore dhe institucioneve huadhënëse, kolateralizimi, ristrukturimi i kredive, historia kreditore, si dhe rolet si bashkë-huamarrës dhe garantues (tabela 1). **Probabiliteti i mbingarkesës është më i larti te huamarrësit me kredi aktive në sektorin bankar dhe mikrofinanciar njëkohësisht.** Ndërsa krahasuar ndaras sipas sektorëve, tendencat për mbingarkesë ishin më të larta për huamarrësit me kredi aktive në sektorin bankar (25.7 përqind të huamarrësve dhe 9.7 përqind të ekonomive familjare respektive, krahasuar me 15.6 përqind të huamarrësve dhe 6.2 përqind të ekonomive familjare të huamarrësit me kredi vetëm në sektorin mikrofinanciar). **Niveli më i lartë i ngarkesës me borxh të huamarrësve asocohet me huamarrjen e shumëfishtë - me posedimin e shumë kontratave aktive kreditore në institucione të ndryshme.**

Huamarrësit e shumëfishtë në institucione të ndryshme kishin pothuajse dy herë më shumë raste të mbingarkesës me borxh (tabela 1). Po ashtu edhe **tendencat më të larta të vonesave në pagesën e kredive ishin në mesin e huamarrësve të shumëfishtë - më shumë se një kontratë kreditore aktive dhe nga**

institucione të ndryshme. Rreth 30.0 përqind e huamarrësve të shumëfishtë, me produkte kreditore në institucione të ndryshme, janë në vonesë, krahasuar me vetëm 2.0 përqind të huamarrësve të shumëfishtë por në të njëjtin institucion. **Rrjedhimisht edhe problemet në performancën e pagesës rezultuan të jenë të ndërlidhura me nivelin më të lartë të ngarkesës me borxh. Huamarrësit me vonesa kishin pothuajse dy herë më shumë raste të mbingarkesës me borxh.**

Grafik 2b. Shpërndarja e ekonomive familjare sipas indeksit kryesor të ngarkesës (produkti hua)



Burimi: BQK.

Vlerësimi i **mbingarkesës me borxh të ekonomive familjare, sipas një ankete të porositur nga BQK**, e realizuar në mostër tjetër të ekonomive familjare, rezultoi më i ulët. Rezultatet e anketës me ekonomi familjare sugjerojnë që 60.3 përqind e ekonomive familjare nuk posedojnë fare kredi aktive. Në kuadër të ekonomive familjare që kishin kredi aktive, vetëm 4.8 përqind e tyre shfrytëzojnë më shumë se 50 përqind të të hyrave familjare në pagesën e kësteve kreditore. Sipas anketës, **shpërthimi i pandemisë COVID-19** ka pasur efekt të ndryshëm në të ardhurat e ekonomive familjare. Një e treta e ekonomive familjare, përkatësisht 35.6 përqind, janë deklaruar se të hyrat e familjes nuk kanë ndryshuar, 31.1 përqind kanë deklaruar se të hyrat e familjes së tyre janë zvogëluar ndërsa pjesa tjetër prej 27.8 përqind kanë thënë që kanë pasur rënie të përkohshme të të hyrave të cilat janë rikthyer në gjendjen paraprake dhe 5.5 përqind kanë deklaruar se të hyrat familjare janë rritur. Përfundimisht tregues të ndryshëm kanë vlerësuar aspekte të ndryshme të mbingarkesës, të cilat së bashku japin informacion të rëndësishëm mbi nivelin e ngarkesës së ekonomive familjare në Kosovë.

Tabela 2. Nivelet e ngarkesës me borxh të ekonomive familjare sipas karakteristikave socio-demografike dhe socio-ekonomike

Karakteristikat socio-demografike dhe socio-ekonomike të huamarrësit individual	Të pa ngarkuar (kësti mujor < 50% e të hyrave të EF)	Të mbingarkuar (kësti mujor > 50% e të hyrave të EF)		
		Në rrezik (borxh/të hyra = 50%-75%)	Në fazë kritike (borxh/të hyra = 75%-100%)	Josolvent (borxh/të hyra = mbi 100%)
Gjinia e huamarrësit respektiv***				
Burrë	87.3%	8.8%	2.2%	1.7%
Grua	91.1%	6.7%	1.4%	0.8%
Statusi martesor i huamarrësit respektiv				
E/l pamartuar	92.3%	6.4%	0.6%	0.6%
Martuar	87.2%	8.6%	2.6%	1.6%
Ve ndarë	81.8%	18.2%	0.0%	0.0%
Lloji vendbanimit***				
Urban	89.4%	7.9%	1.5%	1.2%
Rural	87.3%	8.4%	2.7%	1.5%
Rajoni i huamarrësit respektiv				
Prishtinë	89.5%	8.6%	1.0%	0.8%
Mitrovicë	80.6%	13.1%	3.1%	3.1%
Prizren	90.9%	6.4%	1.7%	1.0%
Ferizaj	92.5%	4.5%	0.8%	2.3%
Gjilan	90.2%	5.3%	1.5%	3.0%
Gjakovë	84.6%	9.2%	5.1%	1.0%
Pejë	88.0%	8.6%	2.4%	1.0%
Profesioni i huamarrësit respektiv				
Forcat e armatosura	80.0%	20.0%	0.0%	0.0%
Menaxherët	85.0%	13.3%	1.7%	0.0%
Profesionistët	88.0%	8.9%	2.4%	0.6%
Teknikët dhe bashkëpunëtorët profesional	92.5%	6.0%	0.5%	1.0%
Punëtorë zyreje dhe asistent	78.6%	17.9%	3.6%	0.0%
Punonjësit e shërbimit dhe shitjes	89.5%	8.4%	1.6%	0.5%
Punëtorët e aftësuar në bujqësi, pylltari dhe peshkatari	83.0%	5.4%	3.6%	8.0%
Punonjësit e zezes dhe profesioneve të ngjashme	90.8%	7.1%	1.4%	0.7%
Operatorët dhe instaluesit në fabrika dhe makina	82.1%	14.3%	0.0%	3.6%
Profesionet elementare	89.8%	6.0%	2.3%	1.9%
Pensioner	71.9%	18.8%	3.1%	6.3%
Shtëpiake	83.3%	8.3%	8.3%	0.0%
Tjera, përfshirë mirëqenien sociale	90.0%	6.0%	4.0%	0.0%
Student	100.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Mosha e huamarrësit respektiv				
< 30 vjet	95.1%	3.9%	0.7%	0.4%
30 - 40 vjet	88.8%	7.7%	2.6%	1.0%
40 - 50 vjet	85.3%	10.2%	2.8%	1.7%
50- 60 vjet	88.3%	8.4%	1.6%	1.6%
> 60 vjet	83.7%	12.6%	1.3%	2.5%
Përvoja e punës e huamarrësit respektiv***				
0-5 vite përvojë pune	91.4%	5.9%	1.3%	1.3%
6-10 vite	87.9%	9.4%	2.0%	0.7%
mbi 10 vite	86.1%	9.9%	2.7%	1.3%
Numri i të punësuarve në ekonomi familjare				
1 (vetëm huamarrësi)	81.9%	13.2%	2.6%	2.3%
2 të punësuar	90.8%	6.2%	2.3%	0.8%
3-5 të punësuar	95.0%	3.8%	0.3%	0.9%
mbi 5 të punësuar	94.4%	2.8%	0.0%	2.8%
Niveli i të hyrave të ekonomisë familjare				
deri në 170 euro	20.0%	20.0%	0.0%	60.0%
170-249 euro	50.0%	21.4%	10.7%	17.9%
250-449 euro	81.6%	13.4%	3.0%	2.0%
450-749 euro	83.5%	12.3%	3.5%	0.8%
750-999 euro	92.2%	6.0%	1.3%	0.6%
1000-2000 euro	95.1%	3.3%	0.6%	1.0%
mbi 2000 euro	92.1%	6.1%	0.6%	1.2%
Lloji i institucionit huadhënës				
Bankë	90.3%	8.0%	1.1%	0.6%
Mikrofinancë	93.8%	4.0%	1.3%	0.8%
Bankë dhe Mikrofinancë njëkohësisht	81.4%	11.4%	3.9%	3.2%
Numri i kontratave kreditore të huamarrësit respektiv				
Shumë kontrata - një institucion kredidhënës	92.5%	6.5%	0.6%	0.4%
Shumë kontrata - disa institucione kredidhënëse	77.8%	13.8%	5.1%	3.4%

***Në këto karakteristika socio-demografike nuk kishte dallime të theksueshme - statistiki të rëndësishme - në tendencat për mbingarkesë

Rezultatet sugjerojnë se mbingarkesa asocohet me huamarrje të shumëfishtë dhe performancë më të dobët të pagesës. Megjithatë, duhet të theksohet se relacioni shkak-pasojë ndërmjet këtyre faktorëve nuk është i përcaktuar, dhe mund të zhvillohet në kahje të ndryshme: posedimi i më shumë kontratave kreditore patjetër ndikon në rritjen e borxhit mujor për pagesë dhe ka ndikim në rritjen e nivelit të ngarkesës me borxh të huamarrësve; megjithatë, ekziston mundësia që huamarrësit të marrin borxh shtesë për servisim të borxhit ekzistues në rastet e pamundësisë së pagesës, dhe në këtë mënyrë të ndikojnë në mbingarkesë.

Mbingarkesa me borxh e ekonomive familjare duke qenë koncept kompleks dhe prezenca e shume faktorëve ndikues në ngarkesën me borxh dhe ndërlidhjes ndërmjet tyre e ka bërë procesin e vlerësimit të ngarkesës mjaft sfidues. Natyra e tillë dhe procesi i vlerësimit i përballur me kufizime të të dhënave bën që rezultatet e studimit të jenë subjekt i disa kufizimeve në aspekt të kualitetit të të dhënave në dispozicion dhe supozimeve të bëra për shkak të mungesave të hasura. Në aspektin e disponueshmërisë së të dhënave janë evidentuar rastet si: mungesa e informacionit për bashkë-huamarrjet që mund të ketë ndikuar në mbivlerësim të ngarkesës së huamarrësit dhe mos-konsistenca e mundshme e kohës së raportimit/azhurnimit të të dhënave për huamarrësin që mund të ndikojnë në nënvlerësimin apo mbi-vlerësimin e ngarkesës aktuale me borxh.

Në aspekt të kualitetit, në mungesë të mekanizmave detyrues për raportim të të dhënave për ekonomitë familjare, rezultatet mbi ekonominë familjare duhet marrë me rezervë (mungesa e informacionit për borxhin e mundshëm të anëtarëve tjerë të njësisë familjare që mund të reflektoj nënvlerësim të mbingarkesës, si dhe rastet, megjithëse të rralla, kur shpenzimet mujore të raportuara për gjithë njësinë e ekonomisë familjare kanë tejkaluar të hyrat mujore të ekonomisë familjare që shprehin dyshimet mbi kualitetin e informacioneve të dhëna).

Kufizimet e shumta në të dhëna për njësinë e ekonomisë familjare, dhe natyra komplekse dhe shumë e rëndësishme e problematikës së mbingarkueshmërisë, theksojnë nevojën për ndërveprim të institucioneve përkatësisht angazhimin e të gjitha palëve relevante në mbledhjen dhe ofrimin e të dhënave cilësore. **Rekomandimet** në lidhje me masa të mundshme që mund të ndërmerren nga palët e interesit, dalin në mënyrë të natyrshme nga gjetjet e studimit, si dhe nga konsultimet e materialeve dhe palëve relevante:




4. Zhvillimet në sistemin financiar

Në linjë me ecuritë në aktivitetin ekonomik, sistemi financiar shënoi rritje të theksuar të aktivitetit gjatë vitit 2021, ku të gjithë sektorët përbërës kontribuan në rritje.

Në dhjetor 2021, vlera e asetëve të sistemit financiar arriti në 8.93 miliardë euro, që përkon me rritje vjetore prej 12.7 përqind (rritje prej 9.1 dhe 14.9 përqind në vitin 2020 dhe 2019, respektivisht). Shkalla e ndërmjetësimit financiar (raporti i asetëve ndaj BPV-së) u zvogëlua për 2 pikë përqindje, në 114.2 përqind, ndikuar kryesisht nga rritja më e lartë e BPV-së së prititur për këtë vit si pasojë e rimëkëmbjes së fuqishme të ekonomisë (grafik 19).

Grafik 19. Pesha e sektorëve të sistemit financiar ndaj BPV-së




Burimi: BQK.

Rritja e asetëve të sektorit bankar kryesisht i atribuohet rritjes së aktivitetit kreditor dhe rritjes së investimeve në letra me vlerë, përderisa rritja e asetëve të sektorit mikrofinanciar i atribuohet kryesisht rikuperimit të aktivitetit kredidhënës dhe përsheptimit të rritjes së lizingjeve. Rritja e kreditimit nga sektori bankar reflektoj riaktivizimin e ekonomisë në vend duke reflektuar besueshmërinë e rifituar dhe realizimin e investimeve të mbajtura pezull që

nga viti 2020. Rritja e asetëve të sektorit pensional u përsheptua gjatë vitit 2021 krahasuar me vitin paraprak, i ndikuar nga kthimi pozitiv nga investimet si dhe nga rritja e kontributeve të arkëtuara gjatë kësaj periudhe. Asetet e sektorit të sigurimeve po ashtu shënuan rritje të përsheptuar. Rritje më të lartë kishte kategoria e depozitave të mbajtura në bankat komerciale (kryesisht në formë të depozitave të afatizuara), pasuar nga investimi në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Grafik 20. Pjesëmarrja e sektorëve përkatës në asetet e sistemit financiar



Burimi: BQK.

Sa i përket numrit të institucioneve financiare, deri në dhjetor 2021 u shtua vetëm numri i institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jo bankare, nga 29 sa ishin në vitin e kaluar në 30 këtë vit. Ndërsa, numri i siguruesve u zvogëlua në 12 për shkak të revokimit të licencës së një prej siguruesve (tabela 4). Ndihmësit financiar kanë numrin më të madh të institucioneve financiare, megjithëse pjesëmarrja e tyre në gjithsej asetet e sistemit financiar vazhdon të qëndroj në 0.3 përqind (grafik 20).

Kapitali i huaj mbizotëron pjesën më të madhe të sektorëve të sistemit financiar, e veçanërisht sektorëve që merren me aktivitet kreditues (grafik 21).

Tabela 4. Numri i institucioneve financiare


Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Bankat komerciale	8	8	9	9	10	10	10	10	10	10	11	11
Kompanitë e sigurimeve	12	13	13	13	14	15	15	15	14	13	13	12
Fondet pensionale	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	28	34	38	39	42	44	40	43	50	50	57	53
Institucionet mikrofinanciare dhe financiare jo-bankare	17	20	17	17	18	18	22	25	29	29	29	30

Burimi: BQK.

Sektori bankar dominohet nga kapitali me prejardhje nga BE, që përbën 52.5 përqind të gjithë asetëve të sektorit. Bankat vendore rritën peshën në gjithë asetet e tregut bankar në 14.5 përqind (13.5 përqind në dhjetor 2020). Bankat me origjinë nga Turqia shënuan rritje të pjesëmarrjes në treg, me një pjesëmarrje prej 16.6 përqind në 2021 (16.1 përqind në 2020).

Rritja në konkurrencën e shërbimeve të ofruara nga bankat u reflektua në uljen e koncentrimin bankar²⁰ në 52.5 përqind nga 55.5 përqind në vitin e kaluar. Sektori i sigurimeve vazhdon të ketë nivel më të ulët të koncentrimin si rrjedhojë e shpërndarjes më të baraspeshuar të asetëve në treg. Sidoqoftë, gjatë tre viteve të fundit shihet një tendencë e rritjes së koncentrimin të asetëve të sektorit të sigurimeve, për shkak të revokimit të licencës së dy siguresve (një në vitin 2019 dhe një në vitin 2021).

Grafik 21. Pronësia e sektorëve përbërës të sistemit financiar, dhjetor 2021



Burimi: BQK.

Kompanitë e sigurimit me kapital vendor përbëjnë 50.2 përqind të gjithë asetëve të sektorit, nga 50.9 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, kompanitë me kapital të huaj me pjesëmarrje prej 49.8 përqind kanë vend të

origjinës Austrinë, Slloveninë dhe Shqipërinë (grafik 21).

Sistemi financiar në Kosovë ka strukturë të thjeshtë të bilancit, përkitazi me modelin tradicional të aktivitetëve, me ndërlidhje të ulët të aktivitetëve ndërmjet sektorëve të sistemit. Sa i përket ndërlidhjeve në sistemin financiar në përgjithësi, ndërlidhja më e madhe vazhdon të qëndroj në mes bankave komerciale dhe BQK-së; megjithatë gjatë vitit 2021 rritje kishte vetëm ekspozimi ndaj Qeverisë Qendrore, saktësisht investimi në letrat me vlerë të Qeverisë nga sektori bankar, pensional dhe ai i sigurimeve. Në kuadër të ndërlidhjeve ndërbankare, me nivel më të lartë vazhdoi të qëndroj ndërlidhja në mes të sektorit bankar dhe bankave amë, si linjë proaktive për rritje të kapacitetit absorbues për humbje të mundshme, si dhe për financim.


Dinamikat në ndërlidhjet mes akterëve të sektorit në vitin 2021 kanë pësuar ndryshim krahas vitit paraprak. Lidhja kryesore me rritjen më të lartë ishte në formë të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës, përderisa në vitet paraprake dominonin lidhjet në formë të depozitave në BQK dhe banka komerciale. Megjithatë, niveli i këtyre ndërlidhjeve vazhdon të jetë i ulët, duke minimizuar kështu mundësitë e bartjes së problemeve dhe rreziqeve nga një institucion në tjetrin.

Ndërlidhja më e theksuar qëndron në mes të bankave komerciale dhe BQK-së, që përfaqësohet në formë të depozitave për rezervën e detyrueshme dhe tepicën e kësaj rezerve që bankat e mbajnë në BQK. Kompanitë e sigurimeve dhe fondet pensionale

²⁰ Shprehur si raport i asetëve të tri bankave më të mëdha ndaj gjithë asetëve të sektorit

po ashtu mbajnë kërkesa, në formë të depozitave (llogarive rrjedhëse) ndaj BQK-së. Sidoqoftë, pesha e kësaj ndërlidhje u zvogëluar në vitin 2021, ku së bashku me bankat komerciale përbënin 46.5 përqind të gjithsej depozitave të BQK-së kundrejt 51 përqind në vitin paraprak.

Figura 1. Ndërlidhjet institucionale të Sistemit Financiar të Kosovës



Burimi: BQK.

Shënim: madhësia e secilës nyje (rrethi) reflekton totalin e aseteve të secilit institucion, përjashtuar Qeverinë Qendrore ku është marrë për bazë gjithsej detyrimet që i ka në formë të letrave me vlerë ndaj këtyre institucioneve. Drejtimi i shigjetave nënkupton kërkesa ndaj institucionit të cilit i drejtohet shigjeta ndërsa trashësia e vizë lidhëses dhe shigjetës reflekton nivelin apo madhësinë e ndërlidhjes. Gjendja është me dhjetor 2021.

Në këtë zvogëlim ndikoi tërheqja e depozitave të fondeve pensionale nga BQK dhe alokimi i tyre drejt letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës, gjë që rriti ndërlidhjen e këtij sektori me Qeverinë Qendrore (figura 1). Depozitat që institucionet financiare jo-bankare mbajnë në banka komerciale paraqesin ekspozim të lartë ndër-institucional (përjashtuar ekspozimin ndaj qeverisë) për disa nga këto institucione. Kompanitë e sigurimeve mbajnë si depozita në banka komerciale rreth 46 përqind të aseteve të tyre. Institucionet mikrofinanciare, në dhjetor 2021, përgjysmuan pjesëmarrjen e bilancit me bankat komerciale në gjithsej asetet e tyre në 5.4 përqind nga 10.7 përqind në vitin paraprak, të ndikuar nga rritja e kreditimit. Gjithashtu, fondet pensionale zvogëluar konsiderueshëm pjesëmarrjen e bilancit me bankat komerciale në 1.9 përqind nga 6.5 përqind në dhjetor 2020. Depozitat e këtyre institucioneve përbëjnë 4.1 përqind të gjithsej depozitave të sektorit bankar, vlerë kjo e zvogëluar nga 6.1 përqind në vitin paraprak pas tërheqjes së depozitave të fondeve pensionale nga sektori bankar. Rrjedhimisht,

likuiditeti i sektorit bankar paraqet faktor me rëndësi në funksionimin stabil të sektorëvetjerë financiar, pasi që në kontekst të ndërlidhjeve, depozitat përbëjnë një nga kanalet kryesore për bartje të mundshme të problemeve ndër-institucionale. Ndërsa, kërkesat e bankave komerciale ndaj institucioneve të tjera financiare jo-bankare, që përfaqësohen në formë të kredive, kanë pjesëmarrje të ulët prej vetëm 0.3 përqind të gjithsej kredive të sektorit bankar.


Pjesë të rëndësishme në figurën e ndërlidhjes përbën edhe ekspozimi i sistemit financiar ndaj Qeverisë Qendrore, i shprehur në formë të letrave me vlerë, pasi që është konsideruar se rëndësia e ekspozimeve të tilla është në rritje në kushtet kur mundësitë për investime nga ana e institucioneve janë të kufizuara pikërisht në letra me vlerë qeveritare dhe depozita-kredi.

Sektori pensional është një ndër investuesit kryesor në letrat me vlerë të qeverisë, pasuar nga BQK (përmes tregut sekondar) dhe bankat komerciale. Institucionet e tjera financiare gjithashtu kanë kërkesa ndaj Qeverisë në formë të letrave me vlerë qeveritare, ndërsa qeveria ka kërkesa (ekspozim) vetëm ndaj BQK-së dhe bankave komerciale përmes depozitave që mban në këto institucione.

Lidhjet ndërbankare janë akoma më të koncentruara se sa ato ndër institucionale, ku disa banka që janë relativisht më të vogla kanë ekspozime të theksuara ndaj bankave më të mëdha, si dhe në nivel më të ulët ndërmjet tyre brenda sistemit financiar në vend (figura 2). Bankat e mëdha ekspozimet kryesore i kanë në tregjet e jashtme, ndaj bankave amë apo edhe bankave e institucioneve të tjera financiare.

Lidhjet e theksuara ndërmjet tre bankave në vend të paraqitura në grafikun më lartë, përfaqësohen kryesisht në formë të burimeve të financimit siç janë depozitat. Lidhja më e theksuar paraqitet në mes të bankës I me bankën E dhe bankën J, për shkak të kërkesave financiare në formë të depozitave të afatizuara që banka I ka ndaj këtyre bankave, e që njëkohësisht përbën burim financimi për këto të fundit.

Figura 2. Ndërlidhjet bankare të sektorit bankar të Kosovës



Burimi: BQK.

Shënim: madhësia e secilës nyje (rrethi) reflekton totalin e aseteve të secilit institucion bankar, përjashtuar bankat amë ku është marrë për bazë gjithsej kërkesat që i kanë bankat amë në formë të linjave kreditore apo borxhit të ndërvarur ndaj bankave përkatëse në vend. Drejtimi i shigjetave nënkupton kërkesa ndaj institucionit bankar të cilit i drejtohet shigjeta ndërsa trashësia vizë-lidhëses dhe shigjetës reflekton nivelin apo madhësinë e ndërlidhjes. Gjendja është me dhjetor 2021.

Njëkohësisht, Banka C ka ndërlidhje të theksuar me bankën J, në formë të kërkesave po ashtu në formë të depozitave. Si masë mbrojtëse ndaj efekteve të mundshme të pandemisë, ndërlidhja e disa prej bankave të sektorit me bankat amë u shumëfishua në vitin 2020 dhe 2021, për shkak të kërkesave për rritjen e kapacitetit absorbues në rast të përkeqësimit të portfolios kreditore. Ndërlidhjet me bankat amë përkatëse janë më të theksuarat tek bankat B, F, E dhe J, kryesisht detyrime në formë të huazimeve afatshkurtra, depozitave si dhe në nivel më të vogël huave. Përderisa, banka J ka gjithashtu ndërlidhje të theksuar me bankën amë në formë të kërkesave ndaj saj, përkatësisht depozitave në bankën amë dhe degët e tjera të grupit.

4.1. Aktiviteti bankar

Sektori bankar gjatë vitit 2021 u karakterizua me rritje të theksuar të aktivitetit, e mbështetur kryesisht nga rritja e konsiderueshme e financimit të sektorit. Aktiviteti bankar u koncentrua kryesisht në kreditim dhe investim në letrat me vlerë. Asetet e sektorit bankar u rritën për 11.1 përqind nga viti paraprak, dhe arritën vlerën prej 5.96 miliardë euro. Aktiviteti kreditor shënoi rritje të përshpejtuar, si pasojë e rimëkëmbjes së

fuqishme të aktivitetit ekonomik në vend gjatë vitit 2021.


Në rrethana të rritjes së lartë të depozitave të arkëtuara gjatë vitit, si dhe rritjes së kërkesës për kredi si pasojë e rimëkëmbjes së aktivitetit ekonomik në vend dhe përmirësimit të perspektivës së tregut, bankat i koncentruan mjetet në zgjerimin e aktivitetit kreditor si dhe investimit në letrat me vlerë. Njëkohësisht, këto ishin zërat e vetëm që u karakterizuan me ritëm të përshpejtuar të rritjes. Rritje vjetore kishte edhe kategoria e parasë së gatshme dhe bilancit me BQK (rritje vjetore prej 5.2 përqind) mirëpo në nivel më të ulët krahasuar me vitin paraprak, duke lënë të nënkuptohet orientimi i mjeteve në instrumente me kthim më të lartë financiar si rrjedhojë e perspektivës më të mirë në treg. Përderisa, zëri i vetëm me rënie ishte bilanci me bankat komerciale i cili u zvogëlua për 11.8 përqind (rritje për 27.6 përqind në vitin e kaluar), ku kryesisht u zvogëluan depozitat e mbajtura në bankat komerciale jashtë vendit. Këto dinamika sygjerojnë se bankat, në vend se t'i mbajnë mjetet në formë të rezervave, i kanë investuar ato, duke reflektuar përmirësimin e perspektivës së aktivitetit ekonomik në vend gjatë vitit 2021. Përderisa, për vitin vijues pritjet janë në ndërrim të orientimit të aseteve nga kreditimi në mbajtjen e rezervave si masë mbrojtëse ndaj përkeqësimit të perspektivës në tregun vendor e global, si pasojë e inflacionit të lartë.

Sektori nuk ka pësuar ndryshime strukturore në anën e aseteve ndër vite, me përjashtim të nënkategorisë së letrave me vlerë që shënoi rritje nga viti 2012 si rezultat i fillimit të tregut të brendshëm të letrave me vlerë dhe pjesëmarrjes aktive të bankave në këtë treg (grafik 22).

Stoku i letrave me vlerë shënoi rritje të përshpejtuar vjetore prej 17.1 përqind. Investimet e sektorit bankar në letra me vlerë të qeverisë së Kosovës u rritën për 22.6 përqind krahasuar me vitin paraprak, ndërsa investimet në letrat me vlerë të qeverive të huaja shënuan rritje prej 18.0 përqind.

Aktiviteti i sektorit bankar vazhdon të financohet kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare, të cilat në këtë vit shënuan rritje vjetore dyshifrore si pasojë e rezervave të mbajtura qysh nga viti paraprak, niveli i lartë i remitencave, si dhe ardhja e lartë e diasporës, që nënkupton hyrjen e remitencave edhe nga rrugë joformale.


Grafik 22. Pjesëmarrja në strukturën e asetëve



Burimi: BQK.

Gjithsej depozitat e sektorit shënuan rritje vjetore prej 12.4 përqind (rritje prej 11.6 dhe 16.2 përqind në vitin 2020 dhe 2019, respektivisht) dhe arritën nivelin prej 4.90 miliardë euro, ndikuar kryesisht nga rritja e konsiderueshme e depozitave të transferueshme të ekonomive familjare dhe të ndërmarrjeve (publike dhe private), si dhe në nivel më të ulët depozitave të kursimit të ekonomive familjare. Në vitin 2021, depozitat përfaqësuan 82.3 përqind të burimeve të financimit të sektorit bankar (grafik 23).

Grafik 23. Pjesëmarrja në strukturën e detyrimeve dhe burimeve vetanake




Burimi: BQK.

Depozitat e ekonomive familjare, që përbëjnë 68.7 përqind të gjithsej stokut të depozitave, shënuan rritje prej 14.6 përqind. Rritja e

konsiderueshme e depozitave gjatë vitit 2021 reflektoi pasiguritë e bartura nga viti 2020 si dhe valët e rritjes së infektiveve edhe gjatë vitit 2021, që ndikuan në shtyrjen e shpenzimeve dhe investimeve nga ekonomitë familjare. Për më tepër, në dinamikën e depozitave të ekonomive familjare rol të rëndësishëm kanë edhe remitencat, niveli i të cilave shënoi rritje dyshifrore gjatë këtij viti. Tutje, rritje të theksuar kishte edhe niveli i vizitave nga diaspora në vend, që nënkupton hyrjen e remitencave edhe nga rrugë joformale. Njëkohësisht, edhe të hyrat nga skemat lehtësuese të aplikuara nga Qeveria kontribuan në rritje të depozitave.

Viti 2021 u karakterizua me rritje të depozitave edhe nga korporatat jo financiare dhe publike, përderisa depozitat e korporatave financiare shënuan rënie të ndikuara kryesisht nga rënia e depozitave të fondeve pensionale (grafik 24).

Grafik 24. Stoku i gjithsej depozitave dhe depozitave të reja, në milionë euro




Burimi: BQK.

Në kuadër të sistemit financiar, kompanitë e sigurimeve rritën nivelin e depozitave të mbajtura në bankat vendore, si pasojë e profitabilitetit më të lartë të sektorit gjatë vitit 2021, mirëpo në të njëjtën kohë sigurosit rritën edhe investimet në letrat me vlerë. Përderisa, fondet pensionale zvogëljuan depozitat e afatizuara në sektorin bankar, të cilat kanë edhe peshën më të lartë të depozitave të fondeve pensionale të mbajtura në sektorin bankar. Gjithashtu, për shkak të përmirësimit të perspektivës në ekonominë e vendit, sektori mikrofinanciar ka rialokuar mjetet e tyre nga rezervat e mbajtura në bankat komerciale në formë të depozitave në aktivitetin kreditor dhe të lizingjeve. Depozitat

e arkëtuara nga korporatat jofinanciare kishin ritëm të përshpejtuar të rritjes krahasuar me vitin paraprak. Në kuadër të depozitave të këtij segmenti, rritjen më të lartë e kishin depozitat e transferushme. Kjo dinamikë mund të jetë ndikuar nga rimëkëmbja e aktivitetit ekonomik të këtij sektori me përmirësimin e situatës me pandeminë gjatë vitit 2021 duke ndikuar në rritjen e qarkullimit të ndërmarrjeve, e që rrjedhimisht mund të jetë reflektuar në rritjen e përshpejtuar të depozitave të tyre në sektorin bankar. Sidoqoftë, sipas Anketës së Kreditimit Bankar, depozitat e ndërmarrjeve gjatë tremujorit të parë të vitit 2022 veçse shënuan rënie, e në një nga bankat sistemike kishte rënie të konsiderueshme të tyre. Rënia e depozitave nga ndërmarrjet reflekton investimin më të lartë të mjeteve në kapital qarkullues si dhe blerjen e parakohshme të stokut për të shmangur rritjen e kostove si pasojë e rritjes së çmimeve në tregjet e huaja dhe vendore. Përderisa, tutje gjatë tremujorit të dytë bankat u shprehen optimiste për rritje të depozitave nga ndërmarrjet edhe pse në një nivel të ulët, e që mund të jetë ndikuar nga sezonaliteti që e karakterizon këtë tremujor në aspekt të aktivitetit të shtuar ekonomik të ndërmarrjeve.

Grafik 25. Pozicioni neto ndaj jorezidentëve




Burimi: BQK.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit të jashtëm vazhdon të jetë i ulët, si dhe shënoi rënie krahasuar me rritjen e theksuar të vitit paraprak. Pozicioni neto kreditor ndaj sektorit të jashtëm shënoi rënie, për 4.6 përqind, duke zbritur vlerën në 585.1 milionë euro (grafik 25 dhe 26). Kjo rënie e pozicionit neto kreditor ishte kryesisht

rrjedhojë e rënies së investimeve në sektorin e jashtëm, në formë të depozitave dhe kredive.

Kërkesat ndaj jo rezidentëve zënë 14.4 përqind të gjithsej aseteve të sektorit bankar, ku 89.0 përqind e tyre janë depozita dhe investime në letra me vlerë.

Grafik 26. Kontributi i zërave në ndryshimin vjetor të aktivitetit me jorezidentët



Burimi: BQK.

Detyrimet e sektorit bankar ndaj jo rezidentëve zënë 4.5 përqind të gjithsej detyrimeve të sektorit bankar, në formë të linjave kreditore dhe depozitave të sektorit të jashtëm të mbajtura në vend. Kreditë e marra nga sektori i jashtëm dhe depozitat e sektorit të jashtëm të mbajtura në vend, së bashku përbëjnë 98.4 përqind të gjithsej detyrimeve ndaj jo-rezidentëve.


Sektori bankar vazhdon të ketë ekspozim të ulët ndaj sektorit të jashtëm. Niveli i ulët i aseteve në valutë të huaj zvogëlon më tej efektet e bartjes së problemeve nga sektori i jashtëm si dhe eviton humbjet e mundshme nga ndryshimet jo të favorshme në kurset e këmbimit kundrejt valutës euro.

4.1.1 Zhvillimet kreditore

Aktiviteti kreditor i sektorit bankar përshpejtoi rritjen si pasojë e rritjes së lartë të kërkesës për financim, të nxitur nga rikuperimi i shpejtë i aktivitetit ekonomik nga kriza pandemike. Megjithatë, si pasojë e zhvillimeve globale në rritjen e çmimeve të energjisë dhe produkteve bazë, pritjet janë që kërkesa të zvogëlohet, përkatësisht të përgjysmohet në vitin 2022, ndërsa oferta kreditore të mbetet e ngjashme, pa ndryshime të rëndësishme pozitive.

Dinamika e aktivitetit kreditues, gjatë pjesës më të madhe të vitit 2021, për korporatat jo financiare dhe ekonomitë familjare, sipas anketës së kreditimit bankar, u përcaktua kryesisht nga lëvizjet në kërkesën kreditore. Njëkohësisht, edhe oferta kreditore ndikoi pozitivisht mirëpo në një nivel më të ulët. Rritja e theksuar e kërkesës kreditore nga ndërmarrjet u nxit nga kërkesa për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues dhe investimeve fikse, përderisa për ekonomitë familjare kërkesën për kredi e ndikoi kërkesa për financimin e shpenzimeve të konsumit. Sipas anketës së kreditimit bankar, faktorët e sipërpërmendur kontribuan në rritje të përshpejtuar të kreditimit krahasuar me vitin paraprak. Sidoqoftë, sentimentin e bankave tregon një kërkesë kreditore të përgjysmuar në tremujorin e dytë e tutje, si dhe perspektivë të ngjashme dhe pasiguri edhe për dinamikat gjatë pjesës së mbetur të vitit 2022. Po ashtu, në përgjigjet e bankave deri në një masë vërehet hezitim në anën e ofertës kreditore sidomos për ndërmarrjet e mëdha. Bankat gjatë periudhës së ardhshme edhe nëse nuk do të shtrëngojnë standardet kreditore, kanë deklaruar se do të rrisin vigjilencën në procedurat e brendshme për analizimin e kërkesave për kredi.

Grafik 27. Rritja vjetore e kredive për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare



Burimi: BQK.


Stoku i kredive aktive në bankat e vendit arriti në 3.75 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore dyfish më të lartë kundrejt vitit paraprak, prej 15.5 përqind, mbështetur nga kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare (grafik 27).

Stoku i kredive për ndërmarrjet shënoi rritje prej 13.6 përqind dhe arriti vlerën prej 2.33 miliardë euro. Ndërsa, kreditë e reja gjatë vitit

2021 ishin 1.03 miliardë euro (grafik 28), nga të cilat për qëllime investuese ishin 564.7 milionë euro, ndërsa kreditë për qëllime jo-investuese ishin 440.2 milionë euro.

Me rritje të kreditimit u karakterizuan pothuajse të gjithë sektorët ekonomik, përjashtuar sektorin e bujqësisë që u karakterizuan me rënie. Sektorët që u kredituan më shumë ishin prodhimtaria, tregtia dhe shërbimet financiare.


Grafik 28. Stoku i gjithsej kredive dhe kredive të reja për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare, në milionë euro



Burimi: BQK.

Kreditë për sektorin e prodhimit dhe shërbimeve financiare u rritën për 27.5 përqind dhe 29.9 përqind, duke arritur vlerën prej 404.8 dhe 148.2 milionë euro, respektivisht.

Grafik 29. Stoku i kredive sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: BQK.


Kreditë ndaj sektorit të tregtisë, i cili dominon strukturën e gjithsej kredive, shënuan rritje vjetore prej 9.6 përqind dhe arritën vlerën prej 1,036.9 milionë euro (grafik 29). Ndërsa, sektori i bujqësisë, i cili ka peshë të vogël në gjithsej stokun e kredive të ndërmarrjeve, u karakterizua me rënie prej 6.8 përqind.

Mbështetës i rëndësishëm i kreditimit ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme vazhdon

të jetë Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, shfrytëzimi i të cilit shënoi trend të përshpejtuar të rritjes në vitin 2021. Numri kumulativ i kredive të bankave për NVM-të, të garantuara nga FKGK, arriti në 10,064 në fund të vitit 2021 (6,103 në fund të vitit 2020). Shuma totale e kredive të garantuara deri në dhjetor 2021 shënoi 408.7 milionë euro, kundrejt vlerës së garantuar prej 229.0 milionë euro në vitin paraprak (grafik 30). Ndër tjerash, rritja e përshpejtuar e garancive u mbështet nga nënshkrimi i marrëveshjes financiare për rritjen e kapitalit garantues me Bankën Gjermane për Zhvillim në vlerë 6 milionë euro. Gjithashtu, në fillim të vitit 2021 filloi implementimi i masave garantuese në kuadër të Pakos për Rimëkëmbjen Ekonomike, e cila përmban rritjen e mbulesës së kredive për NVM-të nga FKGK deri në 80 përqind, ndryshim ky që ndikon në zgjerimin e profileve që mund të përfitojnë nga garancitë.

Kryesisht, struktura e kredive të garantuara është përfaqësimit i strukturës së përgjithshme të kredive të sektorit bankar. Krahasuar me vitin paraprak, të gjithë sektorët ekonomik rritën peshën në gjithsej portofolin e kredive të garantuara, përveç sektorit të shërbimeve i cili zvogëloi pjesëmarrjen.

Grafik 30. Kreditë e aprovuara dhe të garantuara nga FKGK




Burimi: FKGK.

Trendi i rritjes së kreditimit të ekonomive familjare gjithashtu shënoi rritje të përshpejtuar, ndikuar nga perspektiva e përmirësuar e tregut vendor e ndikuar nga përmirësimi i situatës me pandeminë.

Në dhjetor 2021, rritja vjetore e stokut të kredive të ekonomive familjare ishte 18.6 përqind krahas rritjes 7.1 përqind një vit më

parë dhe rritjes prej 10.4 përqind në vitin 2019. Vlera e kredisë për këtë sektor arriti në 1.40 miliardë euro. Përshpejtimi i rritjes së kreditimit të ekonomive familjare i atribuohet në masë të madhe dinamikës së kredive të reja të këtij sektori, të cilat gjatë kësaj periudhe shënuan rritje vjetore prej 45.0 përqind (rënie prej 2.4 përqind në dhjetor 2020) (grafik 28).


Grafik 31. Kreditë e ndërmarrjeve, pjesëmarrja sipas maturitetit



Burimi: BQK.

Në kuadër të kredive të reja të ekonomive familjare, rritje të konsiderueshme kishin të dy kategoritë, si ajo për kredi hipotekare ashtu edhe për kredi konsumuese me rritje vjetore prej 56.6 përqind dhe 40.3 përqind, respektivisht.

Grafik 32. Kreditë e ekonomive familjare, pjesëmarrja sipas maturitetit



Burimi: BQK.

Kjo rritje e kredive të reja për ekonomitë familjare u ndikua nga përmirësimi i situatës me pandeminë, rrjedhimisht lirimi i masave kufizuese, që u karakterizua me rritje të investimeve dhe konsumit të shtyrë nga ekonomitë familjare deri në përmirësim të situatës pandemike, si dhe ndihmat e marra nga pakot lehtësuese të Qeverisë.

Kreditë me maturitet afatmesëm, dominojnë strukturën e gjithsej kredive me pjesëmarrje

prej 51,7 përqind,²¹ shënuan rritjen më të lartë vjetore prej 20.4 përqind. Vlera e tyre arriti në 1.94 miliardë euro.

Kreditë me maturitet afatmesëm kishin rritje prej 10.2 përqind me vlerë prej 1.38 miliardë euro. Kreditë me afat të mesëm maturiteti janë kryesisht të dominuara nga kreditë e lëshuara për korporatat jo financiare (grafik 31), përderisa kreditimi afatgjatë është kryesisht karakteristikë e portofolios kreditore të segmentit të ekonomive familjare (grafik 32).

Sipas Anketës së Kreditimit Bankar së realizuar për tremujorin e katërt të 2021, kreditë afatgjata për ekonomive familjare u ndikuan pozitivisht kryesisht nga ana e kërkesës kreditore, përderisa oferta kreditore favorizoi më shumë kreditë më maturitet afatshkurtër.

Kutia 4. Anketa e Kreditimit Bankar²²


Rezultatet e fundit të Anketës së Kreditimit Bankar²³ pasqyrojnë zhvillimet në aktivitetin e kreditimit bankar gjatë periudhës janar - mars 2022 (referuar si TM1 2022), si dhe pritjet për aktivitetin kreditues në periudhën prill - qershor 2022 (referuar si TM2 2022).

Dinamika e aktivitetit kreditues për **ndërmarrjet** gjatë TM1 2022, sipas anketës së kreditimit bankar, rezultojnë të jetë ndikuar pozitivisht, në nivel më të lartë nga ana e kërkesës për kredi, ndërsa oferta kreditore po ashtu ndikoj pozitivisht mirëpo në nivel më të ulët.

Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan se kanë lehtësuar në masë të vogël standardet kreditore të aplikuara gjatë vlerësimit të aplikacioneve të ndërmarrjeve për kredi. Ky lehtësim reflekton ndryshimet në standardet kreditore për kategorinë NVM-ve.

Për tremujorin e dytë të vitit 2022, bankat pritjet t'i shtrëngojnë standardet kreditore për ndërmarrjet e mëdha, përderisa për NVM-të pritjet të mbesin të pandryshuara bazuar në pasiguritë që po përcjellin vitin 2022 si pasojë e rritjes së çmimeve dhe ndikimit të luftës Rusi – Ukrainë në hallkat e furnizimit (grafik 1).

Grafik 1. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve të ndërmarrjeve



Burimi: BQK.

Faktori kryesor që ndikoi në lehtësimin e standardeve kreditore, sipas deklaratimit të bankave, ishte rritja e presioneve të konkurrencës në mes të bankave. Përderisa, në një nivel më të ulët pozitivisht në lehtësim ndikuan edhe perspektiva e

favorshme e tregut bankar në vend dhe mbështetja e ndërmarrjeve në kreditim nga FKGK-ja.

Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan se kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet u

²¹ Periudha afatshkurtër përfshinë maturitetin deri në 1 vit, afatmesme përfshinë maturitetin prej 1 deri në 5 vite, dhe periudha afatgjatë përfshinë maturitetin mbi 5 vite.

²² Anketa e Kreditimit Bankar realizohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës me 10 banka që operojnë në Kosovë dhe përfaqësojnë 99.9 përqind të kreditimit të gjithëj sektorit. Anketa realizohet në baza tremujore.


²³ Përgjigjet e bankave individuale janë agreguar duke përdorur peshën përkatëse të çdo banke në gjithëj portfolion kreditore të sektorit bankar. Vlerat pozitive e indeksit të standardeve kreditore tregojnë lehtësim dhe vlerat negative tregojnë shtrëngim. Gjithashtu, vlerat pozitive e indeksit të kërkesës për kredi tregojnë rritje të kërkesës dhe vlerat negative tregojnë rënie. Më gjerësisht metodologjinë e përdorur mund ta gjeni në Raportin e Anketës së Kreditimit Bankar në ëeb faqen e BQK.

lehtësuan në masë të ulët. Rritja e presioneve të konkurrencës, si dhe qasja e favorshme në financim në tregun vendor ndikuan në lehtësimin e kushteve të kreditimit. Konkretisht, kushte dhe rregulla të lehtësuara u aplikuan kryesisht për NVM-të, kryesisht përmes uljes së normës së interesit dhe uljes së kërkesave për kolateral (grafik 2).

Bankat deklaruan që duke u mbështetur në qasjen e favorshme në financim nga bankat amë, në rritjen e presioneve të konkurrencës si dhe në mbështetjen

nga FKGGK për NVM-të, bankat për TM2 2022 presin lehtësim deri në një masë të kushteve dhe rregullave. Në këtë kontekst, bankat deklaruan që pritet të ofrojnë kryesisht kushte dhe rregulla të lehtësuara për të dy kategoritë e ndërmarrjeve, e veçanërisht për NVM-të. Kushtet dhe rregullat pritet të lehtësohen përmes normave më të volitshme të interesit dhe kërkesave më të vogla për kolateral.

Grafik 2. Rregullat dhe kushtet e aplikuar për kreditë ndaj ndërmarrjeve



Burimi: BQK.

Gjatë periudhës raportuese, kërkesa e ndërmarrjeve për kredi bankare rezulton të jetë rritur deri në një masë. Rritja e kërkesës për ndërmarrjet i atribuohet kryesisht kërkesës nga NVM-të, përderisa për ndërmarrjet e mëdha kishte nivel më të ulët të kërkesës për kredi (grafik 3). Për më tepër, cilësia e aplikacioneve të pranuar u përmirësua, veçanërisht për NVM-të. Raporti i kredive jo-performuese të ndërmarrjeve u përmirësua gjatë TM1 2022 sipas deklaratave të bankave në anketë.


Sipas anketës, rritja e kërkesës për kredi nga NVM-të kryesisht u ndikua nga rritja e kërkesës për

financimin e inventarëve dhe kapitalit punues, dhe kërkesës për financimin e investimeve fikse.

Pasiguritë në perspektivën në vend dhe jashtë tij po diktojnë pritjet e bankave sa i përket ndryshimeve në kërkesën për kredi. Rrjedhimisht, gjatë tremujorit të dytë 2022 bankat presin rritje të përgjysmuar të kërkesës për kredi, nga të dy kategoritë e ndërmarrjeve, në krahasim me tremujorin aktual.

Sa i përket cilësisë së portfolios kreditore të ndërmarrjeve, bankat presin që gjatë tremujorit të dytë raporti i kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive të rritet, mirëpo në një nivel të ulët.

Grafik 3. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet



Burimi: BQK.


Sa i përket afatit kohor të kredive, rezultatet e anketës tregojnë se rritje më të madhe të kërkesës gjatë kësaj periudhe kishte për kreditë afatshkurtra. Kërkesa për kredi afatgjata kishte rritje gjithashtu, por në një shkallë më të vogël. Njëkohësisht, oferta kreditore e ndarë sipas maturitetit të kredive favorizoj kreditë me maturitet afatshkurtër, krahas atyre me maturitet afatgjatë. Në tremujorin e ardhshëm, bankat presin lehtësim marginal të standardeve kreditore kryesisht për kreditë afatshkurtra. Ngjashëm, sa i përket kërkesës, bankat presin rritje marginale të kërkesës kryesisht për kreditë afatshkurtra (grafik 7).

Dinamikat e aktivitetit kreditues për **ekonomitë familjare** gjatë periudhës raportuese, sipas anketës, u ndikuan pozitivisht në një masë më të

madhe nga kërkesa për kredi se sa nga oferta kreditore. Standardet kreditore të aplikuar gjatë shqyrtimit të aplikacioneve për kredi nga ekonomitë familjare u lehtësuan për të dy llojet e kredive, e veçanërisht për kreditë konsumuese (grafik 4). Sipas anketës së kreditimit bankar faktorët që kontribuan pozitivisht në standardet kreditore të aplikuar gjatë këtij tremujori ishin rritja e presioneve të konkurrencës, pozita e favorshme e likuiditetit të sektorit, si dhe përmirësimi i perspektivës së tregut bankar në vend.

Pritjet e bankave për TM2 2022 japin indikacione për lehtësim të standardeve kreditore, mirëpo në një nivel dukshëm më të ulët me atë të TM1 2022. Lehtësim pritet të aplikohet për kreditë konsumuese.

Grafik 4. Standardet kreditore të aplikuar në vlerësimin e aplikacioneve nga ekonomitë familjare




Burimi: BQK.

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja ndaj ekonomive familjare në përgjithësi u lehtësuan deri në një masë në tremujorin e parë të vitit 2022. Lehtësimi i kushteve dhe rregullave ishte më i lartë për kreditë për blerjen e shtëpive se sa për kreditë konsumuese. Kryesisht, kushtet dhe rregullat u lehtësuan përmes uljes së normës së interesit, uljes së kërkesave për kolateral dhe në një nivel më të ulët rritjes së shumës së aprovuar dhe zgjatjes së afatit të maturitetit. Njëkohësisht, ulja e kërkesës për kolateral kishte indeksin më të lartë pozitiv për kreditë e reja konsumuese gjatë këtij tremujori (grafik 5). Rritja e presioneve të konkurrencës, përmirësimi i prospekteve në tregun bankar, si dhe qasja e favorshme në financim rezultojnë të kenë qënë faktor kyç në lehtësimin e kushteve dhe

rregullave të kreditimit për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të parë të vitit 2022.


Në tremujorin e ardhshëm priten ndryshime të parëndësishme të kushteve dhe rregullave për kredi për ekonomitë familjare. Lehtësim marginal pritet të aplikohet për kreditë konsumuese, i fokusuar në rritjen e madhësisë së kredive, uljen e normës së interesit dhe uljen e kërkesës për kolateral. Bankat raportuan rritje të kërkesës për kredi të ekonomive familjare. Të dy kategoritë e kredive të ekonomive familjare kishin rritje të përafërt të kërkesës (grafik 6). Rritja e kërkesës nga ekonomitë familjare kryesisht i atribuohet perspektivës së kënaqshme të tregut të patundshmërive dhe rritjes së financimit të shpenzimeve tjera të konsumit.

Grafik 5. Rregullat dhe kushtet e aplikuar për kreditë ndaj ekonomive familjare


Gjithashtu, cilësia e aplikacioneve të pranuar kishte rritje marginale për të dy kategoritë e kredive për ekonomitë familjare. Sipas anketës, raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive për ekonomitë familjare kishte rënie, e i cili për tremujorin vijues pritet të ndërroj kahun me indeks marginal pozitiv.

Në tremujorin e dytë të vitit 2022, bankat presin rritje të kërkesës për kredi deri në një masë për

kreditë konsumuese, përderisa kërkesa për kredi për blerjen e shtëpive pritet të mbetet kryesisht e pandryshuar. Rezultatet e anketës sugjerojnë se bankat ia atribuon këto pritje perspektivës së kënaqshme të tregut të patundshmërive, edhe pse u karakterizua me indeks pozitiv marginal.


Grafik 6. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare


Sa i përket afatit kohor, rezultatet e anketës tregojnë se ekonomitë familjare gjatë TM1 2022 kishin rritje të ngjashme të kërkesës për të dy afatet kohore.

Gjithashtu, oferta kreditore e ndarë sipas maturitetit të kredive rezulton të jetë lehtësuar në masë më të madhe për kreditë afatshkurtra. Bankat presin që në tremujorin e ardhshëm lehtësimi në ofertën kreditore do të orientohet në nivel më të lartë drejt kredive afatshkurtra, se sa në kreditë afatgjata. Gjithashtu, edhe kërkesën për kredi pritet ta dominojnë kreditë me maturitet afatshkurtër (grafik 7). Indeksi i agreguar për **qasjen në financim** nga bankat rezultoi pa ndryshim gjatë tremujorit të parë të vitit 2022.

Megjithatë, gjashtë nga bankat pjesëmarrëse në anketë deklaruan për rritje deri në një masë të qasjes në financim, përderisa tre banka tjera deklaruan rënie (njëra deklaroi rënie të konsiderueshme), ku dy prej tyre me rëndësi sistemike dhe peshë të madhe në sektorin bankar, e që rezultoi në indeks afër zeros. Duke marrë parasysh modelin tradicional të sektorit bankar në Kosovë, financimi vazhdoi të dominohet nga depozitat e ekonomive familjare. Rezultatet e anketës tregojnë që financimi i bankave gjatë këtij tremujori u ndikua pozitivisht nga depozitat e ekonomive familjare, përderisa financimi nga depozitat e ndërmarrjeve shënoi rënie të theksuar.

Grafik 7. Ndryshimi i standardeve kreditore dhe kërkesës për kredi sipas maturitetit




Burimi: BQK.

Përderisa, burimet tjera të financimit nuk patën ndryshime të rëndësishme. Sipas maturitetit, bankat deklaruan rritje marginale të depozitave afatshkurtra, përderisa për ato afatgjata në këtë tremujor nuk kishte ndryshime të rëndësishme.

Për tremujorin e ardhshëm TM2 2022, bankat presin rritje të qasjes në financim. Financimi përmes depozitave të ekonomive familjare pritet të ketë rritje më të lartë se sa përmes depozitave të ndërmarrjeve.

Për dallim nga ky tremujor, në tremujorin vijues tre banka, dy prej tyre me rëndësi sistemike, presin mbështetje në financim të aktivitetit bankar nga bankat amë. Njëkohësisht, një nga bankat po ashtu me rëndësi sistemike deklaroi se pret mbështetje në financimin nga institucionet financiare ndërkombëtare, e që rrjedhimisht rezultoi me një indeks pozitiv të ulët. Në tremujorin vijues, anketat sinjalizojnë pritjet për vazhdimin e dominimit të financimit afatshkurtër (grafik 8).

Grafik 8. Ndryshimi në financimin e sektorit bankar



Burimi: BQK.

5. Rreziqet e sektorit bankar


Sektori bankar gjatë vitit 2021 u ndodh në dinamika të reja të krijuara pas vitit pandemik, të karakterizuara me rritje të aktivitetit, në proces e në mbështetje të rikuperimit ekonomik. Masat e ndërmarra nga BQK si ristrukturimet, që ndihmuan në ruajtjen e performancës së mirë kreditore të klientëve, sentimentit dhe perceptimi pozitiv i tregut dhe rreziqeve të ndërlidhura me të, rritja e aktivitetit të ndërmarrjeve dhe rritja e remitancave dhe ardhjes së diasporës, rezultuan në rritje të aktivitetit kreditor nga bankat dhe rritje të likuiditetit nga depozitat e pranuar. Prandaj, si rezultat sektori bankar u ekspozua ndaj rritjes në disa rreziqe që ndërlidhet me mospërputhje përshkak të rritjeve në disa pozicione bilancore. Më konkretisht, rritja më e shpejtë e kreditimit ka rritur asetet me peshë rreziku, shpërndarja e dividendës ka zvogëluar profitin e bartur, rritja e depozitave afatshkurtëra ka rritur detyrimet afatshkurtëra dhe mospërputhjet në afatet e maturimit në mes të aseteve dhe detyrimeve. Megjithatë, që të gjithë treguesit e shëndetit financiar të sektorit bankar qëndruan në pozita të favorshme për të mbështetur sektorin në rast të materializimit të rreziqeve.

Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar, i elaboruar në vijim, bënë vlerësimin e kushteve të brendshme të sektorit bankar, që reflektojnë stabilitetin e tij në periudhën e fundit në raport me gjendjen historike ndër vite.

Indeksi është i ndërtuar mbi treguesit financiar bazë të stabilitetit të sektorit bankar, duke marrë vlera në intervalin 0 deri 1, ku vlerat më të larta paraqesin rrezik në rënie dhe anasjelltas. Indeksi është kalkuluar në baza

tremujore, përmes të cilit vlerësohet nëse kemi rritje apo ulje të ndjeshmërisë së rrezikut.²⁴

Grafik 33. Indeksi i agreguar i stabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK.

Sipas indeksit të përgjithshëm të agreguar të stabilitetit të sektorit, në mesatare është shënuar rritje vjetore e ndjeshmërisë ndaj rreziqeve (grafik 33). Rritja e përgjithshme e ndjeshmërisë ndaj rreziqeve u ndikua nga indikatorët me rritje rreziku si ai i solvencës dhe likuiditetit. Ndërsa, ulje e ndjeshmërisë u shënuar në indikatorët e rrezikut kreditor, profitabilitetit, dhe tregut.

Rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të solvencës i atribuohet nivelit më të ulët të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit, për shkak të rritjes së aseteve me rrezik nga kreditimi më i lartë, ndërkohë që edhe kapitali ishte lehtësisht më i ulët se viti paraparak për shkak të ndarjes së dividendës, shpërndarja e së cilës ishte pezulluar, si masë e përkohshme mbrojtëse e rekomanduar nga BQK, deri në tetor të vitit 2021.²⁵ (grafik 34). Rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të likuiditetit i atribuohet nivelit më të ulët të treguesve të likuiditetit, si raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra. Rritja e depozitave kryesisht në afate të shkurta të maturimit ka ndikuar që detyrimet afatshkurtra të jenë

²⁴ Për më tepër rreth metodologjisë së ndërtimit të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar, referojuni Raportit të Stabilitetit Financiar nr.9.

²⁵ Më 16 mars 2020, BQK mori vendim për pezullimin e përkohshëm të zbatueshmërisë së dispozitave të caktuara të disa rregulloreve të mbikëqyrjes së


institucioneve kredhënëse, si mbështetje për sfidat e krijuara nga pandemia Covid-19 në ekonominë e Kosovës dhe sistemin financiar. Shtesë ndaj këtyre masave rregullative, BQK ndërmori masën e përkohshme të ndalimit të shpërndarjes së dividendës, me qëllim të ruajtjes së profitit të realizuar për mbulimin e kërkesave për provizione shtesë dhe humbjeve të mundshme kreditore.

rritur më shpejtë kundrejtë rritjes së mjeteve likuide.

Kurse, rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut kreditor ishte si rezultat i rënies vjetore të raportit të kredive jo-performuese, efekt i zvogëlimit të vlerës së stokut të kredive jo-performuese por poashtu edhe i rritjes së theksuar të kreditimit. **Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të profitabilitetit** i atribuohet profitit më të lartë të realizuar nga të hyrat e interesit dhe jo-interesit (tarifat dhe komisionet), si dhe zvogëlimit të shpenzimeve për provizione për humbje të mundshme në kredi.

Indikatori që vlerëson **ndjeshmërinë ndaj rrezikut të tregut**, i matur përmes pozicionit të hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë, po ashtu ka shënuar rënie. Megjithatë, ky indikator ka peshë shumë të ulët në indeksin e përgjithshëm të stabilitetit financiar (grafik 34).

Grafik 34. Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar, sipas kriterëve të rreziqeve



Indeksi i përgjithshëm i agreguar sugjeron rritje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut, krahasuar me mesataren historike të indeksit (2008–2020), por edhe me mesataren e katër viteve të fundit. Përkundër zhvillimeve pozitive gjatë vitit, megjithëse në përballje me pasojat e pandemisë, tremujori i tretë dhe i katërt rriti ndjeshmërinë për shkak të rritjes së inflacionit. Gjithsesi, gjendja e treguesëve të shëndetit të sektorit bankar në mbyllje të vitit mbetet e kënaqshme meqë sugjeron për kapacitet përballues të rreziqeve ndaj të cilave

potencialisht mund të përballet sektori në vitin vijues.

5.1. Rreziku kreditor


Me lehtësimin gradual të masave kufizuese për kontrollin e pandemisë COVID-19, gjysma e parë e vitit 2021 solli rimëkëmbje ekonomike dhe sentiment pozitiv për tregun. Në aspektin e rrezikut kreditor, në kushtet kur disa sektor të caktuar u ekspozuan ndaj masave kufizuese të vazhduara edhe përgjatë tremujorit të parë të vitit, pasiguria më e madhe vinte nga kreditë e ristrukturuara të cilave u është afruar koha e ripagimeve. Stoku i kredive jo-performuese gjatë këtij tremujori të parë kishte shënuar rritje për 2.8 përqind, por që ky trend ndërroj kahjen drejtë rënies që nga tremujori i dytë, dhe atë në të dy segmentet (ekonomi familjare dhe pothuajse në të gjithë sektorët ekonomik). Tutje, perceptimi për ulje të rrezikut kreditor nga ana e bankave u mbështetet në riklasifikimin e ekspozimeve kreditore gjatë kësaj periudhe, në kategorinë e kredive me rrezik më të ulët, respektivisht zvogëlimin e kategorisë së kredive me vonesa më të zgjatura drejt rritjes së pjesëmarrjes së kategorisë së kredive pa vonesa (shtyllës së parë të klasifikimeve kreditore). Por, me pasiguri përcillen kreditë jo-performuese të kredive të ristrukturuara, të cilat në fund të vitit përbënin pothuajse gjysmën e kredive jo-performuese. Përderisa vlera e kredive ende nën ristrukturim në fund të vitit 2021 përbënte 19.3 përqind të gjithsej kredive, kreditë me probleme të kësaj kategorie kishin pjesëmarrje prej 44.3 përqind në gjithsej kreditë jo-performuese. Për më tepër, optimizmi i gjysmës së parë të vitit u godit me rritje të inflacionit dhe rritje të tensioneve gjeopolitke, situatë që u përcoll menjëherë me rritje të shqetësimeve rreth aktivitetit të bizneseve në sektorët më të ndjeshëm ndaj rrethanave të tilla

(si sektori i tregtisë, ndërtimtarisë dhe bujqësisë) dhe dobësimi të fuqisë blerëse të konsumatorit e përkeqësimit të standardit jetësor, që direkt afektojnë performancën kreditore.

Përfundimisht, vlerësuar nga trendi i treguesve kyç të cilësisë së portfolios kreditore, rreziku kreditor rezulton më i ulët se në periudhat e kaluara, por në kontekstin e këtyre dinamikave jo të favorshme të elaboruara më sipër, rreziku kreditor është rritur dhe mbetet rreziku më eminent i sektorit bankar dhe stabilitetit financiar. Përgjatë vitit 2021, norma e KJP-ve u rikthye në trendet rënësive parapandemike, përkundër që pothuajse të gjitha kredive të ristrukturuara, përfshirë ato në fazën e fundit të ristrukturimeve në shkurt 2021, iu përfundoj afati i shtyrjes së ripagimeve. Rikuperimi i shpejtë ekonomik, i mbështetur nga ndihma dhe vizitat e paprecedent të diasporës në Kosovë, ka ndikuar që efektet negative të pandemisë të mos materializohen në rritje të kredive joperformuese. Përkundrazi, norma e KJP-ve shënoi rënie në 2.3 përqind në fund të vitit, nga 2.7 përqind sa ishte një vit më parë, si rezultat i rritjes së përshtypshme të kreditimit dhe vazhdimi të masave lehtësuese nga BQK, përkatësisht ristrukturimit të kredive²⁶. Rënia e normës së KJP-ve reflekton edhe efektin e njëhershëm të shlyerjeve (on-off effect). Pagesat e borxhit të disa kredimarrësve të mëdhenj në disa banka dhe mbylljes së disa kontratave, e zbritën për 2.6 përqind vlerën e KJP-ve, në 84.1 milionë euro (nga 86.4 milionë euro në vitin 2020 (grafik 35)). Vlera e KJP-ve filloi trendin rënës nga gjysma e dytë e vitit 2021, që përkon edhe me zvogëlim të kredive të reja jo-përformuese në këto muaj, më konkretisht rënie të theksuara janë evidentuar në muajin qershor, gusht dhe shtator. Shumica e bankave kishin zvogëlim të kredive të reja jo-përformuese në baza mujore dhe krahasuar me vitin paraprak, kumulativi i kredive të reja jo-përformuese ishte për 73.0 përqind më i ulët se në vitin paraprak (477.3 mijë euro nga 1.8

milion euro në vitin 2020). Përgjatë vitit 2021, përjashtim bën performanca e muajit dhjetor që regjistroi nivel më të lartë të kredive të reja jo-përformuese dhe atë në shumicën e bankave.

Grafik 35. Rritja vjetore e stokut të kredisë dhe kredive joperformuese



Burimi: BQK.

Norma e KJP-ve të kredive të ristrukturuara ishte më e lartë krahasuar me kreditë që nuk janë ristrukturuar. Në fund të vitit 2021, pothuajse gjysma e kredive joperformuese të sektorit ishin nga kreditë që u ristrukturuan në ndonjërin nga fazat e ristrukturimeve për shkak të pandemisë COVID-19. Megjithëse kreditë e ristrukturuara bartin rrezik më të lartë në aspekt të performancës së tyre, nivelet aktuale të sektorit mbesin të ulëta dhe performanca e pagesës ishte më e mirë se pritjet fillestare. Gjithsesi ecuria e kredive jo-përformuese të kredive të ristrukturuara duhet trajtuar më me kujdes dhe me mbiqyrje të afërt, për shkak të pjesëmarrjes së lartë në gjithsej kreditë jo-përformuese (pothuajse gjysma e stokut të kredive jo-përformuese përfaqësohen nga kreditë që ishin të ristrukturuara përgjatë kësaj periudhe).


Në fazën e parë të ristrukturimeve që përfshinte moratoriumin në pagesën e kredive për periudhën mars – qershor 2020, pjesëmarrja e kredive të ristrukturuara ishte 40.9 përqind²⁷, për shkak të gjendjes së rënduar ekonomike të huamarrësve e shkaktuar nga mbylljes totale të ekonomisë,

²⁶ Përmas shtyrjes së afatit të pagesës së kësteve, si dhe ristrukturimi i kredive përmas ndryshimit të një apo më shumë kushteve të kontratës.

²⁷ Në grafik raportohet bilanci i mbetur i kredive që janë ristrukturuar në fazën përkatëse.

ndërsa stoku i mbetur në dhjetor 2021 ishte 12.9 përqind.

Grafik 36. Kreditë e ristrukturuara, sipas kategorive




Burimi: BQK.

Në fazën e dytë të riskturkimeve, që filloi nga muaji qershor 2020, pjesëmarrja e kredive të riskturkimeve (nga faza e parë dhe e dytë) ishte 18.7 përqind sipas bilancit në dhjetor 2021, nga të cilat 5.8 përqind e gjithsej kredive ishin ristrukturime vetëm të fazës së dytë. Ndërsa me udhëzuesin e fundit të ristrukturimeve në muajin shkurt 2021, vetëm 0.3 përqind e gjithsej kredive janë ristrukturuar, dhe stoku i të gjitha kredive ende nën ristrukturim u zvogëluar në nivelin 19.3 përqind në fund të vitit (grafik 36) nga 36.1 përqind sa ishte në dhjetor 2020. Në dhjetor 2021, kreditë jo-performuese vetëm të kredive të ristrukturuara përbënin 5.2% të gjithsej kredive të ristrukturuara. Përkthyer në nivel të stokut të gjithsej kredive, pjesëmarrja e kredive jo-performuese të kredive të ristrukturuara, rezulton të jetë 1.0 përqind, ndërsa 44.3 përqind ndaj gjithsej kredive jo-performuese.

Përmirësimi i përgjithshëm i cilësisë kreditore në vitin 2021 reflektohet edhe në migrimin e kredive nga kategoria me cilësinë më të ulët të klasifikimit drejt asaj me cilësi më të lartë, përkatësisht nga shtylla 2 drejt shtyllës 1 të klasifikimit kreditor.

Pjesëmarrja e kredive në shtyllën e dytë të klasifikimit kreditor u zvogëluar në 8.6 përqind në dhjetor 2021 nga 11.3 përqind në dhjetor 2020, ndërsa kreditë në shtyllën e parë rritën pjesëmarrjen në 89.1 përqind nga 88.7 përqind (grafik 37).


Grafik 37. Kreditë sipas klasifikimit të ri kreditor në tri shtylla



Burimi: BQK.

Në dhjetor 2021, ekspozimet kreditore pa vonesa (vonesat më pak se 30 ditë), kanë rritur pjesëmarrjen në 97.2 përqind nga 96.9 përqind në dhjetor 2020. Kreditë me vonesa 30 deri në 90 ditë nuk kanë ndryshuar pjesëmarrjen, dhe mbesin në 0.5 përqind të gjithsej kredive (grafik 37). Ndërsa, kreditë jo-performuese (me probabilitet të ulët të pagesës, si dhe ato me vonesa mbi 90 ditë) kanë zvogëluar pjesëmarrjen në 2.3 përqind nga 2.7 përqind në dhjetor 2020 (grafik 37).

Grafik 38. Struktura e kredive sipas klasifikimit të vonesave, metoda e re




Burimi: BQK.

Ekonomitë familjare shënuan rënie të raportit të kredive jo performuese, në 1.2 përqind nga 1.3 përqind në vitin paraprak, si rezultat i rritjes më të theksuar të kreditimit. Rritja dyshifrore e kreditimit për segmentin e ekonomive familjare në vitet e fundit (përfshirë vitin 2020), është pritur që eventualisht do të reflektohet në rritje të problemeve në kthimin e kredisë, marrë parasysh që burimet e të ardhurave në ekonomi nuk janë rritur. Megjithatë vlera e kredive joperformuese në vitin 2021 është rritur për 5.2 përqind, rritja e theksuar e kreditimit

për 18.4 përqind ishte kategoria që ka ndikuar në rënien e normës së KJP-së për 0.1 pikë përqindje (grafik 39). Nga faza e parë e ristrukturimeve, 12.6 përqind e kredive për ekonomi familjare janë ende të ristrukturuara sipas gjendjes në fund të vitit 2021. Nga faza e dytë e ristrukturimeve (udhëzuesi i qershor 2020) mbeten të ristrukturuara edhe 1.1 përqind e këtyre kredive, ndërsa faza e fundit në shkurt 2021 mundësoi ristrukturimin edhe të 0.05 përqind të kredive, sipas gjendjes më dhjetor 2021. Në fund të vitit kreditë ende nën ristrukturim ndaj gjithsej kredive për ekonomitë familjare ishin në nivelin prej 18.1 përqind (5.0 përqind ndaj gjithsej kredive).

Grafik 39. Kreditë joperformuese




Segmenti i ndërmarrjeve ka shënuar përmirësim të cilësisë kreditore, ku norma e KJP-ve zbriti në 2.7 përqind nga 3.1 përqind një vit më parë. Vlera e kredive joperformuese të këtij sektori u zvogëluar për 1.5 përqind, ndërsa kreditë shënuan rritje për 14.2 përqind (grafik 39).

Zhvillimet në cilësinë e portfolios kreditore të sektorëve ekonomik ishin pozitive, të ndikuara nga lehtësimi i masave kufizuese për parandalimin e Covid dhe rihapja pothuajse e plotë e ekonomive. Sektori i tregtisë, i cili përfaqëson sektorin më të kredituar, shënoi rënie të normës së KJP-ve për 0.7 pikë përqindje. Sektori i bujqësisë, i cili karakterizohet me normën më të lartë të KJP-ve, shënoi rënie për 0.9 pikë përqindje duke zbritur në 7.1 përqind. Rënien më të lartë e shënoi sektori i prodhimit, prej 1.1 pikë përqindje, duke rënë në nivelin e raportit të KJP-ve prej 1.6 përqind. Rritje në normën e


KJP-ve shënoi vetëm sektori i patundshmërive, nga 3.4 përqind në 3.7 përqind (grafik 40).

Grafik 40. Raporti i KJP-ve ndaj stokut të kredisë, sipas sektorëve



Në grafikun 41 janë paraqitur ristrukturimet kreditore sipas sektorëve ekonomik. Mesatarja e kredive të riskstrukturuara për segmentin e ndërmarrjeve në fazën e parë të ristrukturimeve (qershor 2020) ishte 45.0 përqind e gjithsej kredive ndaj ndërmarrjeve, ndërsa në fazën e tretë të këtij viti, vetëm 0.7 përqind kredi janë ristruktuar për sektorin e ndërmarrjeve. Në dhjetor 2021 pjesëmarrja e kredive aktive që janë ristruktuar rezultoi në 19.8 përqind të kredive ndaj ndërmarrjeve. Sektorët që u ndikuan më së shumti nga masat e aplikuara kufizuese për të zbutur përhapjen e Covid-19 gjithashtu kanë pjesën më të lartë të kredive të ristrukturuara, me ç'rast sektori më i prekur rezultoi ai i shërbimeve të akomodimit dhe ushqimit me gjithsej 65.2 përqind kredi të ristrukturuara në fazën e parë të ristrukturimeve, 15.6 përqind në fazën e dytë, sipas bilancit të mbetur në fund të vitit 2021, ndërsa edhe 1.1 përqind janë ristruktuar në fazën e tretë. Përderisa sektori i bujqësisë në fazën e parë dhe të dytë të ristrukturimeve përbënte sektorin e pestë dhe gjashtë me rradhë për nga niveli i ristrukturimeve, në fazën e tretë ky sektor përfaqësoj nivelin e dytë më të lartë të ristrukturimeve (pas sektorit të tregtisë) në raport me gjithsej ristrukturimet sipas sektorëve ekonomik. Në fund të vitit 2021, kreditë e ristrukturuara të sektorit të tregtisë përbënin grupin më të madh të ristrukturimeve, respektivisht 9.6 përqind të kredive aktive ndaj ndërmarrjeve.

Grafik 41. Pjesëmarrja e kredive të ristrukturuara ndaj gjithsej kredive në sektorët përkatës




Cilësia e portfolios kreditore pritet të ndikohet negativisht nga efektet zingjirore që do të ketë rendi i ri i krijuar nga fillimi i luftës në Ukrainë dhe sanksionet ekonomike të vendosura ndaj Rusisë, që bashkë me pasojat ekonomike nga pandemia, janë përkthyer në presione të larta inflacioniste me pasoja në standardin e jetesës dhe performancën e bizneseve. Ndërprerjet e aktiviteteve gjatë vitit 2020 dhe kufizimet e vazhduara edhe gjatë vitit 2021 kanë dëmtuar pozicionin financiar të ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare, që ende pa u rikuperuar mirë nga kriza pandemike, në fund të vitit u përballën me krizën gjeopolitike dhe pasojat përcjellëse të saj. Andaj, kjo situatë mund të reflektohet në rënie të cilësisë së portfolios kreditore me efekt më të theksuar në sektorët ekonomik dhe ekonomitë familjare më të ndjeshme ndaj këtyre zhvillimeve.

Sektori bankar i Kosovës vazhdoi pozicionimin në nivelin më të mirë në rajon për nga cilësia e portfolios kreditore. Kosova ndër vite qëndron me raportin më të ulët të kredive jo performuese krahasuar me vendet e rajonit, të cilat kanë kaluar nëpër fazë disa vjeçare të përmirësimit të cilësisë së portfolios kreditore (grafik 42).

Sidoqftë, dinamikat makroekonomike që po karakterizojnë si ekonominë e Kosovës ashtu edhe rajonin priten të reflektohen në kapacitetin ripagues të kredimarrësve. Magnituta e përkeqësimit të cilësisë kreditore në masë të madhe do të varet nga politikat që do të ndjekin vendet (masat fiskale dhe monetare/financiare) dhe kanalit transmetues,

për të siguruar uljen e presioneve inflacioniste dhe evitimin e një shoku të madh në BPV.

Grafik 42. Raporti KJP/gjithsej kreditë në vende të rajonit




Burimi: FMN dhe Bankat Qendrore përkatëse (2021)

Raporti i mbulueshmërisë me provizione të sektorit ka shënuar rritje në 151.0 përqind nga 139.5 përqind në dhjetor 2020. Rritja në normën e provizionimit rezultoi nga niveli më i lartë i stokut të provizioneve të ndara (5.5 përqind rritje vjetore) dhe njëkohësisht rënia e vlerës së KJP-ve (rënie vjetore prej 2.6 përqind) (grafik 43).

Vlera më e lartë e provizioneve këtë vit ka qenë e pritur për shkak të rrezikut të rritur kreditor pasojë e krizës, rrezik që mendohet të jetë i pranishëm edhe vitin në vijim, rezultat i pasigurive dhe dinamikave mjaft sfiduese në treg.

Grafik 43. Ndryshimi vjetor i stokut të KJP-ve dhe mbulueshmëria me provizione



Burimi: BQK.

Sektori bankar megjithëse ka ndarë nivel më të lartë të provizioneve këtë vit, shkalla e shpenzuar e provizioneve (shpenzimet për provizione ndaj kredive) për sektorin, ishte më e ulët në dhjetor 2021 (-0.4 përqind) krahasuar me një vit më parë (-1.2 përqind), rezultat i performancës së përmirësuar kreditore.

5.1.1 Ekspozimet e mëdha kreditore

Shkalla e ekspozimit kreditor ka shënuar rritje në 80.1 përqind, nga 78.3 përqind një vit më parë, megjithëse vazhdon të jetë dukshëm nën nivelin maksimal rregullator.²⁸ Rritja vjetore e vlerës së ekspozimeve të mëdha për 1.9 përqind, krahas rritjes më të ulët prej 0.3 përqind të nivelit të kapitalit të klasit të parë (vetëm për bankat në analizë, përjashtuar degët bankare²⁹) rezultuan në rritje të shkallës së ekspozimit kreditor (grafik 44).


Koncentrimi i rrezikut kreditor, i shprehur si raport ndërmjet vlerës së ekspozimeve të mëdha ndaj numrit të këtyre ekspozimeve, është rritur. Vlera mesatare e ekspozimeve të mëdha³⁰ u rrit në 10.0 milionë euro nga 9.3 milionë euro si rezultat i efektit të rritjes më të lartë të shumës së ekspozimeve të mëdha krahas zvogëlimit të numrit të ekspozimeve të mëdha.

Raporti i tri ekspozimeve më të mëdha ndaj gjithsej ekspozimeve të mëdha kreditore është rritur në 50.8 përqind nga 40.5 përqind. Shkalla e ekspozimeve të mëdha kreditore në vitin 2021 është ngritur si rezultat i rritjes së ekspozimeve të mëdha nga kryesisht tri bankat që kanë rëndësi të përgjithshme sistematike.

Rezultatet e analizës së ndjeshmërisë së sektorit ndaj goditjeve në tri dhe pesë ekspozimet më të mëdha të bankave, në përgjithësi tregojnë për ndjeshmëri të sektorit ndaj goditjeve në këto ekspozime. Andaj, megjithëse sektori qëndron nën nivelin maksimal rregullator të ekspozimeve kreditore, ai është i ndjeshëm ndaj goditjeve të mundshme në këto pozicione. Efektet e vazhdueshme nga kriza e shkaktuar nga Covid-19 dhe dinamikat e reja të krijuara me luftën në Ukrainë ritheksojnë nevojën për një qasje më pro-aktive dhe dinamike në

mbikëqyrjen dhe trajtimin e ekspozimeve të mëdha.

Grafik 44. Koncentrimi i rrezikut kreditor



Burimi: BQK.

5.2. Qëndrueshmëria e profitit dhe rreziku i normave të interesit

Sektori bankar i Kosovës këtë vit shënoi rritjen më të lartë të profitit që nga viti 2015. Pozita e profitabilitetit u favorizua nga të gjitha kategoritë e realizimit të profitit. Zvogëlimi i shpenzimeve për provizione dhe të hyrat më të larta të realizuara ndikuan që profiti i sektorit bankar të jetë më i lartë kundrejt vitit paraprak për 47.1 përqind. Të hyrat u karakterizuan me rritje vjetore më të përsheptuar se shpenzimet, me ç'rast të hyrat nga jo-interesi (tarifat dhe komisionet) ishin kategoria e të hyrave që kontribuoi më shumë në realizim të profitit.


Vlera e profitit neto arriti në 117.5 milionë euro, nga 79.9 milionë në vitin paraprak (grafik 45). Zvogëlimi i rrezikut të perceptuar nga pandemia ndikoi në lirim të një pjese të provizioneve të ndara në vitin e kaluar. Zvogëlimi i shpenzimeve për provizione, së bashku me rritjen më të shpejtë të hyrave në raport me shpenzimet u reflektua në rritjen vjetore të profitit prej 47.1 përqind (grafik 46).

²⁸ Raport i gjithsej Ekspozimeve të mëdha kreditore ndaj Kapitalit të Klasit të Parë. Ekspozim i madh kreditor, përcaktuar sipas rregullorës së BQK-së mbi Ekspozimet e Mëdha, konsiderohet çdo ekspozim ndaj një personi të vetëm ose grup të ndërlidhur personash, vlera e të cilit tejkalon 10 përqind të kapitalit të klasit të parë të bankës. Ndërsa të gjitha ekspozimet e mëdha kreditore së bashku nuk mund të tejkalojnë më shumë se 300 përqind të kapitalit të klasit të parë. Këtu janë përjashtuar ekspozimet e degëve bankare

²⁹ Ekspozimet e mëdha të raportuara nga degët bankare nuk janë përfshirë në analizë, ngase nuk kualifikohen si të tilla sipas rregullores në fuqi. Duke operuar në cilësinë e degës së bankave të huaja, këto institucione nuk janë subjekt i rregullativës për fuqizim të raportit të ekspozimeve ndaj kapitalit të klasit të parë të bankës por ndaj kapitalit të klasit të parë të bankave amë, dhe pavarësisht kësaj, nuk mund të kalojnë shumë prej 25 milion euro.

³⁰ Raporti i gjithsej ekspozimeve të mëdha ndaj numrit të ekspozimeve.


Grafik 45. Struktura e profitit të sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK.

Shkalla e provizionimit, e shprehur si raport i shpenzimeve për provizione ndaj kredive neto, u zvogëluar në 0.4 përqind në vitin 2021 nga 1.2 përqind në vitin e kaluar.

Grafik 46. Kontribuesit kryesor në rritjen / zvogëlimin e profitit



Burimi: BQK.


Megjithatë, niveli i stokut të provizioneve të ndara është rritur përgjatë vitit, që kryesisht reflekton qasjen konzervative të bankave kundrejtë materializimit potencial të rrezikut të rritur kreditor, nxitur fillimisht nga kriza pandemike dhe së fundmi nga rritja e tensioneve gjeopolitike.

Të hyrat për sektorin bankar u rritën për 15.4 përqind si rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave nga jo-interesi (tarifat dhe komisionet) dhe deri në një masë të hyrave nga aktiviteti kreditor. Të hyrat neto nga jo-interesi ishin kontribuesit që ndikuan rritjen e profitit në raport me kontributin e të hyrave neto nga interesi. Të hyrat neto nga interesi u rritën për 5.9 përqind apo 11.2 milionë euro, si rezultat i të hyrave nga aktiviteti i rritur kreditor. Ndërsa të hyrat neto nga jo-interesi janë rritur për 35.3 milionë euro, si rezultat i rritjes së të

hyrave nga tarifat dhe komisionet dhe i rënies së shpenzimeve për provizione.

Por, margjina neto e interesit shënoi rënie të lehtë në 4.3 përqind nga 4.6 përqind në vitin paraprak, që mund t'i atribuohet efektit sasior për shkak të rritjes më të lartë të stokut të asetëve që sjellin interes (14.3 përqind rritje vjetore) se sa i çmimit - të hyrave nga interesi në këto asete (5.9 përqind rritje vjetore) (grafik 47).


Grafik 47. Të hyrat dhe shpenzimet e interesit



Burimi: BQK.

Gjithsej të hyrat nga interesi u rriten për 14.7 milionë euro gjegjësisht për 6.9 përqind. Ndërsa vetëm të hyrat nga interesi në kredi u rritën për 16.8 milionë euro (apo 8.5 përqind).

Grafik 48. Të hyrat dhe shpenzimet e jo-interesit



Burimi: BQK.


Të hyrat nga jo-interesi (tarifat dhe komisionet si dhe të ardhurat tjera operative) shënuan rritje prej 31.0 përqind, apo për 20.3 milionë euro (grafik 48 dhe 49).

Shpenzimet e interesit në depozita shënuan rritje prej 5.7 përqind, por që ndikimi i rritjes nuk u transmetua në profit për shkak të

efekteve më të larta pozitive të kategorive të tjera (grafik 46).

Shpenzimet e jo-interesit u zvogëluan për 24.5 përqind në 46.1 milionë euro, kryesisht si rezultat i shpenzimeve për provizione të cilat u zvogëluan konsiderueshëm për 22.8 milionë euro. Shpenzimet për tarifa dhe komisione u rritën për 7.8 milionë euro, ndërkohë që shpenzimet e përgjithshme dhe administrative u rritën për 12.5 milionë euro (11.6 përqind) të ndikuar nga shpenzimet e personelit dhe shpenzimet e përgjithshme (grafik 50).

Grafik 49. Struktura e të hyrave të sektorit bankar




Burimi: BQK.

Në muajt në vijim, profiti i sektorit bankar karakterizohet nga pasiguritë në rritje dhe presionet e shkaktuara nga kriza e luftës në Ukrainë, dhe për pasojë inflacioni i lartë. Dobësimi i aftësisë paguese të klientëve si dhe rritja e nevojës për ndarje të provizioneve për të mbuluar humbjet e mundshme mund të ndikojnë si në rënien e të hyrave të sektorit, ashtu edhe në rritje të shpenzimeve.

Afati maksimal i shtyerjeve të ripagimeve të kësteve prej jo më shumë se 9 muaj, i mundësuar me vendimin e fundit të ristrukturimeve në shkurt 2021, ka përfunduar në fund të vitit 2021³¹. Efektet e rritjes së rrezikut kreditor nuk janë vërejtur gjatë vitit 2021, por që dinamikat negative duke filluar që nga fundi i vitit mund ta përkeqësojnë performancën kreditore të klientëve në periudhën në vijim.

Grafik 50. Struktura e shpenzimeve të sektorit bankar



Burimi: BQK.

Përkeqësimi i mundshëm i portfolios kreditorë të klientëve do të ndikoj në të ardhurat e sektorit përmes rënies së të hyrave të interesit nga kreditë, përkatësisht, përmes mos-arkëtimit të principalit si dhe zbritjes së interesit të përlogaritur si pasojë e rritjes së pritshme të KJP-ve. Kërkesat për provizionim gjithashtu pritet të rriten konform rritjes së rrezikut kreditor, ndaj efekti negativ në pozitën e profitit pritet të ndjehet si nga ana e të hyrave ashtu edhe nga shpenzimet.

Ndërsa intensifikimi i përpjekjeve të bankave për digjitalizim të shërbimeve, si dhe rritja e kërkesës apo shfrytëzimit të këtyre shërbimeve nga ana e klientëve, do të jetë përfituese në aspekt të rritjes së efikasitetit të menaxhimit të kostove dhe rënies së shpenzimeve operative.


Indikatorët e profitabilitetit u rritën si rezultat i rritjes së profitit, dhe vazhdojnë të qëndrojnë në nivelin më të lartë në rajon. Kthimi mesatar në asete dhe kapital i sektorit bankar të Kosovës u rrit në 2.3 përkatësisht 19.5 përqind, nga 1.8 përkatësisht 15.6 përqind një vit më parë (grafik 51).

Këto nivele janë mjaft mbi mesataren e bankave të rajonit që shënuan normë të kthimit në asete prej mesatarisht 1.3 përqind dhe normë të kthimit në kapital prej 9.9 përqind. Edhe vendet e rajonit shënuan rritje në treguesit e profitabilitetit gjatë këtij viti, por më të ulët se sektori bankar në Kosovë,

³¹ [Udhezues-per-ristrukturim-te-kredive.pdf \(bqk-kos.org\)](https://www.bqk-kos.org/udhezues-per-ristrukturim-te-kredive.pdf)

prandaj edhe është rritur dallimin mes mesatares së Kosovës dhe këtyre vendeve.³²

Grafik 51. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK.

5.2.1 Rreziku ndaj luhatjeve të normave të interesit

Rritja e vazhdueshme e kreditimit afatgjatë nga bankat në një të anë, dhe pjesëmarrja e lartë e depozitave me afat më të shkurtër maturimi në anë tjetër, në përgjithësi, kanë rritur ekspozimin e sektorit bankar të Kosovës ndaj rrezikut të ndryshimeve në norma të interesit ngase kanë rritur mospërputhjen e maturitetit ndërmjet asetëve dhe detyrimeve që bartin interes.

Hendeku kumulativ ndërmjet asetëve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit në vitin 2021 ishte pozitiv prej 951.28 milionë euro, shumë pak më i lartë se viti paraprak. Detyrimet me ndjeshmëri ndaj normave të interesit shënuan rritje më të lartë vjetore, dhe atë në afatet e maturimit ‘deri në 90 ditë’ dhe ‘1-5 vite’, përderisa rritja e asetëve ishte më e ngadalësuar, dhe kryesisht në afatin e maturimit ‘mbi 5 vite. Niveli më i lartë i detyrimeve afatshkurtëra dhe rritja e mospërputhjeve në afatet e maturimit në mes pasurisë dhe detyrimeve, ndërlidhet me nivelin më të lartë të depozitave nga fluksi i ardhjes së diasporës, rritja e remitançave përmes kanaleve formale dhe jo formale dhe prirjet më të larta për të kursyer kundrejtë


³² Në vendet e rajonit përfshihen Shqipëria, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia Veriore dhe Mali i Zi. Burimi i informacionit është databaza e Treguesve të Shëndetit Financiar të FMN-së dhe bankat qendrore përkatëse. Të dhënat për Bosnen dhe Hercegovinën reflektojnë

shpenzimeve në rritjet e pasigurive që kanë karakterizuar dy vitet e fundit.

Bilanci i gjendjes së sektorit bankar në Kosovë karakterizohet kryesisht me norma fikse interesi (76.1 përqind e kredive janë me norma fikse), andaj sektori është i ndikuar nga lëvizjet e normave të interesit kryesisht në maturim të këtyre pozicioneve. Në afat të shkurtër, rritja e mundshme e kostos së financimit mund të ndikoj në rritjen e presionit në shpenzimet e sektorit, meqë kategoria kryesore e asetëve, kreditë, janë kontraktuar me norma fikse të interesit dhe kanë maturitet më të gjatë. Nëse analizojmë vetëm kreditë dhe depozitat, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të bilancit të bankave, hendeku kumulativ ndërmjet tyre rezulton negativ si pasojë e nivelit më të lartë të depozitave krahas kredive, posaqërisht për grupin me afat maturimi ‘1-5 vite’.

Krahasuar me vitin paraprak, hendeku pozitiv ndërmjet asetëve dhe detyrimeve u zgjerua për të gjitha afatet e maturimit ndërsa hendeku negativ për kategorinë me afat maturimi ‘1 deri në 5 vite’ u thellua tutje si rezultat i rritjes së depozitave me këtë afat maturimi (grafik 52).

Grafik 52. Asetet dhe detyrimet e ndjeshme ndaj normave të interesit



Burimi: BQK.

Zgjerimi i mospërputhjeve në këto kategori të afateve të maturimit mes asetëve dhe detyrimeve mund të paraqes rritje të ekspozimit ndaj rrezikut në luhatjen, respektivisht rritjen e normave të interesit për periudhat kohore përkatëse, ngase mund të

gjenden në shtator 2021 për shkak të mungesës së të dhënave më të vonshme.

rritë bilancin e shpenzimeve për refinancim të aseteve në raport me të hyrat që do të gjenerohen nga riinvestimi i mjeteve në këto afate.


5.3. Rreziku nga pozicioni në valuta të huaja

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të ndryshimeve në kurset valutore është zvogëluar krahasuar me vitin paraprak.

Pozicioni i agreguar neto i hapur për të gjitha valutat e huaja zbriti në 20.3 milion euro ekuivalente nga 21.6 milion euro, që konsiston në raport prej 3.7 përqind të kapitalit të klasit të parë krahasuar me 3.9 përqind sa ishte në vitin 2020 (grafik 53). Rënia e pozicioneve në valutë të huaj rezultoi kryesisht nga reduktimi i ekspozimeve ndaj valutës britanike dhe frangut zviceran.

Sipas valutave të veçanta, pozicioni neto ndaj kapitalit të klasit të parë për frangun zviceran rezulton në territor negativ, nga pozicioni pozitiv i vitit të kaluar si rezultat i rritjes së lartë të detyrimeve dhe rënies së aseteve në këtë valutë. Kjo do të thotë se sektori bankar është më i ekspozuar ndaj rrezikut të zhvlerësimit të mundshëm të euros ndaj këtyre valutave. Po ashtu edhe pozicioni neto për funtën britanike kaloi në territor negativ nga ai pozitiv, por si rezultat i rritjes më të lartë të detyrimeve krahas rritjes së aseteve në këtë valutë. Për dollarin amerikan, pozicioni neto i hapur negativ u zgjerua tutje, që nënkupton se bankat kanë rritur tutje detyrimet në këtë valutë.

Grafik 53. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë




Burimi: BQK.

Raporti i pozicioneve neto të hapura për çdo valutë individuale ndaj kapitalit të klasit të parë vazhdon të mbetet mjaft nën nivelin maksimal prej 15 përqind të lejuar sipas rregullores përkatëse. Prandaj, luhatjet valutore kanë ndikim marginal në gjendjen financiare të sektorit, marrë parasysh nivelin mjaft të ulët të pozicioneve të hapura në valuta të huaja. Kjo dëshmohet edhe përmes analizës 'stres test' që sugjeron nivel të ulët të ndjeshmërisë së pozitës kapitale të sektorit ndaj luhatjeve në kurset e këmbimit.

Rreziku i tërthortë kreditor nga ekspozimi në valutë mbetet i ulët ngase kreditë në valutë mbeten në nivel marginal. Kreditë në valutë të huaj përbëjnë vetëm 0.1 përqind të gjithëj kredive, dhe shënuan rënie prej 0.2 milionë euro të portfolios kreditorë në valutë nga viti paraprak.

Grafik 54. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj



Burimi: BQK.


Depozitat në valutë të huaj gjithashtu kanë pjesëmarrje të ulët, 4.6 përqind, ndërsa u rritën për 32.6 milionë euro nga viti paraprak (grafik 54).

5.4. Kapitali

Sektori bankar vazhdon të ketë normë kapitali mbi nivelet e kërkuara rregullative.³³ Megjithatë, aktiviteti i lartë kreditor përgjatë vitit 2021 ka rritur asetet e peshura me rrezik në bilancet e bankave, duke rezultuar që raporti i mjaftueshmërsë së kapitalit (TMK) të jetë më i ulët për 2.1 pikë përqindje, në nivelin 15.3 përqind, nga 17.4 përqind në vitin e kaluar.

Norma e kapitalit ndryshon ndërmjet bankave, me ç'rast kryesisht bankat me rëndësi sistematike kanë normë më të lartë të kapitalizimit. Në nivel sektori, varianca midis TMK-së së bankave individuale ndaj mesatares së sektorit bankar ka shënuar rënie (përafrit të TMK-së ndaj mesatares së sektorit). Pozita e kapitalizimit të sektorit reflektohet të jetë në nivel adekuat edhe nga treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit të klasit të parë ndaj asetëve të peshuara me rrezik, i cili qëndroi në 13.6 përqind, megjithëse më e ulët se në vitin e kaluar, për arsyen e njejtë, të rritjes së asetëve të peshuara me rrezik që konsistojnë kryesisht kreditë afatgjata (grafik 55).

Grafik 55. Kapitalizimi i sektorit bankar



Burimi: BQK.

Krahasuar me një vit më parë, norma e rritjes vjetore të APR-ve ishte pothuajse për pesë herë më e lartë (rritje prej 13.6 përqind nga 2.8 përqind një vit më parë dhe nga 11.7 përqind rritje në vitin para-pandemik), si rezultat i


³³ Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit duhet të jetë në çdo kohë mbi nivelin 12 përqind ndaj Asetëve të peshuara me rrezik. Kapitali bazë i klasit të parë duhet të jetë në çdo kohë së paku 4.9 përqind të APR-ve, ndërsa

përsheptimit të aktivitetit kreditues në rrethanat e rigjallërimit ekonomik pas periudhës pandemike dhe rritjes së optimizimit e zbutjes së perceptimit të rreziqeve nga ana e bankave. Kapitali rregullativ shënoi rënie vjetore prej 0.1 përqind, e ndikuar nga profiti më i ulët i mbajtur nga vitet paraprake, shkak i shpërndarjes së dividendës në fund të vitit.

Prandaj efekti më i lartë i rritjes së asetëve të peshuara me rrezik, dha kontribut më të lartë rënës, prej 2.1 pikë përqindje në treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit. Po ashtu zvogëlimi i lehtë i kapitalit rregullator kontribuoj në rënie të TMK-së për 0.03 pikë përqindje (Grafik 56).

Sektori bankar ka bazë të fortë të kapitalit rregullator, 89.1 përqind e të cilit është kapital i klasit të parë. Profiti i mbajtur ka pjesëmarrje të lartë në kapital të klasit të parë (35.9 përqind), që sugjeron që bankat janë të orientuara në krijimin e kapitalit kryesisht brenda aktivitetit të tyre (kapitalizimit të fitimit).

Grafik 56. Kontributi i Kapitalit Rregullator dhe APR-ve në Raportin e Kapitalizimit




Burimi: BQK.

Në kuadër të gjithsej kapitalit rregullativ rritje shënuan kapitali aksionar, vlera e emrit të mirë, dhe provizionet e mbajtura. Me rënie u karakterizua borxhi i ndërvarur dhe fitimi i mbajtur nga vitet paraprake (Grafik 57). Fitimi i mbajtur u reduktua për shkak të ndarjes së dividendës në tremujorin e fundit të vitit, shpërndarja e së cilës deri këtë kohë ishte

Kapitali rregullativ i klasit të parë duhet të qëndrojë minimalisht në 9 përqind në raport me APR-të.

e pezulluar si masë e përkohshme e ndërmarrë nga BQK gjatë pandemisë, me qëllim të ruajtjes së profitit të realizuar për mbulimin e kërkesave për provizione shtesë dhe si masë mbështetëse për përforsimin e pozitës së kapitalit dhe aktivitetit kreditues.

Grafik 57. Struktura e kapitalit rregullator



Burimi: BQK.

Indikatori i levës financiare (raporti i kapitalit të klasit të parë ndaj ekspozimeve pas korrigjimeve rregullative) në dhjetor 2021 qëndroi në 9.4 përqind (grafik 58). Ky raport qëndron lartë mbi minimumin e sugjeruar me kornizën e Basel III për levë financiare prej minimum 3.0 përqind³⁴, dhe sugjeron për pozitë të mirë të kapitalit.

Në kuadër të aseteve të peshuara me rrezik, asetet e peshuara për rrezik kreditor shënuan normë më të lartë të rritjes prej 14.3 përqind nga 2.8 përqind një vit më parë, që rezulton nga aktiviteti i rritur kreditor.


Ndërsa asetet e peshuara për rrezik operacional shënuan rritje prej 5.2 përqind nga 3.6 përqind. Pjesëmarrja e aseteve të peshuara sipas rreziqeve mbetet e ngjashme, me 93.2 përqind të APR-ve të peshuara për rrezik kreditor, 6.8 përqind për rrezik operacional dhe pjesë shumë e ulët, 0.0002 përqind për rrezik të tregut (grafik 59).³⁵

Asetet e peshuara për rrezikun kreditor (grafik 60) shënuan vlerën 3.7 miliardë euro (3.3 miliardë në vitin 2020). Në kuadër të këtyre aseteve dominojnë kreditë me pakicë (ang.

³⁴ Sipas Basel III, norma e leves llogaritet si raport ndërmjet kapitalit të klasit të parë dhe ekspozimeve pas ndryshimeve rregullative. Kjo normë duhet të jetë e barabartë apo mbi 3 përqind. BQK filloi llogaritjen e kësaj norme, sipas standardit të Basel III, nga viti 2020.

retail loans) me 43.9 përqind, pasuar nga ekspozimet ndaj korporatave me 19.9 përqind.


Grafik 58. Norma e levës



Burimi: BQK.

Kreditë hipotekare të mbështetura me pronë të paluajshme komerciale dhe rezidenciale kanë pjesëmarrje prej 14.5 dhe 8.2 përqind respektivisht. Ekspozimi ndaj bankave tjera, qeverive dhe bankave qendrore ishte relativisht i ulët prej 3.7 përqind dhe 2.0 përqind respektivisht.

Grafik 59. Raporti i APR-ve ndaj gjithsej aseteve të sektorit



Burimi: BQK.


Ekspozimet tjera të mbetura përbëjnë 7.8 përqind të ekspozimeve, që përfshijnë autoritetet lokale, sektorin publik, bankat zhvillimore, organizatat ndërkombëtare (grafik 60).

Sipas peshës së rrezikut, kategoria e peshuar me 100 përqind, që përbën edhe kategorinë me peshën më të theksuar në gjithsej asetet me rrezik (72.4 përqind), dhe që përfshinë

³⁵ Asetet e peshuara për rrezik të tregut u raportuan për herë të parë me fillim nga vitin 2020, sipas formatit të ri të raportimit të kërkuar nga BQK.

ekspozime me pakicë (retail/individët), kredi ndaj korporatave dhe kredi hipotekare të mbështetura me pronë komerciale (grafik 61 dhe 62), shënoi rritjen më të theksuar këtë periudhë (për 401.7 milionë euro).


Grafik 60. Asetet e peshuara me rrezik kreditor, pjesëmarrja



Burimi: BQK.

Po ashtu edhe asetet me peshë rreziku 75 përqind (që përfshinë kreditë me pakicë/retail dhe kreditë hipotekare e mbështetur me pronë të paluajtshme rezidenciale) shënuan rritje prej 9.4 përqind (apo për 61.5 milionë euro).


Grafik 61. Klasat e aseteve sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK.

Ndërsa vetëm kategoria e aseteve me peshë rreziku 20% që përfshinë kreditimin ndaj institucioneve financiare, qeverive dhe bankës qendrore, shënoi rënie për 9.7 përqind. Ky zhvillim sugjeron për rritje më të lartë të kreditimit në segmentin retail-për individët, korporatat dhe kreditimin hipotekar të mbështetur në pronë të paluajtshme rezidenciale (grafik 61 dhe 62).

Grafik 62. Struktura e APR-ve për rrezik kreditor, sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK.

5.5. Financimi dhe Rreziku i Likuiditetit

Pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar është përforcuar tutje, mbështetur kryesisht nga rritja e theksuar e depozitave të sektorit privat. Kriza pandemike rriti fillimisht pasigurinë e akterëve në sistemin financiar për presion të mundshëm në menaxhimin e likuiditetit. Megjithatë, rritja e preferencave për kursime kundrejt shpenzimeve, por edhe e mundësive të reduktuara dhe pasigurive për të shpenzuar në kohë të krizës, ndikoi që bilanci i financimit të bankave të jetë në favor të pozitës së likuiditetit, pozitë që u trashëgua edhe në vitin 2021. Prospektet për vitin 2022 dhe tutje japin indikacione për sfida të reja të rritura në kontekst të kostove të financimit. Fillimisht, rritja e depozitave nuk pritet të ketë trendin e rritjes sikurse në vitin 2021, dhe kjo do të nxisë konkurrencën e bankave në tërheqje/mbajtje të depozitave, duke ndikuar rritjen e kostove të financimit. Tutje, kostot e mbajtjes së likuiditetit do të sfidohen me rritjen e normave të interesit në nivel global të cilat transmetohen direkt përmes financimit nga bankat amë. Politikat monetare të disa bankave qendrore veçse janë kundërpërgjigjur rritjes së inflacionit përmes rritjes së normave bazë të interesit. BQE ka hezitur të ndërhyjë dhe ndryshoj politikën monetare në gjysmën e parë të vitit 2022, kryesisht si

pasojë e ndikimit që pritet të ketë rritja e kostos së financimit në disa nga ekonomitë e BE-së (recesionit potencial) dhe dobësimit të mëtejshëm të euros. Megjithatë, rritja persistente e inflacionit në nivele të papara në dekadën e fundit ka ndikuar që BQE të sinjalizoj për vendimin potencial të rritjes së normave të interesit në mbledhjen e këshillit në korrik 2022. Ndryshimet në normat e interesit në BQE do të afektojnë indirekt kostot e mbajtjes së likuiditetit dhe kostot e financimit në vend. Për më tepër, përkundër normës së lartë të likuiditetit në nivel sektori, shumica e bankave kanë shënuar rënie të raportit të likuiditetit nga viti i kaluar, ndër të cilat disa me rënie më të theksueshme.

Pozita e mirë e likuiditetit të sektorit gjatë vitit 2021 u mbështet tutje nga rritja e vazhdueshme e depozitave, dhe në veçanti depozitave të ekonomive familjare, të mbështetura kryesisht nga remitencat përmes kanaleve formale por edhe joformale (fluksi i lartë i diasporës me hapjen e mundësive për udhëtime). Sidoqoftë, rritja e inflacionit ka rritur pasigurinë, presionin për mbajtje të nivelit të depozitave në sektorin bankar dhe sfidat për dizajnimin e politikave të duhura ekonomike (fiskale e financiare). BQK, megjithëse më e kufizuar në spektrin e mekanizmave për injektim direkt të likuiditetit në treg (në mungesë të politikës monetare, BQK ka në dispozicionin instrumentin e Fondit të Likuiditetit Emergjent për injektim direkt të mjeteve në sektorin bankar), nevojat e mundshme për likuiditet mund t'i përmbushë edhe përmes mekanizmave tjera si menaxhimit të rezervave të likuiditetit, marrëveshjeve ndërbankare për likuiditet si dhe financimit nga bankat amë.


Nën ndikimin e gjendjes së pasigurisë si dhe normave të ulëta të interesit, pjesëmarrja e depozitave të transferueshme është zgjeruar, që në kombinim me rritjen e kreditimit afatgjatë kontribuan në theksimin e mospërputhjeve të maturimeve në mes të këtyre zërave. Megjithatë, indikatorët kryesor të likuiditetit japin sinjale pozitive për

gjendjen aktuale të likuiditetit bankar, ku niveli i lartë i rezervave të likuiditetit të bankave që mbahen në BQK por edhe i gjithsej asetëve likuide, e bën sektorin më rezistent ndaj efekteve të mundshme negative që mund të rezultojnë kur mospërputhjet e afateve të maturimit në mes të investimeve dhe financimit janë të theksuara.

5.5.1 Financimi bankar

Struktura e financimit të sektorit bankar dominohet nga financimi prej sektorit jo-bankar, kryesisht depozitave të sektorit privat, të cilat vazhduan rritjen.


Grafik 63. Struktura e financimit



Financimi ndër-bankar është në nivel shumë të ulët, dhe po ashtu bankat janë shumë pak të ekspozuara ndaj financimit në sektorin e jashtëm (grafik 63).

Këtë vit depozitat tejkaluan kreditë për 130.8 përqind, tregues që u zvogëlua për 3.6 pikë përqindje nga viti paraprak, nën ndikimet e rritjes më të lartë të kreditimit (grafik 64).

Grafik 64. Rritja e kredive dhe depozitave të sektorit bankar




Rritja e depozitave kryesisht të ekonomive familjare në këto rrethana të pasigurive dhe presioneve të inflacionit, reflekton preferencat për kursim ose mbajtje të depozitave të transferueshme për qëllime konsumi në dëm të investimeve.

Depozitat e ekonomive familjare vazhduan tredin e përsheptuar të rritjes në 13.8 përqind (13.2 përqind ishte në vitin 2020) stoku i të cilave arriti në 3.4 miliardë euro (grafik 65). Pjesa më e madhe e tyre ishin depozita të transferueshme, të cilat me rritjen e tyre vjetore prej 18.9 përqind kontribuan në rritjen e gjithsej depozitave të ekonomive familjare (grafik 66).

Depozitat e ndërmarrjeve shënuan trend më të përsheptuar të rritjes vjetore prej 19.3 përqind (11.1 përqind rritje vjetore në vitin 2020), e që mund të ndërlidhet me rritjen e aktivitetit të tyre biznesor me heqjen e masave kufizuese ndaj Covid-19 dhe hapjen e plotë të ekonomive. Rritja e depozitave mund të jetë po ashtu edhe efekt i mbështetjes financiare të ofruar në kuadër të pakove ndihmuese nga qeveria - masa për mbështetjen e bizneseve të prekura nga kriza pandemike. Rritja ishte veçanërisht e theksuar përgjatë fundit të vitit, më konkretisht muaji dhjetor 2021 përbën nivelin më të lartë të depozitimit.


Grafik 65. Struktura e depozitave



Stoku i depozitave të ndërmarrjeve arriti në 987.1 milionë euro, me pjesëmarrje 20.0 përqind në gjithsej depozitat.

Rritja e depozitave të ndërmarrjeve u ndikua kryesisht nga rritja e depozitave të transferueshme prej 22.7 përqind, duke qenë se edhe përbëjnë kategorinë me pjesëmarrjen më të lartë, kanë kontribuar në theksimin e rritjes së përgjithshme të depozitave të ndërmarrjeve. Pasiguritë e larta rreth ecurisë së aktivitetit të bizneseve për shkak të gjendjes pandemike dhe inflacionit, por edhe natyra e funksionimit të sektorit të biznesit, në përgjithësi kërkojnë mbështetjen më shumë në depozita të transferueshme për të mbuluar nevojat e tyre të likuiditetit dhe aktivitetit ditor, kundrejt mbajtjes së mjeteve në formë të depozitave të afatizuara.

Grafik 66. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit



Struktura e gjithsej depozitave sipas afatit të maturimit dominohet nga depozitat e transferueshme me pjesëmarrje prej 67.9 përqind, të cilat shënuan rritje edhe këtë vit, me normë vjetore prej 19.1 përqind (grafik 66).


Depozitat e transferueshme kryesisht posedohen nga ekonomitë familjare 64.0 përqind (ndërsa 26.5 përqind janë të ndërmarrjeve). Përderisa depozitat e transferueshme dhe depozitat e kursimit shënuan rritje vjetore prej 19.1 përqind dhe 14.4 përqind respektivisht, ato të afatizuara u karakterizuan me rënie vjetore prej 10.1 përqind.

Afatet e maturimit të depozitave dhe kredive theksojnë mospërputhjet strukturore ndërmjet tyre, të cilat janë më të shprehura tek afatet ‘deri në 1 vit’ dhe ‘mbi 1 vit deri në 2 vite’. Depozitat e afatizuara me afat të maturimit ‘mbi 2 vite’ dominuan strukturën e depozitave

të afatizuara, dhe rritën pjesëmarrjen e tyre relative në 49.5 përqind të gjithsej depozitave të afatizuara (nga 44.8), përderisa, kreditë me afat maturimi 'mbi 5 deri në 10 vite' janë ato që kanë pjesëmarrjen më të lartë, prej 39.3 përqind në gjithsej kreditë (grafik 67).

Pjesëmarrja e lartë e depozitave të transferueshme dhe e dominimit të depozitave me maturim afatshkurtër në njërin anë, dhe në anën tjetër rritja e kreditimit afatgjatë shton nevojat për mbikqyrje më prudente të financimit të qëndrueshëm të bankave, e veçanërisht në këtë periudhë të rritjes së lartë të inflacionit. Kostot e financimit mund të rriten me rritjen e mundshme të normave bazë të interesit si masë për kontrollim të inflacionit.

Grafik 67. Struktura e afateve të maturimit të depozitave dhe kredive




Përderisa financimi nga jashtë është në nivel të ulët, rritja e kostos së jetesës në vend për shkak të rritjes së inflacionit (nëse të ardhurat mbesin të pandryshuara ose kanë ndryshime marginale), do të rritë shpenzimet e jetës që rrjedhimisht do të ulë depozitat, duke krijuar në mënyrë direkte sfida për financim.

5.5.2 Rreziku i Likuiditetit

Spektori bankar vazhdon të mbajë pozitë të kënaqshme të likuiditetit, duke dëshmuar kapacitet për mbështetje të aktivitetit kreditues si dhe kapacitet të lartë për përballje me rreziqe të mundshme. Në vitin 2021, raporti i aseteve

likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra zbriti në 37.4 përqind krahasuar me 39.6 përqind në vitin 2020. Ky rezultat u ndikua nga rritja më e lartë e detyrimeve afatshkurtëra se sa rritja e aseteve likuide prej 12.8 përqind, dhe 6.6 përqind respektivisht. Mirëpo, raporti i ngushtë i likuiditetit, i cili përfshinë vetëm asetet shumë likuide (paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj, llogaritë rrjedhëse dhe plasmanet), në raport me detyrimet afatshkurtëra, u ngrit lehtësisht në 30.6 përqind nga 30.5 përqind një vit më parë, për shkak të rritjes më të lartë të aseteve shumë likuide prej 13.2 përqind.

Grafik 68. Indikatorët e likuiditetit



Raporti i aseteve likuide ndaj gjithsej aseteve zbriti në 28.9 përqind (30.2 përqind në vitin 2020), duke qenë se asetet u rriten më shpejtë kundrejt aseteve likuide (grafik 68). Megjithatë, norma më e lartë e raportit bazë të likuiditetit (raportit të aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra) se minimumi rregullator³⁶, tregon për potencial të sektorit për financim të zgjerimit të aktivitetit kreditues.

Rritja e aseteve likuide gjatë periudhës rezultoi kryesisht nga rritja e depozitave me maturitet afatshkurtër deri në 30 ditë të plasuar në bankat e vendit. Rritja konsiston në vlerë prej 73.5 milionë euro. Po ashtu kontribut të rëndësishëm në rritje të aseteve likuide kishte rritja prej 23.2 milionë euro e kategorisë dominuese që është rezerva e likuiditetit më bankën qendrore (me

³⁶ Raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra është i definuar në Rregulloren për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit prej 25 përqind (neni 17. Norma e likuiditetit)

pjesëmarrje prej 35.0 përqind), pastaj e parasë së gatshme për 20.7 milionë euro apo 9.0 përqind rritje vjetore, si dhe rritja e fletëobligacioneve të qeverisë së Republikës së Kosovës prej 19.5 milionë euro, apo rritje vjetore prej 10.0 përqind.

Ndërsa, rënie shënoi kategoria e llogarisë rrjedhëse që bankat mbajnë në banka dhe institucione të tjera financiare, prej 21.2 përqind, apo për 51.7 milionë euro. Rënie shënuan edhe depozitat dhe plasmanët në bankat e tjera jashtë vendit, për 5.9 milionë euro (4.9 përqind rënie vjetore) si dhe fletëobligacionet e qeverive të huaja prej 0.3 përqind (412 mijë euro).


Rezervat e likuiditetit të bankave komerciale vazhdojnë të jenë në nivele të larta, duke tejkaluar rezervën e obliguar të mbajtur në BQK për 68.3 përqind. Nga gushti i vitit 2016, BQK ka aplikuar normë negative të interesit mbi tepricën e rezervës së obliguar që bankat komerciale në vend i mbajnë në bankën qendrore, në linjë me vendimin e BQE-së për aplikim të normave negative në depozita.

Aplikimi i normës negative ndikoi tepricën e rezervës menjëherë në muajin vijues (në shtator të vitit 2016 teprica u zvogëlua për 29.9 përqind), por që efekte afatgjata të masave përmes aplikimit të normës negative në nivelin e tepricës së rezervës, nuk janë vërejtur, potencialisht për shkak të mundësive të kufizuara për alokimin dhe investim të mjeteve (grafik 69)³⁷. Megjithatë niveli i tepricës së rezervave bankare gjatë vitit 2021 prej 68.3 përqind është ulur krahas vitit 2020 (që ishte në nivelin 82.3 përqind), si rezultat i rritjes vjetore shumë më të lartë të aktivitetit kredidhënës, përkundër rritjes së vazhdueshme të depozitave.

Ambienti i normave të ulëta të interesit në vitet e fundit ka stimuluar ekonominë familjare të zhvendosin depozitat e tyre në favor të maturitetit afatshkurtër, që krahas trendit të rritjes së kreditimit

afatgjatë ka rezultuar në theksimin e mospërputhjeve të maturitetit ndërmjet aseteve dhe detyrimeve.

Grafik 69. Rezervat e likuiditetit



Burimi: BQK.

Mospërputhjet e afateve të maturimit ndërmjet investimeve dhe financimit po rriten në kushtet kur depozitat e transferueshme janë rritur dhe afatet e maturimit të kredive janë zgjatuar, lëvizje kjo që rritë ekspozimin ndaj rrezikut të likuiditetit.

Hendeku kumulativ i likuiditetit në vitin 2021 u ngushtua në 598.8 milionë euro nga 619.0 milionë euro një vit më parë. Në këtë rezultat ka ndikuar kryesisht zgjerimi më i theksuar i hendekut negativ ndërmjet aseteve dhe detyrimeve të afateve të maturimit “1 deri 7 ditë”, për shkak të rritjes më të lartë të detyrimeve me këtë maturitet. Rreth 77.2 përqind e detyrimeve kategorizohen në afatin “1-7 ditë” në raport me asetet e këtij afati që përbëjnë vetëm 22.1 përqind të gjithsej aseteve. Kategoritë e tjera të afateve të maturimit po ashtu shënuan rritje dhe krijojnë hendek pozitiv të likuiditetit. Zgjerimi i radhës më i lartë ishte te hendeku pozitiv ndërmjet aseteve dhe detyrimeve të afateve të maturimit “1 deri në 5 vite”, për shkak të rritjes më të lartë të aseteve me këtë maturitet. Rreth 37.2 përqind e aseteve kategorizohen në afatin “1-5 vite” në raport me detyrimet e këtij afati që përbëjnë vetëm 10.8 përqind të gjithsej detyrimeve.

³⁷ Teprica e likuiditetit karakterizohet me efekte të sezonalitetit. Tendenca për rritje të nivelit të rezervave të tepërta të likuiditetit vërehet gjatë muajve të tremujorit të tretë dhe në muajin dhjetor të viteve përkatëse.

Grafik 70. Hendeku i likuiditetit*



Burimi: BQK.

Rrjedhimisht, mospërputhjet e afateve të maturimit të zërave bilancor janë më të theksuarat në kategoritë e maturimit '1-7 ditë' dhe '1-5 vite' (grafik 70). Kjo situatë paraqet sfidë për menaxhimin e likuiditetit të bankave me vazhdimësinë e rritjes së hovshme të kreditimit afatgjatë.

5.6. Kapacitetit absorbues i goditjeve - analiza Stress-Test³⁸

Qëndrueshmëria e sektorit bankar ndaj pasojave të krizës pandemike Covid-19 dhe dinamikave të tjera jo të favorshme si rritja e inflacionit, është testuar dhe vlerësuar përmes kalibrimit të skenarëve të bazuar në parashikime të mundshme të ngjarjeve për periudhën e ardhshme një vjeçare. Megjithatë, zhvillimet dhe rrjedhimisht supozimet janë përcjellë me pasiguri të mëdha, për shkak se masat e ndërmarra nga autoritetet vendore për të zbutur krizën pandemike kanë izoluar efektet direkte të pandemisë në bilancet e sektorit bankar. Po ashtu, situatat e reja të krijuara nga rritja e inflacionit dhe vendosja e sanksioneve ekonomike ndaj Rusisë për shkak të luftës së filluar në Ukrainë, përcjellen me pasiguri rreth kohëzgjatjes dhe efekteteve zingjirore që do të pasojnë e që e subjektivizojnë performancën ekonomike të të gjithë akterëve në treg. Ndërtimi i skenarëve për rrezikun kreditor do të përfshijë goditjet makroekonomike në portfolion kreditor dhe

pozitën kapitale. Në këtë ushtrim janë konsideruar tre skenarë në nivel sektori të bazuara në supozimet e goditjeve të aktivitetit ekonomik në portfolion kreditor dhe kapitalin, supozime që janë ndërtuar mbi nivelet e parashikuara të rritjes së inflacionit³⁹, duke qenë faktori nxitës në krijimin e dinamikave të reja në treg.

Masat e paprecedenta stimuluese të ndërmarra nga autoritetet vendore për të ndihmuar ekonominë që të rimëkëmben nga pandemia, kanë nxitur rritjen e çmimeve në shumë ekonomi. Rrjedhimisht performcimi i theksuar i kërkesës së përgjithshme me rihapjen e ekonomive nuk u shoqërua me rritje të ofertës si pasojë e ndërprerjeve masive në zingjirët prodhues të mallrave, duke shkaktuar kështu presione inflacioniste. Mospërputhjet globale mes kërkesës dhe ofertës për energji, produkte ushqimore dhe produkte të tjera, u përkeqësuan me fillimin e luftës në Ukrainë, që është duke e rënduar rendin ekonomik botëror. Lufta dhe vendosja e sanksioneve ekonomike e financiare ndaj Rusisë do të ketë implikime negative në ngadalësimin e aktivitetit ekonomik botëror dhe rritjen tutje të çmimeve. Çmimet e rritura të energjisë dhe lëndëve të para përveç se janë duke shkatuar pengesa në prodhim, njëkohësisht kanë ulur fuqinë blerëse të konsumatorit dhe besueshmërinë e tij në treg për shkak të pasigurive të krijuara mbi të ardhmen. Prandaj implikimet direkte të inflacionit në fuqinë blerëse të konsumatorit dhe standardin jetësor janë të një rëndësie të veçantë për efektin zingjiror që do të kenë në performancën kreditor të kredimarrësve (zvogëlimi i aftësisë paguese) dhe në likuiditetin e bankave (zvogëlimi i depozitave për shkak të rritjes së shpenzimeve nga efekti i inflacionit).

Në këtë analizë është përfshirë po ashtu supozimi i ndryshimeve në norma të interesit. Banka e Anglisë (BoE) dhe Rezerva Federale e SHBA-së (FED) u janë përgjigjur inflacionit me

³⁸ Stress Test nuk përfaqëson një model parashikimi, por përmban skenarë të supozuar të goditjeve makroekonomike dhe financiare me qëllim të matjes së rezistencës së sektorit bankar ndaj këtyre goditjeve negative, pa paragjykimë që situata të tilla mund të ndodhin apo priten të ndodhin në të ardhmen.

³⁹ Norma e rritjes së inflacionit është parashikuar me modelin statistikor ARIMA.

ndërmarrjen e masave të politikës monetare përmes rritjes së normave bazë të interesit. Po ashtu praktikat dëshmojnë se në kohë krize kreditë e reja do të konsideroheshin me rrezikshmëri më të lartë prandaj edhe mund të pritet rritje e normës së interesit. Gjithsesi lëvizjet në normat e interesit në vend janë subjekt i sentimentit të bankave ndaj rreziqeve dhe performancës kreditore të klientëve por edhe zhvillimeve dhe ndryshimit të normave të interesit në eurozonë. Rrjedhimisht në skenarët e përpiluar është supozuar që normat e interesit do të rriten për shkak të rritjes së rreziqeve në treg si rezultat i pasigurive mbi të ardhmen e konfliktit dhe presioneve të inflacionit.

Sipas rezultateve nga testi i goditjeve në portfolion kreditore, pozita kapitale e sektorit bankar, në përgjithësi, do të mund të përballonte goditjet në dy nga tre skenarët e dizajnuar (grafik 71, tabela 7). Në nivel të bankave, në skenarin më të rëndë, shumë prej tyre do të përballëshin me nevojën për kapital shtesë për përballim të goditjeve në portfolion e tyre kreditor.⁴⁰

Rezultatet nga testi i goditjeve në pozitën e likuiditetit sugjerojnë se sektori bankar posedon kapacitet financiar për të përballuar situatat e supozuara të tërheqjes së një shume të konsiderueshme të depozitave. Në të gjithë skenarët e supozuar, pozita e likuiditetit e shumicës së bankave rezulton e qëndrueshme, përjashtuar në supozimin e tërheqjeve të 38.6 përqind të depozitave në fund të ditës së pestë me radhë, ku katër banka do të paraqiteshin me mungesë të mjeteve likuide (tabela 9).

5.6.1. Vlerësimi i qëndrueshmërisë ndaj goditjeve në portfolion kreditore dhe pozitën kapitale

Analiza stres-test për rrezikun kreditor vlerëson qëndrueshmërinë e sektorit bankar, për periudhën një vjeçare bazuar në gjendjen e këtij viti, ndaj tronditjeve të mundshme në portfolion kreditore si dhe në pozitën kapitale, nga zhvillimet e pafavorshme. Analiza është realizuar përmes aplikimit të tri skenarëve: skenarit bazë, të moderuar dhe atij të rëndë që si pikënisje kanë supozimet e rënies së aktivitetit ekonomik nga rritja e inflacionit (tabela 5 dhe 6). Në dy skenarët e parë, rritja e kreditimit është supozuar të jetë 10.1 përqind, më e ulët se rritja e këtij viti, dhe 7.0 përqind në skenarin e rënduar, për shkak të pasigurive rreth ecurisë së inflacionit dhe aktivitetit ekonomik (tabela 5).

Skenari bazë mbështetet në zhvillimet makroekonomike të pritshme. Në këtë skenar, aktiviteti ekonomik në vend parashikohet të ketë një rritje pozitive prej 2.5 përqind. Rritja ekonomike supozohet se do të shoqërohet me rritje më të ngadalësuar të kreditimit⁴¹ (tabela 5 dhe 7). Po ashtu është supozuar se do të realizohen të hyra më të larta ngase të hyrat nga interesi në kredi mund të rriten nga rritja e kreditimit. Këto supozime janë reflektuar në llogaritjen e profitit për vitin 2022 ashtu që për bazë është marrë profiti neto pas tatimit të realizuar gjatë vitit 2021, ndaj të cilit pastaj është aplikuar zbritja e të hyrave që do të realizoheshin po qe se nuk do të rriteshin KJP-të. Në këtë rast profiti do të jetë më i ulët se në vitin aktual për 1.7 përqind për shkak të rritjes së KJP-ve krahas rritjes së kreditimit.⁴² Rezultatet në bazë të këtyre supozimeve sugjerojnë që raporti i kredive jo performuese do të rritet për 0.91 pikë përqindje, por sektori rezulton të jetë rezistent ndaj rritjes së KJP-ve, me ç'rast norma e kapitalizimit do të përmirësohet në 16.0 përqind nga niveli aktual


⁴⁰ Në analizë janë përfshirë 10 nga 11 banka që operojnë në tregun e Kosovës. Banka Credins nuk është përfshirë duke qenë në fillim të aktivitetit të saj.

⁴¹ Sipas parashikimeve të bankave për 2022, rritja vjetore e kreditimit të sektorit bankar do të jetë mesatarisht 10.1 përqind (siguruar nga Departamenti i Mbikqyrjes Bankare)

⁴² Ndikimi i këtyre zhvillimeve në cilësinë e portfolios kreditore është llogaritur përmes koeficientit të elasticitetit të kredive jo-performuese ndaj hendekut të prodhimit prej 0.8pp. Material kërkimor i FMN-së, i papublikuar, 'CESE Bank Loss Projection and Stress Testing Exercise', Korrik 2009.

15.1 përqind⁴³. Rritja e normës së kapitalizimit rezulton për shkak se të hyrat e pritura për t'u realizuar në vitin në vijim janë më të mëdha se kërkesat për provizionet e pritura shtesë, si dhe për shkak të përfshirjes së profitit të realizuar në vitin aktual në përlllogaritjen e nivelit të kapitalit, nën supozimin që nuk do të shpërndahet dividendë (grafik 71, grafik 72, tabela 7). Përkeqësim të pozitës së kapitalit do të kishin dy banka, të cilat janë degë bankare dhe rrjedhimisht nuk janë subjekt i kërkesës minimale për kapital prej 12 përqind.

Grafik 71. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit, sipas skenarëve



Burimi: BQK.

Në dy skenarët e tjerë është supozuar se do të ketë stagflacion, rënie të aktivitetit ekonomik e shoqëruar nga niveli më i lartë i inflacionit. Intensifikimi i luftës në Ukrainë dhe vendosja e sanksioneve ekonomike e financiare ndaj Rusisë, kohëzgjatja e të cilave mbetet e pasigurt por që pasojat do të jenë evidente, do të përkeqësoj tutje kufizimet në anën e ofertës që potencialisht do të presionojnë akoma më shumë çmimet. Inflacioni në vend pritet të jetë dukshëm më i lartë krahasuar me skenarin bazë pasi që shporta e konsumatorit kosovar ka një pjesëmarrje të lartë të kategorive më të prekura (ushqimi dhe transporti) nga kriza e re e krijuar dhe të cilat janë duke shënuar rritjen më të lartë të çmimeve. Rritja e çmimeve do të ndikoj direkt në standardin jetësor dhe aftësinë paguese të konsumatorit.

Skenari i moderuar supozon se aktiviteti ekonomik do të pësoj rënie prej 4.7 përqind në vitin 2022. Rrjedhimisht, duke u bazuar në

koeficientin e elasticitetit të KJP-ve ndaj rritjes ekonomike, norma e kredive jo-performuese do të rritet për 6.7 pikë përqindje, në 8.9 përqind (tabela 6). Këto supozime janë reflektuar në llogaritjen e profitit për periudhë një vjeçare ashtu që për bazë është marrë profiti neto pas tatimit të realizuar për vitin 2021, i reduktuar për të hyrat që nuk do të realizohen për shkak të rritjes së normës KJP-ve.⁴⁴ Profiti për vitin 2022 do të pësojë tronditje duke u zvogëluar për 12.7 përqind, si rezultat i rritjes së shkallës së dështimit të kredive. Humbjet e sektorit do të arrinin vlerën prej 196.0 milionë euro (grafik 72). Këto humbje do t'i ngarkohen direkt kapitalit, por niveli i lartë i provizioneve aktuale të mbajtura për të mbuluar dështimin e kredive bën që sektori të jetë më rezistent ndaj goditjeve të supozuara në këtë skenar, me treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit që do të zbriste në 12.0 përqind. Megjithatë, gjashtë banka do të rezultonin të nënkapitalizuara, përfshirë dy banka me rëndësi të përgjithshme sistemike, për të cilat norma e mjaftueshmërisë së kapitalit do të zbriste në 10.8 përqind dhe 9.9 përqind, respektivisht. Mjetet shtesë të nevojshme për ngritjen e kapitalit në nivelin minimal të kërkuar do të arrijnë vlerën prej 54.4 milionë euro (tabela 7).

Në skenarin e rënduar janë vlerësuar zhvillime negative më ekstreme të dinamikave aktuale dhe ndjeshmëri më e lartë e aktivitetit ekonomik në vend ndaj këtyre zhvillimeve, megjithëse me probabilitet më të ulët ndodhjeje. Inflacioni supozohet se do të rritet deri në 20.0 përqind ndërsa rënia ekonomike do të jetë 11.6 përqind. Kjo gjendje mund të karakterizohet me pasiguri të shtuara në realizimin e të ardhurave dhe dobësim të mëtejshëm të aftësisë paguese të huamarrësve. Ndërsa kreditimi është supozuar se do të rritet për 7.0 përqind, në shkallë të njejtë si në vitin pandemik kur shumica e aktiviteteve ishin të kufizuara ose edhe të ndaluara. Sektori bankar

⁴³ Raporti i provizionimit sipas shtyllave kreditore për secilën bankë, për të llogaritur provizionet shtesë të nevojshme me rritjen e KJP-ve, është përcaktuar të jetë i njëjtë me raportin e provizionimit të secilë bankë korresponduese, që kanë realizuar në vitin 2021.

⁴⁴ Vlerësimi i të hyrave të 'humbura' si pasojë e rritjes së KJP-ve është bërë fillimisht duke llogaritur ex-post normën e përgjithshme të interesit në kredi për secilën bankë, e cila më pastaj është shumëzuar me vlerën e shtuar të KJP-ve.

do të përballej me rritje të raportit të kredive joperformuese për 12.2 pikë përqindje, duke u rritur deri në 14.4 përqind. Në analizë nuk konsiderohet mundësia e realizimit të kolateralit apo rritja e kapitalit nga burime të tjera, duke qenë se efikasiteti dhe mundësia e realizimit të këtyre veprimeve është shumë e pasigurt në kohë krize. Profiti do të pësoj tronditje nga rritja e shkallës së dështimit të kredive ekzistuese, duke u zvogëluar për 22.5 përqind.

Humbjet e sektorit do të arrinin vlerën prej 336.7 milionë euro (grafik 72) dhe niveli i kapitalizimit pas goditjes do të zbrës në 8.6 përqind, nën minimumin rregullator (tabela 6). Numri i bankave me probleme në pozicionin e kapitalit do të rritej në tetë, prej tyre katër banka me rëndësi sistemike, TMK e së cilave do të zbrisnin në 10.6 përqind, 8.8 përqind, 8.1 përqind dhe 6.5 përqind. Mjetet shtesë të nevojshme për ngritjen e kapitalit në nivelin minimal të kërkuar do të arrinin vlerën 160.1 milionë euro (grafik 72, tabela 7).


5.6.1.1 Skenari i rrezikut kreditor kombinuar me rrezikut e tregut

Skenari i moderuar i rrezikut kreditor, që parasheh rënie ekonomike prej 4.7 përqind, është shoqëruar me skenarin e rrezikut të tregut, përkatësisht me supozimin mbi rritjen prej 2.0 pikë përqindje të normave të interesit në pozicionet bilancore të sektorit bankar (tabela 5). Praktikisht dëshmojnë se në kohë krize reagimi fillestar i kreditorëve do të ishte rritja e normave të interesit për shkak të rritjes së rrezikut. Ndërsa si kundërpërgjigje kërkesa për huamarrje do të zvogëlohej për shkak të pasigurisë që krijohet për të investuar e që rrjedhimisht në fazë të mëvonshme do të krijonte presione për zvogëlim të normave të interesit me qëllim të stimulimit të aktivitetit ekonomik. Megjithatë, supozimi i rritjes së normave të interesit në këtë skenar është mbështetur në situatën aktuale të inflacionit të rritur dhe në faktin se disa autoritete monetare (Rezerva Federale e SHBASë dhe Banka e Anglisë) tashmë i kanë ngritur normat bazë të interesit për kontrollim të inflacionit, dhe parashohin rritje të mëtejme të tyre përgjatë vitit 2022. Po ashtu autoriteti

monetar i Eurozonës ka dhënë sinjale se mundësia për rritjen e normave bazë të interesit nuk përjashtohet, dhe kjo në mënyre indirekte do të ndikoj edhe normat e interesit në vend. Analiza mbështetet në gjendje statike 1 vjeçare të bilancit të gjendjes, prandaj konsiderohet se të njëjtat instrumente që maturojnë brenda një viti do të riinvestohen dhe rifinancohen me norma të interesit të supozuara në këtë skenar.

Pjesëmarrja e kredive jo performuese ndaj gjithsej kredive mbetet e njëjtë si në rrezikun e moderuar kreditor, në 8.9 përqind. Ndërsa humbjet e sektorit me aplikimin e supozimit mbi rritjen e normave të interesit do të zvogëloheshin në vlerën prej 187.1 milionë euro nga 196.0 milionë euro nga skenari i moderuar (grafik 72). Supozimi i rritjes së normave të interesit ka dhënë efekte pozitive në të hyrat neto nga interesi, duke rezultuar nga fakti se sektori ka hendek pozitiv të bilancit me ndjeshmëri ndaj normave të interesit dhe nën supozimin se të njëjtat pozicione do të riinvestohen, atëherë si rrjedhojë të hyrat e sektorit do të jenë më të larta edhe pse me efekte të tjera negative që mund të ketë ky supozim (si rritja e kostos për huamarrësit).

Grafik 72. Rezultatet e stress testit për rrezikun kreditor-humbjet dhe rikapitalizimi



Niveli i kapitalizimit pas goditjes rezulton 12.2 përqind për vitin 2022, që është mbi kërkesat rregullative (tabela 7). Në nivel të bankave individuale, gjashtë banka do të përballeshin me probleme kapitalizimi, nga të cilat dy banka me rëndësi të përgjithshme sistemike, TMK e të cilave do të ju zbriste në 10.5 përqind dhe 10.1 përqind, respektivisht. Mjetet shtesë të nevojshme për ngritjen e kapitalit në nivelin

minimal të kërkuar do të ishin gjithsej 53.8 milionë euro (grafik 72 dhe tabela 7).

5.6.1.2 Skenari i rrezikut nga dështimi i ekspozimeve të mëdha kreditore

Në këtë skenar është vlerësuar qëndrueshmëria e bankave ndaj dështimit të mundshëm të tre dhe pesë kredimarrësve më të mëdhenj. Supozimi i dështimit të tre kredimarrësve më të mëdhenj do të ndikonte që niveli i kapitalizimit të sektorit të bie në 12.1 përqind dhe humbjet të arrijnë në 190.3 milionë euro (grafik 72 dhe tabela 7).⁴⁵ Pesë banka do të përballëshin me humbje të larta, ndër to dy degë bankare që nuk janë subjekt i rregullativës mbi kapitalin dhe dy banka me rëndësi të përgjithshme sistemike, TMK e së cilave do të zbriste në 10.5 dhe 10.9 përqind, respektivisht.

Dështimi i pesë kredimarrësve më të mëdhenj do ta përkeqësonte edhe më tej gjendjen në këto pesë banka, si dhe një bankë tjetër që gjithashtu do të rezultonte e nën kapitalizuar. Humbjet do të arrinin në 270.0 milionë euro dhe TMK e sektorit do të zbriste në 10.1 përqind. Bankave të nën-kapitalizuara do të iu nevojiteshin 72.4 milionë euro shtesë për ngritje të kapitalit në nivelin minimal rregullativ (grafik 72 dhe tabela 7). **Rezultatet e këtij skenari sugjerojnë se**

sektori është i ndjeshëm ndaj ekspozimeve të mëdha, performanca e të cilave duhet të monitorohet për së afërmi në kushtet e krizës aktuale. Gjithashtu theksohet se rritja e përqendrimit të ekspozimeve kreditore në kushte të thellimit të mëtejme të krizës ekonomike paraqet rritje të theksuar të ndjeshmërisë së rrezikut kreditor.

5.6.1.3 Kapacitet kapitale të bankave për absorbim të rritjes së kredive-joperfomuese

Sektori bankar është në gjendje të përballoj një raport të KJP-ve ndaj gjithsej kredive deri në 8.87 përqind pa u paraqitur nevoja për injektim të kapitalit shtesë për mbajtjen e TMK-së së sektorit në nivelin e kërkuar rregullator. Po ashtu, nivelet përballuese të KJP-ve të secilës bankë para se të shfaqen probleme me kapitalin paraqiten të larta për disa banka. Përfundimisht bën njëra bankë me rëndësi sistemike e cila do të mund të përballonte rritje të normës së KJP-së vetëm deri në 6.1 përqind. Niveli më i lartë i përballimit të rritjes së normës së KJP-së është 15.9 përqind të gjithsej portofolit të kredive, para se bankës të i paraqitet nevoja për kapital shtesë.

Tabela 5. Supozimet për skenarët e rrezikut kreditor

Indikatorët	Skenari bazë	Skenari i moderuar	Skenari i rëndë
	Supozimet		
BPV (norma e rritjes reale, %)	2.5	-4.7	-11.6
Kredia bruto (norma e rritjes së kreditimit, %)	10.1	10.1	7.0
Rritja e normave të interesit në pozicionet bilancore (për pikë përqindje)	n/a	2.0 pp	n/a
Profiti (normë e rritjes së profitit, %)	-1.7	-12.7	-22.5

Burimi: BQK.

⁴⁵ Ekspozimet e mëdha të raportuara nga degët bankare janë përfshirë në analizë, që megjithëse duke operuar në cilësinë e degës së bankave të huaja, këto institucione nuk janë subjekt i rregullativës për kufizim të raportit

të ekspozimeve ndaj kapitalit të klasit të parë të bankës por ndaj kapitalit të klasit të parë të bankave amë, pavarësisht kësaj, nuk mund të kalojnë shumë prej 25 milion euro.

Tabela 6. Koeficienti i elasticitetit të normës së KJP-ve

Përshkrimi	Elasticiteti	Reagimet e normës së KJP-ve		
		Skenari bazë	Skenari i moderuar	Skenari i rëndë
Zgjerimi i hendekut të prodhimit	0.80 pp	0.91 pp	6.67 pp	12.19 pp

Burimi: BQK.

Tabela 7. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik kreditor

Përshkrimi	Numri i bankave me TMK<12%	Norma e kapitalizimit			Norma e KJP-ve			Mjetet shtesë të nevojshme për rikapitalizim (në mijëra euro)
		niveli më i lartë	niveli më i ulët	niveli i sektorit	niveli më i lartë	niveli më i ulët	niveli i sektorit	
Nivelet aktuale (para goditjeve)		52.5	10.1	15.1	3.1	0.0	2.2	
Rezultatet e skenarëve								
Skenari bazë: Rritja e normës KJP për 0.91pp, rritja e kreditimit për 10.1%, rënia e profilit për 1.7%	2	52.9	9.0	16.0	4.0	0.9	3.2	4,820
Skenari i moderuar: Rritja e normës KJP për 6.67pp, rritja e kreditimit për 10.1%, rënie e profilit për 12.7%	6	52.2	5.2	12.0	9.8	6.7	8.9	54,359
Skenari i rënduar: Rritja e normës KJP për 12.19pp, rritja e kreditimit për 7.0%, rënia e profilit për 22.5%.	8	51.7	1.8	8.6	15.3	12.2	14.4	160,122
Skenari i moderuar i rrezikut kreditor në kombinim me rrezikun e tregut	6	52.7	4.9	12.2	9.8	6.7	8.9	53,769
Dështimi i tre kredimarrësve më të mëdhenjë	5	18.6	10.5	12.1	36.8	2.2	8.7	22,666
Dështimi i pesë kredimarrësve më të mëdhenjë	6	16.4	8.3	10.1	51.4	2.2	11.6	72,428

Burimi: BQK.

5.6.2 Vlerësimi i qëndrueshmërisë ndaj goditjeve në pozitën e likuiditetit

Testi i qëndrueshmërisë së pozitës së likuiditetit të sektorit bankar ka për qëllim që të vlerësoj aftësinë financuese të bankave për të përballuar mungesën e likuiditetit të shkaktuar nga situatat ekstreme.

Testi është mbështetur në dy skenarë hipotetik që vlerësojnë mjaftueshmërinë e mjeteve likuide të bankave për të përballuar tërheqjet e një vlere të depozitave brenda 5 ditësh si dhe përballimin e rrezikut nga dështimi i depozitave të koncentruara. Skenarët janë mjaftë konzervativ për faktin se nuk është marrë parasysh mundësia që bankat të plotësojnë një pjesë të nevojave të likuiditetit përmes burimeve të jashtme të financimit.

Skenari 1: Tërheqja e depozitave në baza ditore


Në këtë skenar është konsideruar tërheqja e depozitave të ndara sipas strukturës dhe subjekteve, në nivele të ndryshme të tërheqjeve në baza ditore (tabela 8), për pesë ditë radhazi. Pas çdo dite ndahen 5 përqind të depozitave nga depozitat e mbetura për qëllime të operimit të bankës në ditët vijuese. Kjo nënkupton që, nën paraqitjen e skenarëve të supozuar, rezerva e detyrueshme prej 10 përqind do të përgjysmohej. Skenari po ashtu është ndërtuar mbi supozimin se gjatë kësaj periudhe mundësia e shndërrimit të mjeteve likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind e mjeteve likuide, ndërsa e mjeteve jo-likuide do të ishte vetëm 1 përqind e këtyre mjeteve brenda ditës.

Tabela 8. Supozimet për skenarët e rrezikut të likuiditetit

Tërheqja e depozitave	Supozimet për tërheqjet kohore	Niveli i tërheqjes së depozitave
Ekonomitë familjare - Depozitat e transferueshme	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	10.0%
Ndërmarrjet - Depozitat e transferueshme	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	9.0%
Subjektet e tjera - Depozitat e transferueshme	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	8.0%
Depozitat e kursimit	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	10.0%
Depozitat e afatizuara	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	8.0%
Pesë depozitorët më të mëdhenj	Brenda ditës	100.0%
Njëzet depozitorët më të mëdhenj	Brenda ditës	100.0%

Burimi: BQK.

Përderisa sektori bankar në Kosovë nuk ka historik të krizave të mëparshme financiare dhe praktika e pandemisë nuk dha nivele të larta të tërheqjeve të depozitave, atëherë janë supozuar nivele më ekstreme për të vlerësuar kapacitetin e sektorit bankar për të përballuar humbjet po qe se situatë e tillë do të ndodhte dhe ky nivel i tërheqjeve të depozitave do të materializohej. Këto nivele më ekstreme janë bazuar në eksperiencat e vendeve të rajonit, të cilat kanë përjetuar situatat të tërheqjeve të konsiderueshme të depozitave në të kaluarën.

Grafik 73. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit -Skenari 1



Burimi: BQK.

Rezultatet e skenarëve sugjerojnë që pjesa më e madhe e bankave do të mund të përballonin tërheqjen e depozitave sipas niveleve të përcaktuara, në baza ditore deri në ditën e katërt, ku një bankë do të paraqitej me nevoja për likuiditet. Në ditën e pestë probleme me likuiditet do të paraqiteshin në katër banka, duke përfshirë këtu edhe tri banka me rëndësi të përgjithshme sistemike. Vlera e mjeteve likuide në mungesë do të arrinte në 79.2 milionë euro (grafik 73, tabela 9). Shkalla e tërheqjes së përgjithshme të depozitave në

sektorin bankar në ditën e pestë do të arrinte në 38.6 përqind të gjithsej depozitave (tabela 9).

Skenari 2: Tërheqja e depozitave nga depozitarët më të mëdhenj

Pozita e likuiditetit të bankave rezulton të jetë në gjendje që të përballojë tërheqjet e depozitave nga **pesë depozitorët më të mëdhenj**.

Grafik 74. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit - Skenari 2


Burimi: BQK.

Ndërsa nën supozimin se **njëzet depozitorët më të mëdhenj** të secilës bankë do të tërheqin depozitat e tyre brenda ditës, atëherë gjendja e likuiditetit do të dobësohej në tri banka. Mungesa e mjeteve për këto tri banka do të arrinte në 31.8 milionë euro (grafik 74, tabela 9). **Rezultatet e këtij skenari përgjithësisht sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës nuk ka koncentrim të theksuar të burimit të financimit, përkatësisht depozitave.**

5.6.2.1 Niveli përballues i tërheqjes së depozitave para se pozita e likuiditetit të arrijë nivelet kritike

Problemet me likuiditet për tërë sektorin bankar do të paraqiteshin në rast të tërheqjes së 27.8 përqind të depozitave brenda ditës, që nënkupton se sektori bankar mund të jetë në gjendje të përballojë tërheqjen e afër një të tretës (1/3) së gjithsej depozitave pa pasur

nevojë për mjete likuide shtesë (grafik 74 dhe tabela 9). Ndërsa në nivel të bankave, banka me pragun më të ulët të tërheqjeve qëndron në 22.0 përqind, ndërsa banka me më të lartin në 68.0 përqind dhe 32.0 përqind (si rezultat i nivelit të lartë të mjeteve likuide që posedojnë).

Tabela 9. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik të likuiditetit

Rezultatet e skenarëve të rrezikut kreditor	Numri i bankave me mungesë të mjeteve likuide	Niveli i depozitave të tërhequra (%)	Mjetet likuide shtesë të nevojshme (në mijëra euro)	Raporti Kredi/Depozitë
Skenari 1: Tërheqja e depozitave në baza ditore në fund të ditës së pestë	4	-38.6%	(79,215)	124.4%
Skenari 2.1: Tërheqja e depozitave nga 5 depozitorët më të mëdhenjë	0	-8.1%		83.1%
Skenari 2.2: Tërheqja e depozitave nga 20 depozitorët më të mëdhenjë	3	-14.2%	(31,756)	89.1%
Pragu - Tërheqja e depozitave deri në nivelin kritik të likuiditetit		-27.8%	(84,014)	105.8%

Burimi: BQK.

Kutia 5. Ndryshimet klimatike dhe rëndësia e tyre në stabilitetin financiar

Për herë të parë si pjesë e Raportit të Stabilitetit Financiar, do të përfshihet tema e ndryshimeve klimatike dhe ndikimet përcjellëse në mirëqenien sociale dhe në stabilitetin financiar. Sidoqoftë, para shtjellimit të ndikimeve që ndryshimet klimatike kanë në sistemin financiar, do të elaborohen konceptet bazë të ndryshimit klimatik, si dhe iniciativat globale dhe vendore në këtë drejtim.

Hyrje

Intensifikimi i aktivitetit njerëzor ndikoi në aktivitet të shtuar ekonomik, i cili për pasojë intensifikoi prodhimin në nivel global. Rritja e intensitetit të prodhimit dhe degradimi i natyrës ndikuan në rritjen e gazrave serrë si dioksidi i karbonit, oksidi i azotit dhe metani, të cilat grumbullohen në atmosferë duke penguar transmetimin e nxehtësisë jashtë planetit, dukuri e njohur edhe si efekti serrë (sipas vlerësimeve të


NASA⁴⁶, niveli i dioksidit të karbonit u rrit për 50 përqind në krahasim me periudhën para - industriale (1750). Për pasojë, rritja e nivelit të këtyre gazrave shkakton rritje të temperaturës dhe luhatje të balancave klimatike, të cilat sjellin shpeshimin e katastrofave natyrore si vërshime, thatësira e zjarre. Rrjedhimisht, ndikimi i ndryshimeve klimatike paraqet rrezik në rritje për mirëqenien sociale, zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin financiar në të ardhmen. Sipas vlerësimeve të UNEP FI⁴⁷, vazhdimi në nivel aktual i ndryshimeve klimatike bart një kosto vjetore në mes 5 dhe 20 përqind të BPV-së globale. Në Kosovë, emetimet e gazrave serrë gjatë vitit 2019 ishin rreth 9.6 milionë ton⁴⁸, ndërsa në vitin 2020, kjo shifër ra në 7.9 milionë ton⁴⁹ për shkak të rënies së aktivitetit të përgjithshëm ekonomik si pasojë e pandemisë COVID-19. Ky trend karakterizoi edhe ecuritë e emetimit në rajon dhe në nivel global. Në krahasim me rajonin, Kosova renditet vendi i tretë me emetimin më të lartë (grafik 1). Sidoqoftë, në nivel global, emetimi i gazrave serrë në Kosovë është margjinal.

⁴⁶ NASA Global Climate Change, <https://climate.nasa.gov/vital-signs/carbon-dioxide/>

⁴⁷ UN Environment Programme Finance Initiative, <https://www.unepfi.org/climate-change/climate-change/>.

⁴⁸ AMMK, Emetimi i Gazrave Serrë në Kosovë 2014-2019, 2021

⁴⁹ Global Carbon Project. (2021). Supplemental data of Global Carbon Project 2021 (1.0) [Data set]. Global Carbon Project. <https://doi.org/10.18160/gcp-2021>.

Grafik 1. Emetimi i CO2 në rajon (në milionë ton)


Burimi: Global Carbon Budget - Global Carbon Project.

Meqë sipas Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), rreth 99 përqind e gazrave serrë të emetuara në Kosovë përbëhet nga dioksidi i karbonit (CO₂), në vazhdim do të marrim CO₂ si bazë të analizës. Sektori i energjisë përbën sektorin me emetimin më të lartë të CO₂ me rreth 86 përqind, pasuar nga sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimi i tokave me 8 përqind, ndërsa 5 përqind të emetimit të gazrave serrë në Kosovë e përbën sektori i mbeturinave (grafik 2). Sipas AMMK, totali i emetimeve të CO₂ në Kosovë është në varësi të lartë nga sasia e energjisë elektrike e prodhuar nga thëngjilli, e që është burimi kryesor i emetimeve të CO₂ në vendin tonë.


Me evidentimin e efekteve nga ndryshimet klimatike, filloi ndërgjegjësimi mbi rreziqet që bartin, e si kundërpërgjigje filluan edhe iniciativat për zvogëlimin e tyre. Megjithëse iniciativa të ndryshme kishin filluar dekada më parë, në fund të vitit 2015, 196 shtete adaptuan Marrëveshjen e Parisit që hyri në fuqi në Nëntor 2016. Qëllimi i kësaj marrëveshje është të kufizojë ngrohjen globale apo emetimin e gazrave serrë, dhe ndërtimin e qëndrueshmërisë për t'u përballur me efektet e rritjes së temperaturave. Marrëveshja e Parisit përfaqëson një hap të rëndësishëm drejtë luftimit të ndryshimeve klimatike, duke qenë se obligon ligjërisht shtetet pjesëmarrëse të raportojnë mbi objektivat afatmesme (5 vjeçare) në luftën kundër ngrohjes globale, objektiva që duhet të avancojnë (të jenë progresive) përgjatë periudhave vijuese. Avancimi drejtë objektivave në kuadër të marrëveshjes së Parisit kërkon transformim ekonomik dhe social. Gjithashtu, marrë parasysh koston e lartë financiare që bartë ky proces, marrëveshja gjithashtu specifikon

mbështetjen financiare dhe ngritjen e kapaciteteve për vendet në zhvillim.

Sa i përket iniciativave për menaxhimin e ndryshimeve klimatike në vend, Qeveria e Kosovës miratoi Strategjinë për Ndryshime Klimatike 2019 – 2028 dhe Planin e Veprimit për ndryshime klimatike 2019-2021. Kjo strategji përcakton politikat për zvogëlimin e emetimeve të gazrave serrë dhe për përshtatjen me ndryshimet klimatike, politika që do të siguronin zhvillim të qëndrueshëm ekonomik përmes reformimit të modelit ekonomik. Sipas kësaj strategjie, fushat e prekura dhe që njëkohësisht rrisin rrezikun nga ndryshimet klimatike, ndër tjera, janë industritë që përdorin teknologji të vjetërsuara (shembull: termocentralet), ndërtimi dhe urbanizimi i pa kontrolluar, jo stabiliteti socio-ekonomik si pasojë e shkallës së lartë të varfërisë në vend, si dhe praktika të pa qëndrueshme bujqësore⁵⁰. Qeveria e Kosovës, gjithashtu në Tetor 2020, nënshkroi deklaratën e Sofiës (ang. 'Sofia Declaration') e cila në linjë me Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor parasheh nxitjen për rritjen e efikasitetit të energjisë për sektorin privat dhe ekonominë familjare, mbështetjen e projekteve për energji të ripërtërishme, si dhe adaptimin e një plani veprues për përshtatjen graduale të tarifave të energjisë elektrike. Në kuadër të kësaj deklaratë gjithashtu pritet adaptimi i një strategjie afatgjatë për energjinë dhe klimën, të cilat ndër tjerash kanë në fokus zvogëlimin e emetimeve të CO₂ dhe planet për largimin gradual të subvencioneve të thëngjillit dhe lëndëve djegëse.

⁵⁰ Strategjia për ndryshimet klimatike 2019-2028 dhe plani i veprimit për ndryshime klimatike 2019- 2021, Qeveria e Kosovës, 2018

Grafik 2. Emetimet e gazrave serrë sipas sektorëve në vitin 2019, në përqindje



■ Energjia ■ Proceset industriale dhe përdorimi i produkteve ■ Bujqësia, pylltaria dhe përdorimi i tokave ■ Mbeturinat

Burimi: AMMK.

Për më tepër, në janar 2022, Qeveria miratoi themelimin e Këshillit Kombëtar për Ndryshimet Klimatike, i cili do të jetë përgjegjës për përcjelljen e zbatimit të strategjive dhe planeve të miratuara për menaxhimin e ndryshimeve klimatike. Aktivitetet vendore që do të ndërmirën duhet të jenë në përputhje me angazhimet në kuadër të iniciativave globale dhe rajonale, si Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshime Klimatike, Marrëveshja e Parisit, si dhe Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor⁵¹. Në qershor 2022, Qeveria e Kosovës ka hartuar Draft Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2022-2031. Në pritje të shqyrtimit dhe miratimit nga Kuvendi, kjo strategji do të fokusohet ndër tjerash në investime në burime të ripërtërishme të energjisë, dekarbonizimin e energjisë, si dhe siguri në furnizimin me energji elektrike.

Ndikimi në sistemin financiar

Për të analizuar ndikimin e rreziqeve nga ndryshimet klimatike duhet të merren parasysh efektet nga dy lloje të rreziqeve që burojnë nga këto ndryshime, e që janë rreziku fizik dhe ai i tranzicionit. Konkretisht, rreziku fizik vije nga ngjarje të paparashikuara klimaterike si zjarret, vërshimet, stuhitë, si dhe nga ngjarje të parashikueshme dhe graduale siç mund të jetë ngrohja globale apo rritja e nivelit të ujërave. Ky rrezik, ndër tjera, mund të ndikojë drejtpërdrejtë në ulje të produktivitetit, dëmtim të aseteve apo në mënyrë indirekte në ndërprerjen e zingjirëve të furnizimit. Ndërsa, rreziku i tranzicionit rezulton kryesisht nga ndryshimet e nevojshme në aktivitetet ekonomike dhe reflekton të gjitha kostot e realizimit të ndryshimeve përkatëse, për të kaluar në ekonomi me emetim të ulët të CO₂. Rreziku i tranzicionit mund të nxitet, ndër tjera,

nga ndryshimet në politikat fiskale apo politikat e ambientit dhe ndryshimeve klimatike, avancimi i teknologjisë, si dhe ndryshimi në preferencat apo sentimentin e konsumatorëve. Një pjesë e madhe e sektorëve më të prekur nga ndryshimet klimatike, si bujqësia, energjia, transporti, ndërtimtaria dhe prodhimi bartin të dy llojet e rreziqeve⁵². Ndryshimet klimatike kanë ndikim në aktivitetet e ndërmarrjeve, e që për pasojë, ndikojnë në sektorin real duke u reflektuar në rritje të rrezikut edhe në sistemin financiar. Në aspekt të sektorit bankar, rreziqet nga ndryshimet klimatike kontribuojnë në rritjen e rreziqeve ekzistuese si rreziku kreditor, rreziku operacional, rreziku i tregut dhe ai i likuiditetit.

Sqarim: Për të elaboruar tutje dhe për të kuptuar natyrën e ndikimit të rreziqeve nga ndryshimet klimatike, po marrim shembull rrezikun kreditor dhe atë operacional. Rreziku kreditor vije nga faktor të jashtëm siç është performanca e ripagimit të detyrimeve nga ana e klientëve. Specifikisht, në aspekt të rrezikut fizik, sektori bankar mund të ndikohet nga rënia e vlerës së kolateralit për shkak të dëmtimeve fizike, apo në aspektin e rrezikut të tranzicionit, mund të ndikohet nga rritja e shpenzimeve për mbulimin e avancimit të teknologjisë (për emetim më të ulët të CO₂), e që rrjedhimisht reflektohet në performancën financiare të klientit. Në anën tjetër, rreziku operacional ka për bazë kryesisht faktorë të brendshëm si politikat dhe strategjia e bankës. Nga perspektiva e rrezikut fizik, mund të ndikohet nga dëmtimi fizik i degëve të bankës si pasojë e katastrofave natyrore, ndërsa në aspekt të tranzicionit, mund të ndikohet nga rreziku reputacional si pasojë e financimit të projekteve me pasojë negative në mjedis.

⁵¹ Dokumenti mbi vendimin, 2022, <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2022/01/Vendimet-e-mbledhjes-se-54-te-Qeverise-se-Kosoves-1.pdf>

⁵² BQE, 'Guide on climate-related and environmental risks', Nëntor 2020 (https://www.bankingsupervision.europa.eu/ecb/pub/pdf/ssm.202011fin_alguideonclimate-relatedandenvironmentalrisks-58213f6564.en.pdf)


Struktura e financimit të sektorëve ekonomik, që reflekton ekspozimin e sektorit bankar ndaj sektorëve me emetim të lartë të CO2 si dhe sektorëve me pozitë të caktuar gjeografike, përcakton edhe vlerësimin ndikimit të këtij rreziku në sektorin bankar. Sa i përket strukturës së kreditimit në Kosovë, sektori i tregtisë ka peshë të lartë prej 43.4 përqind dhe përbën sektorin dominues në kuadër të ekspozimeve të mëdha me 27.3 përqind. Ekspozimi i lartë në këtë sektor rrit mundësinë e bartjes së rrezikut nga sektori i jashtëm, bazuar në peshën e madhe që ka importi në ekonominë e vendit, duke marrë parasysh që rreziqet klimatike prekin në masë më të lartë vendet importuese për shkak iniciativave, tashmë në fuqi, drejt dekarbonizimit të ekonomive në nivel global e rajonal.

Sektori i prodhimit dhe ai i ndërtimitarisë përbëjnë 19.4 dhe 13.7 përqind, respektivisht, të gjithëj kreditimit nga sektori bankar. Gjithashtu, këta dy sektor kanë pjesëmarrje relativisht të lartë edhe në kuadër të ekspozimeve të mëdha me 14.0 dhe 6.9 përqind, respektivisht. Të dy sektorët ndikohen drejtpërdrejtë nga ndryshimet klimatike si në aspektin fizik, pra nga ngjarjet natyrore, e veçanërisht në aspektin e tranzicionit drejt emetimeve më të ulëta të CO2, ku janë subjekt i politikave dhe strategjive për mbrojtjen e mjedisit që njëherësh mbartin në vete rritje të shpenzimeve për modifikimet e nevojshme të cilat kanë kosto të lartë. Duke marrë parasysh ekspozimin relativisht të lartë të sektorit bankar

në këta sektorë dhe presionin për tranzicion drejt dekarbonizimit, bankat duhen të jenë më prudente në kreditimin dhe ekspozimin kundrejt sektorëve në fjalë.

Si sektori me emetimin më të lartë të CO2, sektori i energjisë ka peshë të vogël në ekspozimin e sektorit bankar me 1.9 përqind të gjithëj kreditimit të sektorit. Gjithashtu, ky sektor nuk bën pjesë në ekspozimet e mëdha të sektorit bankar. Sidoqoftë, 5.2 përqind e ekspozimeve të mëdha janë kundrejt sektorit të derivateve (grafik 3), sektor me emetim të lartë të CO2 dhe rrjedhimisht kontribues në përshpejtimin e ndryshimeve klimatike dhe bartës i rreziqeve klimatike, veçanërisht rrezikut të tranzicionit. Rrjedhimisht, megjithëse ekspozimi kreditor në këtë sektor nuk paraqet drejtpërdrejtë rrezik për sektorin bankar, rreziku i tranzicionit që bartin të gjithë sektorët tjerë ekonomik që kanë varësi të lartë nga sektori i energjisë mund të përkthehet në rrezik në rritje për sektorin bankar. Varësia e Kosovës në energjinë e prodhuar nga termocentralet⁵³ nënkupton që një politikë për tranzicionin drejt një ekonomie me emetim të ulët të CO2 përbën një rrezik të lartë për kapacitetin absorbues financiar të ekonomisë kundrejt ndryshimeve që një politikë e tillë kërkon. Andaj, politikat drejt një ekonomie të gjelbër kërkojnë ekspertizë dhe ritëm gradual të implementimit që të evitohet rreziku i mbingarkesës financiare së ekonomisë së vendit.

Grafik 3. Ekspozimi i sektorit bankar të Kosovës ndaj rreziqeve nga ndryshimet klimatike sipas



Rreziku në rritje nga sektori i energjisë, mbështetet edhe nga pritjet për periudhën afatmesme dhe afatgjatë, të cilat sugjerojnë rritje të theksuar të kostonë së energjisë elektrike si pasojë e taksave dhe rregullave për dekurajimin e përdorimit të lëndëve

me emetim të lartë për prodhimin e saj. Këto pritje sinjalizojnë orientimin e ndërmarrjeve nga energjia e ripërtërishme.

⁵³ Sipas raportit të AMMK, në kuadër të emetimeve nga sektori i energjisë, 99,95 përqind e emetimeve vije nga sektori i industrisë së energjisë, saktësisht nga aktivitetet nga djegia e karburanteve, ku bëjnë

pjesë emetimet nga përdorimi i lëndëve djegëse për prodhimin e energjisë elektrike, ngrohtoret, transporti rrugor dhe industritë prodhuese.

Iniciativat nga sistemi financiar

Përveç iniciativave shtetërore për uljen e emetimit të CO₂, në kuadër të sistemit financiar gjithashtu ka nisma të cilat kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe njëkohësisht përshpejtojnë tranzicionin drejt një ekonomie me emetim të ulët të CO₂. Konkretisht, institucionet financiare këtë e realizojnë nëpërmjet financimit të gjelbër (ang. 'green finance'), e që nënkupton financimin e klientëve, aktivitetet e të cilëve kontribuojnë në ruajtjen e mjedisit dhe ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve që vijnë nga ndryshimet klimatike. Ky lloj financimi në Kosovë mbështetet nga programe të ndryshme zhvillimore për nxitjen e investimeve të gjelbra në vend. Fondet nga programet përkatëse mundësojnë kreditimin me kushte më të volitshme të klientëve të cilët investojnë në projekte të gjelbra, qofshin ato ekonomi familjare që do të investojnë në ndërtim apo renovim të shtëpive me teknologji me efikasitet të lartë të energjisë, apo ndërmarrje që investojnë në teknologji dhe procese për uljen e emetimit të CO₂ nga veprimtarive të tyre ekonomike. Në kuadër të iniciativave, për Ballkanin Perëndimor vlen të theksohet programi i BERZH, Green Economy Financing Facility, një program me kapital prej 85 milionë euro që mbështet ekonominë familjare për investime në teknologji të gjelbra të cilat rrisin efikasitetin e energjisë përmes financimit nga institucionet financiare pjesëmarrëse në program e që operojnë në vend⁵⁴. Ky program përfshinë 5 institucione financiare. Gjithashtu, fondi investiv i iniciuar nga Banka Investive Evropiane (BIE) dhe Banka Zhvillimore e Gjermanisë (KfW), Green for Growth Fund (GGF), KfW ka për qëllim lehtësimin e ndryshimeve klimatike dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike përmes investimit në masa që ulin konsumin dhe shfrytëzimin e resurseve, si dhe emetimin e CO₂⁵⁵. Fondi vepron përmes financimit të targetuar për ndërmarrje dhe ekonomi familjare përmes institucioneve financiare, si dhe përmes investimit direkt në projekte dhe kompani. Në kuadër të këtij fondi, pjesëmarrëse janë katër institucione financiare në vend me një portfolio investimi prej 14.2 milionë euro⁵⁶.

Tutje, Fondi për Garanci Kreditorë (FKGK) në kuadër të politikave rregulluese për ofrimin e

garancive përfshin gjithashtu edhe Politikën dhe Kornizën e Menaxhimit Mjedisor dhe Social, në bazë të cilave merret edhe vendimi për lëshimin e garancisë. Përmes këtyre politikave, FKGK synon të identifikoj dhe adresoj rreziqet klimatike që ndërlidhen me aktivitetet për të cilat ofron garanci. Për më tepër, FKGK nuk ofron garanci kreditorë për aktivitetet me emetim të lartë të CO₂, e që janë të listuara në këtë politikë⁵⁷. Përveç financimit të gjelbër, institucionet financiare duhet të sigurojnë që përbrenda institucionit të implementojnë dhe përcjellin politika mbi ruajtjen e mjedisit, përmes të cilave në mënyrë indirekte kontribuojnë në dekarbonizim. Ndër tjerash, kjo nënkupton efikasitetin në përdorimin e energjisë, digitalizimin e proceseve operative të institucionit, si dhe digitalizimin e ofrimit të shërbimeve ndaj klientëve.

Adekuatshmëria e kornizës rregullative

Përgjegjësia kryesore për ndërtimin, implementimin dhe monitorimin e politikave adekuate për zvogëlimin e efekteve nga ndryshimet klimatike bie mbi qeveritë. Sidoqoftë, materializimi i rreziqeve nga ndryshimet klimatike (fizike dhe të tranzicionit) ka efekt të rëndësishëm në zhvillimet makroekonomike dhe në rritjen e rreziqet financiare. Në këtë rast, ruajtja e stabilitetit financiar bie nën mandatin e bankës qendrore. Rrjedhimisht, mbikëqyrja e efekteve të ndryshimeve klimatike në sistemin financiar duhet të jetë pjesë e rregullativës dhe operacioneve të bankave qendrore apo institucioneve mbikëqyrëse përkatëse. Megjithatë iniciativat për të reduktuar e menaxhuar ndryshimet klimatike kanë filluar dekada më parë, iniciativat për përfshirjen e rreziqeve nga ndryshimet klimatike në kornizën rregullative kanë filluar vetëm në vitet e fundit, duke marr parasysh sfidën për kuantifikimin dhe vlerësimin e efekteve të ndryshimeve klimatike në sistemin financiar. Saktësisht, Komiteti i Baselit për Mbikëqyrjen Bankare dhe Autoriteti Bankar Evropian në fund të vitit 2021, në kuadër të 'Udhërrëfyesit për adresimin e rreziqeve nga ndryshimet klimatike'⁵⁸, kanë nisur me vlerësimin nëse korniza aktuale rregullative Basel i mbulon mjaftueshëm veçoritë specifike të rreziqeve të ndryshimeve klimatike dhe nxjerrja e propozimeve për të adresuar mungesat potenciale. Gjithashtu, me inicativë të Komisionit Evropian, institucionet relevante në mbikëqyrjen e rrezikut sistematik, do të vlerësojnë dhe potencialisht modifikojnë adekuatshmërinë e politikave dhe masave makroprudenciale për të adresuar këto rreziqe⁵⁹.

⁵⁴ Më shumë informata gjene në linkun, <https://ebrdgeff.com/kosovo/the-programme/the-facility/>

⁵⁵ Më shumë informata gjene në linkun, <https://www.ggf.lu/about-green-for-growth-fund>

⁵⁶ H2 2021 Country Fact Sheet Kosovo, GGF https://www.ggf.lu/fileadmin/user_upload/Publications/Country_Fact_Sheet/GGF_Kosovo_Fact_Sheet_H2_2021.pdf

⁵⁷ Politikë të Menaxhimit Mjedisor dhe Social, FKGK, <https://fondikgk.org/ep-content/uploads/2021/07/Politika-e-Menaxhimit-Mjedisor-dhe-Social.pdf>

⁵⁸ FSB Roadmap for Addressing Climate-Related Financial Risks, 2021, Bordi i Stabilitetit Financiar, dokumenti i plotë mund të gjendet në <https://www.fsb.org/ep-content/uploads/P070721-2.pdf>

⁵⁹ ECB 2021, https://www.ecb.europa.eu/pub/financial-stability/macprudential-bulletin/html/ecb.mpbu202110_1-5323a5baa8.en.html

Korniza rregullative aktuale adreson menaxhimin e rreziqeve si ai kreditor, i likuiditetit, solvencës dhe ai operacional. Siç u theksua edhe më lartë rreziqet nga ndryshimet klimatike kontribuojnë në këto rreziqe të sektorit bankar, në këtë aspekt pritet që efektet e mundshme nga rreziqet e lartpërmendura të mbulohen nga kjo kornizë rregullative. Megjithatë, korniza aktuale e mbikëqyrjes së institucioneve financiare kryesisht mbështetet në të dhëna historike për të vlerësuar marrëdhënien në mes të faktorëve të rrezikut dhe ekspozimeve, përfshirë edhe periudhat me rënie ekonomike dhe krizave. Rrjedhimisht, fokusi në periudhat e ardhshme dhe pasiguritë e të panjohurat që lidhen me efektet e ndryshimeve klimatike përbëjnë një sfidë të konsiderueshme për vlerësimin e saktë të rreziqeve përkatëse. Saktësisht, vështirësitë në vlerësimin e ndikimit të ndryshimeve klimatike duke u bazuar në rregullativen aktuale qëndrojnë në përfshirjen e rreziqeve nga ndryshimet klimatike në përcaktimin e peshave të rrezikut të aseteve, në kërkesat për kapital shtesë, përfshirjen e ekspozimit në ndryshimet klimatike në kuadër të kufizimeve dhe rregullimeve për ekspozimet e mëdha, mos mbulueshmëria e rrezikut nga ndryshimet klimatike në treguesit dhe kërkesat e likuiditetit⁶⁰.

Për më tepër, mungesa e të dhënave cilësore mbi ekspozimin e sistemit financiar në rreziqet nga ndryshimet klimatike, si në frekuencë të lartë ashtu edhe në atë granulare paraqet një sfidë shtesë.

Kjo mungesë nënkupton vështirësi si në vlerësim të rreziqeve nga ndryshimet klimatike, e po ashtu në arsyetimin e vlerësimin adekuat të bazës për ndryshimet e nevojshme rregullative në këtë aspekt. Përderisa rregullat e mbikëqyrjes së institucioneve financiare do të ndihmojnë në adresimin e rreziqeve nga ndryshimet klimatike në nivel mikro, politikat makroprudenciale do t'i adresoj të njëjtat në nivel të sistemit. Sa i përket adekuatshmërisë së politikave makroprudenciale, vlerësohet se natyra fleksibile e masave në dispozicion mund të shërbejë në mënyrë efikase dhe në afat kohor më të shkurtër në kufizimin e ekspozimeve të ndjeshme ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, si dhe njëkohësisht të nxisin financimin e investimeve të 'gjelbra'. Sidoqoftë, kompleksiteti i lartë, afatet e gjata kohore, pakthyeshmëria e pjesshme e rreziqeve klimatike nënkuptojnë një nivel të lartë pasigurie rreth kohës dhe ndikimit të tyre, gjë që paraqet vështirësi në parashikimin e rreziqeve përkatëse e si pasojë nënvlerësim të ndikimit të tyre në stabilitetin financiar⁶¹. Gjithashtu, aspekti ligjor dhe ai operacional janë faktorë që kontribuojnë në sfidat e rishikimit dhe implementimit të ndryshimeve në politikat dhe kornizën rregullative përkatëse.

⁶⁰ ECB 2021, https://www.ecb.europa.eu/pub/financial-stability/macprudential-bulletin/html/ecb.mpbu202110_1-5323a5baa8.en.html


⁶¹ A theoretical case for incorporating climate risk into the prudential framework, ECB 2021.

6. Institucionet financiare jo-bankare

6.1 Sektori Pensional

Sektori pensional në vitin 2021 shënoi rritje të përshpejtuar të aktivitetit, që i atribuohet kryesisht rritjes së shkallës së vaksinimit dhe rimëkëmbjes ekonomike në nivel global. Kthimi në investimi në fundvit tejkaloi nivelet para-pandemike dhe arriti në vlerë rekorde.

Grafik 75. Asetet e sektorit pensional



Burimi: BQK.


Vlera e asetëve arriti në 2.36 miliardë euro në fund të vitit 2021, që përkon me një rritje vjetore prej 18.2 përqind (grafik 75).⁶² Kjo rritje i atribuohet kthimit të lartë nga investimet si dhe rritjes së arkëtimit prej kontributdhënësve. Niveli më i lartë i kthimit nga investimet erdhi si rrjedhojë e rimëkëmbjes ekonomike globale pas recesionit ekonomik të shkaktuar nga Covid-19 në vitin paraprak.

Arkëtimet e reja shënuan rritje vjetore prej 9.8 përqind (4.2 përqind në vitin 2020), vlera e të cilave arriti në 213.5 milionë euro në fund të vitit. Rritja e përshpejtuar e arkëtimit prej kontributdhënësve i'u atribua hapjes së ekonomisë gjatë këtij vitit krahasuar me vitin e kaluar, ku kishte mbyllje të ekonomisë (operim vetëm të sektorëve esencial) dhe kufizime me sektorin e jashtëm.

Vlera e asetëve të FKPK-së, që menaxhon me 99.6 përqind të gjithsej asetëve të sektorit pensional, arriti në 2.35 miliardë euro, që

paraqet një rritje vjetore prej 18.2 përqind. **Struktura e asetëve të FKPK-së vazhdon të dominohet nga investimet në tregun e jashtëm, të cilat kanë shënuar rritje të pjesëmarrjes krahasuar me vitin paraprak, si rrjedhojë e prospekteve pozitive krahasuar me pasigurinë për investim një vit më parë.** Portfolio investuese në tregjet e huaja u rrit në 1.81 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore për 33.7 përqind (rënie vjetore prej 8.6 përqind në vitin 2020).

Grafik 76. Struktura e investimeve të sektorit pensional




Burimi: BQK.

Si rrjedhojë, pjesëmarrja e investimeve jashtë vendit në dhjetor 2021 arriti në 76.9 përqind të gjithsej asetëve të FKPK-së (68.0 përqind në vitin 2020). Vlera e investimeve brenda vendit zbriti në 544.6 milionë euro, që paraqet rënie vjetore prej 14.6 përqind (grafik 76).

Në kuadër të investimeve brenda vendit, letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës vazhdojnë të jenë kategoria me peshën më të madhe, pasuar nga ajo e certifikatave të depozitit dhe parasë së mbajtur në vend. Pesha e letrave me vlerë u rrit në 90.3 përqind (70.7 përqind në vitin 2020), ndërsa e certifikatave të depozitit u zvogëlua në 8.2 përqind (20.3 përqind në vitin 2020). Pesha e parasë së mbajtur në BQK në gjithsej mjetet e mbajtura brenda vendit zbriti në 1.5 përqind nga 8.9 përqind pjesëmarrje në vitin 2020.

mbetur janë asete të menaxhuara nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP).

⁶² Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) në dhjetor 2021 kishte pjesëmarrje në gjithsej asetet e sektorit prej 99.6 përqind, ndërsa pjesa e

Grafik 77. Kontributet e arkëtuara sipas fondeve pensionale



Burimi: BQK.

Krahasuar me periudhën paraprake, investimet në tregun e brendshëm të letrave me vlerë shënuan rritje të ngadalësuar (për 9.0 përqind nga 50.8 përqind në vitin paraprak), e që reflekton rënien e kërkesës së Qeverisë së Kosovës për të financuar aktivitetet e saj përmes emetimit të borxhit si dhe konkurrencën nga sektori bankar dhe ai i sigurimeve. Kurse, plasimet në certifikata të depozitit u zvogëluan për 65.4 përqind, e që reflekton rialokimin e një pjese të mjeteve në sektorin e jashtëm.

Në fund të vitit 2021, vlera e gjithsej asetëve të FSKP-së arriti në 9.5 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 11.1 përqind. Mirëpo, arkëtimet e reja shënuan vlerën prej 546.4 mijë euro, që përkon me një rënie vjetore prej 1.4 përqind (grafik 77). **Pjesa më e madhe e asetëve të FSKP-së, vazhdon të investohet jashtë vendit, përkatësisht 79.3 përqind e gjithsej asetëve.** Struktura e investimeve jashtë vendit përbëhet kryesisht nga investimet në formë të aksioneve (87.2 përqind), letrave me vlerë (7.8 përqind), dhe parasë së gatshme (5.1 përqind). Në anën tjetër, investimet në Kosovë u zvogëluan për 3.0 pikë përqindje, me pjesëmarrje prej 20.7 përqind të gjithsej asetëve të FSKP-së. Investimet në tregun e brendshëm ishin të shpërndara në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës (64.7 përqind), depozita në bankat komerciale (3.6 përqind), para të gatshme në trezor të FSKP-së (1.6 përqind), dhe të tjera (30.1 përqind).


6.1.1 Performanca financiare e sektorit pensional

Sektori pensional vitin 2021 e mbylli me performancë jashtëzakonisht të mirë financiare duke realizuar kthim pozitiv në investime në vlerë rekorde që prej fillimit të operimit.

Grafik 78. Performanca financiare e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës


Burimi: BQK.

Rritja e shkallës së vaksinimit dhe rimëkëmbja ekonomike në nivel global ndikuan në përmirësimin e performancës së tregjeve globale, që ndikoi në rritjen e kthimit nga investimet edhe për sektorin pensional të Kosovës. Kthimi bruto nga investimet arriti vlerën rekorde që prej fillimit të funksionimit prej 228.4 milionë euro, dhe rritje të theksuar të çmimit për njësi krahasuar me vitin e kaluar.

Grafik 79. Performanca financiare e Fondit Sloveno-Kosovar të Pensioneve


Burimi: BQK.

FKPK realizoi kthim bruto nga investimet në vlerë prej 227.3 milionë euro, me çmim të njësisë prej 1.72 euro nga 1.56 euro sa ishte në ditën e fundit të muajit dhjetor 2020 (grafik


78). FSKP-ja gjatë vitit 2021 realizoi kthim bruto në investime në vlerë prej 1.1 milionë euro, përderisa çmimi i njësisë u rrit në 202.86 euro nga 184.38 euro sa ishte në fund të dhjetorit 2020 (grafik 79).

6.2 Sektori i Sigurimeve

6.2.1 Aktiviteti i sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve në vitin 2021 u karakterizua me zgjerim të aktivitetit, që u reflektua në nivel të lartë të primeve të shkruara. Po ashtu, sektori realizoi nivel të lartë të fitimeve krahasuar me mesataren historike, pavarësisht rritjes së niveleit të dëmeve të paguara.

Grafik 80. Indikatorët e zhvillimit të sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK.

Me një pjesëmarrje prej 2.7 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar, sektori i sigurimeve është sektori i katërt për nga madhësia në kuadër të sistemit financiar.

Niveli i ndërmjetësimit dhe densitetit të sektorit të sigurimeve mbetet ngjashëm me vitet paraprake, me rritje marginale vjetore (grafik 80). Shprehur përmes primeve të shkruara bruto në raport me BPV-në, ndërmjetësimi i sektorit vazhdon të qëndroj në nivel relativisht të ulët krahasuar me mesataren e vendeve të Bashkimit Evropian, në 1.50 përqind (1.47 përqind në vitin 2020). Ngjashëm i ulët mbetet niveli i densitetit, i matur përmes primeve të shkruara për kokë


⁶³ Sipas statistikave të publikuara në databazën e Insurance Europe, niveli i densitetit gjatë periudhës 2009-2018 në 32 vende të Evropës ishte 1,904 Euro (prime të shkruara për kokë banori), kurse niveli i depërimit (ndërmjetësimit) në treg gjatë kësaj periudhe qëndroi në 7.25 përqind. <https://www.insuranceurope.eu/insurancedata>

banori, i cili në vitin 2021 shënoi vlerën prej 65.3 euro (55.2 euro në vitin 2020).⁶³

Struktura e sektorit të sigurimeve vazhdon të dominohet nga shërbimet e siguruesve 'jo-jetë', që përfaqësojnë 91.3 përqind të aseteve të tregut të sigurimeve, ndërsa pjesa e mbetur përbëhet nga asetet e siguruesve 'jetë'.

Gjysma e tregut të sigurimeve përfaqësohet nga siguruesit vendor (50.2 përqind), përderisa pjesa tjetër nga siguruesit me origjinë të huaj. Në kuadër të kompanive me kapital të huaj, siguruesit nga Shqipëria kanë pjesëmarrjen më të lartë në asete, pasuar nga siguruesit nga Sllovenia dhe siguruesit nga Austria (grafik 81).

Grafik 81. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve, sipas pronësisë (dhjetor 2021)



Burimi: BQK.


Tregu i sigurimeve në Kosovë karakterizohet me një shkallë më të ulët të koncentrimit krahasuar me sektorët tjerë të sistemit financiar. Mirëpo, në tri vitet e fundit kemi rritje të lehtë të koncentrimit si rezultat i likuidimit të dy kompanive të sigurimit (një në vitin 2019 dhe një tjetër gjatë vitit 2021). Indeksi i Herfindahl-it⁶⁴ për primet e shkruara bruto (PSHB) është ngritur në 981 pikë nga 925 pikë në vitin 2020). Po i njëjti indeks i kalkuluar duke marrë për bazë asetet e tregut të sigurimeve tregon vlera më të ulëta, por gjithashtu në rritje, përkatësisht 913 pikë për vitin 2021 nga 845 pikë në vitin 2020.

⁶⁴ Indeksi Herfindahl është llogaritur me formulën në vijim: $HI = \sum_{i=1}^n \frac{1}{S} \left(\frac{s_i}{S} \right)^2$, ku S pjesëmarrjen e kompanisë në gjithsej mjetet (primet e shkruara bruto - PSHB) e tregut të sigurimeve, n është gjithsej numri i institucioneve në sektorin përkatës. Në qoftë se indeksi shtrihet ndërmjet intervaleve 1,000 – 1,800 njësi, niveli i koncentrimit në sektorin e sigurimeve konsiderohet i pranueshëm.

Kurse, indeksi CR5⁶⁵ për vitin 2021, i llogaritur në raport me PSHB për sektorin e sigurimeve rezulton 56.6 përqind (55.1 përqind në vitin 2020), ndërsa i llogaritur në raport me asetet rezulton 53.3 përqind (50.2 përqind në vitin 2020). Koncentrimi është më i lartë te sektori i sigurimeve “jetë”, si rezultat i numrit më të vogël të siguruesve në këtë segment të tregut të sigurimit.

Asetet e sektorit të sigurimeve arritën vlerën 238.8 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 9.3 përqind (grafik 82). Sigurimet “jojetë” shënuan rritje vjetore prej 9.2 përqind dhe përfaqësuan 91.3 përqind të gjithsej aseteve të sektorit në fund të vitit 2021. Ndërsa, sigurimet “jetë”, që përbëjnë pjesën e mbetur të aseteve, shënuan rritje vjetore prej 10.3 përqind.

Grafik 82. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK.


Në kuadër të aseteve, rritjen më të theksuar e shënoi kategoria e depozitave të mbajtura në bankat komerciale, që janë kryesisht në formë të depozitave të afatizuara. Kategoria e dytë me rritjen më të lartë ishte ajo e investimeve në Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës. Kurse, pozicioni i huasë dhe të arkëtueshmet, dhe pozicioni i parasë dhe depozitave në BQK, ishin të vetmet kategori që shënuan rënie krahasuar me vitin e kaluar.

Struktura e investimeve të siguruesve është e koncentruar vetëm në investime brenda vendit. Investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës rritën peshën në

investimet e industrisë së sigurimeve në 18.0 përqind në vitin 2021, nga 16.4 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (grafik 83).

Sa i përket detyrimeve të sektorit, provizionet teknike dhe matematike përbëjnë pjesën më të madhe me gjithsej 64.1 përqind, pasuar nga ekuiteti me 26.6 përqind dhe pjesa e mbetur nga detyrimet tjera (grafik 84). Vlera e gjithsej kapitalit të siguruesve gjatë kësaj periudhe shënoi rritje të theksuar, prej 12.4 përqind. Rritja e kapitalit i atribuohet kryesisht fitimit të realizuar gjatë vitit 2021, pasi që kapitali aksionar i paguar mbeti i pandryshuar me vitin 2020. Vlera e humbjeve të akumuluar ndër vite nga sektori u zvogëlua për 2.6 milionë euro, në 42.4 milionë euro në fund të vitit 2021.

Grafik 83. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve (dhjetor 2021)




Burimi: BQK.

Vlera e primeve të shkruara nga siguruesit në vitin 2021 arriti në 117.4 milionë, rritje vjetore prej 18.2 përqind (0.1 përqind në vitin 2020). Rritja e theksuar e primeve të shkruara në vitin 2021 krahasuar me gjendjen e një viti më parë është si rrjedhojë e tkurrjes ekonomike përgjatë vitit 2020, e që kishte prekur edhe sektorin e sigurimeve. Gjatë vitit të kaluar (2020) niveli i primeve të shkruara kishte mbetur pothuajse i pandryshuar me vitin 2019. Andaj, rritja e theksuar vjetore e primeve në vitin 2021 ka kompensuar stagnimin në prime të shkruara përgjatë vitit 2020 si rrjedhojë e pandemisë Covid-19, e cila kishte kulmin e saj në vitin 2020.

⁶⁵ Indeksi CR5 kombinon pjesëmarrjen në treg të 5 kompanive me vlerat më të larta të aseteve në raport me gjithsej asetet e sektorit dhe PSHB ndaj gjithsej PSHB të sektorit.

Struktura e primeve të shkruara dominohet nga primet e sigurimit “jojetë” të cilat përfaqësojnë 95.9 përqind të gjithsej primeve të shkruara. Vlera e primeve të shkruara nga sigurimi “jojetë” në vitin 2021 arriti në 112.6 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 17.6 përqind (grafik 85). Numri i polisave të shitura shënoi gjithashtu rritje, në 1.15 milionë sosh krahasuar me 824.1 mijë një vit më parë.⁶⁶

Grafik 84. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve (dhjetor 2021)




Burimi: BQK.

Rritja e nivelit të primeve të shkruara dhe polisave të shitura krahasuar me vitin e kaluar reflekton aktivitetin e shtuar ekonomik dhe lehtësimin e masave kufizuese për parandalimin e COVID-19. Sigurimet “jojetë” vazhdojnë të dominohen nga sigurimet e detyrueshme me një pjesëmarrje prej 62.4 përqind në gjithsej bruto primet e shkruara “jojetë”, ndërsa pjesa tjetër përfshinë sigurimet vullnetare. Vlera e primeve të shkruara nga sigurimi “jetë” arriti në 4.9 milionë euro, që paraqet vlerë më të lartë për 35.7 përqind krahasuar me vitin 2020. Në vitin 2021, produktet e sigurimeve të detyrueshme shënuan rritje vjetore prej 17.7 përqind, dhe rritën tutje pjesëmarrjen e tyre në gjithsej primet “jojetë”. Rritja e pjesëmarrjes së sigurimeve të detyrueshme u ndikua kryesisht nga produktet “MTPL”. Sigurimet vullnetare

shënuan rritje vjetore prej 17.3 përqind, me rritje më të theksuar në produktet siç janë “Aksidenti dhe shëndeti”, dhe sigurimi “Kasko” (tabela 10).

Grafik 85. Primet bruto të arkëtuara



Burimi: BQK.

Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve, ku përfshihen dëmet e siguruesve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), shënuan rritje për 24.4 përqind, duke arritur vlerën në 61.0 milionë euro në fund të vitit 2021 (49.1 milionë euro në vitin 2020). Nga gjithsej shuma e dëmeve të paguara, 50.8 milionë euro (43.2 milionë euro në vitin 2020) ishin dëme të paguara nga siguruesit, ndërsa 10.2 milionë euro (5.8 milionë euro në vitin 2020) dëme të paguara nga BKS. Dëmet e paguara nga risiguruesit marrin pjesë me 14.4 përqind në gjithsej shumën e paguar të dëmeve nga siguruesit⁶⁷ (11.4 përqind në vitin paraprak). Rritja e nivelit të dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimit dhe BKS-ja ndër tjerash është rezultat i masave më lehtësuese kundër përhapjes së pandemisë, të aplikuara në Kosovë gjatë vitit 2021 krahasuar me masat më të rrepta gjatë vitit të kaluar që u reflektuan në nivel të reduktuar të lëvizjes, dhe rrjedhimisht të dëmeve të ndodhura dhe paguara.

⁶⁶ Përfshihet vetëm sigurimi i jo-jetës

⁶⁷ Nuk përfshihet BKS-ja.

Tabela 10. Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit (në miliona euro)


Aktiviteti	2020	2021	Ndryshimi	Pjesëmarrja: 2020	Pjesëmarrja: 2021
Gjithsej Jo-jetë	95.7	112.6	17.6%	96.4%	95.9%
Sigurimi i detyruar					
MTPL	53.8	60.3	12.0%	54.2%	51.3%
TPL+	1.8	2.8	56.7%	1.8%	2.3%
Sigurime kufitare	4.2	7.3	74.7%	4.2%	6.2%
Sigurimi vullnetar					
Aksident dhe shëndet	16.4	21.0	27.9%	16.5%	17.9%
Kasko	5.5	7.2	31.1%	5.5%	6.1%
Kredi dhe garancione	4.4	4.6	4.0%	4.5%	3.9%
Zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë	6.1	5.1	-16.9%	6.1%	4.3%
Përgjegjësi e përgjithshme	3.6	4.5	22.5%	3.7%	3.8%
Gjithsej jetë	3.6	4.9	35.7%	3.6%	4.1%
Gjithsej tregu	99.3	117.4	18.2%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK.

Tabela 11. Dëmet e paguara, sipas klasave të biznesit (në miliona euro)

Aktiviteti	2020	2021	Ndryshimi	Pjesëmarrja: 2020	Pjesëmarrja: 2021
Gjithsej Jojetë	48.1	59.9	24.5%	98.1%	98.2%
Sigurimi i detyruar					
MTPL	25.4	29.4	15.7%	51.8%	48.2%
TPL+	0.2	0.2	40.3%	0.3%	0.4%
Sigurime kufitare, FG, MoU	5.8	10.2	74.5%	11.9%	16.7%
Sigurimi vullnetar					
Aksident dhe shëndet	9.8	10.6	8.8%	20.0%	17.5%
Kasko	3.4	4.6	34.8%	6.9%	7.5%
Kredi dhe garancione	2.5	1.0	-60.7%	5.1%	1.6%
Sigurime në pronë	1.0	3.4	248.3%	2.0%	5.6%
Sigurimi mallit në tranzit	0.0	0.0	-100.0%	0.1%	0.0%
Përgjegjësi e përgjithshme	0.0	0.5	13130.2%	0.0%	0.8%
Gjithsej jetë	0.9	1.1	20.4%	1.9%	1.8%
Gjithsej tregu	49.1	61.0	24.4%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK.

Grafik 86. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara


Burimi: BQK.

Vlera e dëmeve të paguara nga sigurimet “jojetë” u rrit në 59.9 milionë euro në vitin 2021 (48.1 milionë euro në vitin 2020). Kurse, vlera e dëmeve të paguara nga sigurimet “jetë” u rrit në 1.1 milionë euro nga 0.9 milionë euro sa

ishite në vitin 2020, që paraqet një rritje vjetore prej 20.4 përqind. Rritja e nivelit të dëmeve të paguara në vitin 2021 në kuadër të sigurimit “jojetë” u ndikua si prej pagesave të dëmeve të sigurimeve vullnetare, ashtu edhe atyre të detyrueshme (tabela 11). Vlera e dëmeve të paguara nga sigurimet vullnetare u rrit për 3.4 milion euro krahasuar me vitin paraprak, në 20.1 milionë euro.

Kjo rritje u ndikua kryesisht nga produkti “Sigurimi në pronë”, “Aksident dhe shëndet”, dhe “Kasko”. Kurse, dëmet e paguara nga sigurimet e detyrueshme, që kanë edhe pjesëmarrjen më të madhe në gjithsej portofolin e dëmeve të paguara, shënuan rritje më të përshpejtuar vjetore, prej 26.8 përqind, duke arritur vlerën prej 39.8 milionë euro. Kontributin kryesor në rritjen e nivelit të

dëmeve të sigurimit të detyrueshëm e kishin kategoria “MTPL” dhe “Sigurime kufitare, FG, MoU”.

Si rrjedhojë e rritjes më të lartë të dëmeve të paguara në raport me primet e arkëtuara, raporti dëme/prime u rrit për 2.6 pikë përqindje, në 52.0 përqind (grafik 86).

6.2.2 Performanca financiare e sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve këtë vit e mbylli me rezultat pozitiv financiar prej 6.9 milionë euro, për dallim nga viti i kaluar ku kishte shënuar fitim neto në vlerë prej 2.3 milionë euro (tabela 12). Siguruesit “jojetë” shënuan fitime në vlerë prej 6.4 milionë euro, krahasuar me vlerën prej 2.0 milionë euro në vitin 2020. Ndërsa, siguruesit “jetë” realizuan fitim neto në vlerë prej 492.4 mijë euro krahasuar me 273.3 mijë euro në vitin 2020. Niveli më i lartë i fitimit të realizuar në vitin 2021 krahasuar me vitin paraprak është kryesisht rrjedhojë e nivelit më të lartë të të hyrave nga primet e shkruara (për 18.2 përqind). Niveli i dëmeve të ndodhura këtë vit u rrit për 27.8 përqind, kurse shpenzimet neto operative të sektorit gjatë kësaj periudhe shënuan rënie vjetore prej 3.7 përqind krahasuar me vitin 2020.

Raporti i kombinuar i sektorit gjithashtu pasqyron përmirësimin e pozitës financiare. Në dhjetor 2021, ky raport qëndroi në 94.1 përqind (99.7 përqind në vitin paraprak), duke reflektuar raportin e dëmeve ndaj primeve të fituara neto prej 58.9 përqind dhe raportin e shpenzimeve ndaj primeve të fituara neto prej 35.2 përqind, pa përfshirë të hyrat nga interesat prej investimeve.

Sektori i siguruesve rriti nivelin e likuiditetit krahasuar me gjendjen në fund të vitit të kaluar. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave qëndroi në nivel prej 103.2 përqind (101.3 përqind në vitin 2020), si rezultat i rritjes vjetore më të lartë të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj prej 10.2 përqind, krahasuar me rritjen më të ulët prej 8.2 përqind të rezervave teknike të sektorit të sigurimeve. Kurse, raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve mbeti në nivel të ngjashëm me vitin paraprak, prej 87.3 përqind.

Sa i përket kapitalizimit, sektori i sigurimeve jojetë, në fund të vitit 2021, përveç dy siguruesve ka arritur pajtueshmëri të plotë me kërkesat ligjore në raport me fondin garantues, aftësinë paguese dhe asete të pranueshme në mbulim të provizioneve teknike, duke shënuar një përmirësim të rëndësishëm krahasuar me periudhat e mëhershme. Ky përmirësim nga periudha e njëjtë e vitit paraprak, vjen si rezultat i mos përfshirjes në llogaritje së siguruesit “Kosova e Re” pasi që më datë 24 shtator 2021, Bordi Ekzekutiv i BQK-së ka marrë Vendimin për revokimin e licencës së siguruesit dhe hapjen e procedurave të likuidimit. Rrjedhimisht, kapitali në raport me fondin garantues për siguruesit jojetë rezultoi në 135 përqind mbi normën e pranuar prej 100%, përderisa për siguruesit jetë raporti rezultoi 153.5 përqind. Mbulueshmëria e provizioneve teknike me asete të pranueshme arriti në 109.3 përqind për siguruesit jojetë dhe 115.9 përqind për siguruesit jetë. Megjithatë dy sigurues vazhdojnë të jenë nën kërkesat minimale ligjore për kapital dhe asete të pranueshme në mbulim të provizioneve teknike.”

Tabela 12. Rezultati financiar (në milionë euro)


Përshkrimi	2018	2019	2020	2021
Sigurimet Jojetë	1.0	-5.1	2.0	6.4
Sigurimet Jetë	0.6	0.5	0.3	0.5
Gjithsejtë tregu	1.6	-4.7	2.3	6.9

Burimi: BQK (2021)

6.3. Sektori mikrofinanciar dhe ndihmësit financiar

6.3.1 Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar shënoi përsheptim të rritjes së aktivitetit, si rezultat i rikuperimit të aktivitetit kredidhënës dhe përsheptimit të rritjes së lizingjeve. Rritja e përsheptuar e aktivitetit të sektorit gjatë vitit 2021 reflekton rikuperimin e kërkesës në vend, si rezultat i lehtësimit të restriksioneve ekonomike / sociale për të luftuar pandeminë Covid-19.


Grafik 87. Asetet e sektorit mikrofinanciar


Burimi: BQK.

Asetet e sektorit arritën vlerën prej 340 milionë, që korrespondon me një rritje vjetore prej 7.6 përqind; duke rikuperuar deri në një masë ngadalësimin e rritjes të një viti më parë krahasuar me trendin e rritjes në vitet e fundit (grafik 87). Në tregun vendor operojnë 30 institucione mikrofinanciare,⁶⁸ nga të cilat 13 kanë pronësi të huaj dhe përfaqësojnë 92.1 përqind të gjithsej asetëve të sektorit.

⁶⁸ Këtu përfshihen edhe dhjetë institucione financiare jo-bankare që kryejnë aktivitetet të kredidhënies, lizingut dhe faktoringut. Po ashtu, nëse të dhënat krahasohen me vitet e kaluara mund të vëreni që ka dallim të theksuar në numrin e IMF-ve të raportuara këtë periudhë krahasuar me periudhat paraprake për shkak të ndryshimeve metodologjike. Në numrin e

Indeksi Herfindahl-Hirschman për asetet rezultoi me 1,518 pikë në vitin 2021, që paraqet rritje të lehtë të koncentrimin nga periudha e njëjtë e vitit paraprak (1,487 pikë). Ndërsa, pjesëmarrja e asetëve të tri institucioneve më të mëdha në gjithsej asetet e sektorit u rrit në 56.5 përqind, nga 56.1 përqind sa ishte në vitin 2020, rritje që mund t'i atribuohet deri në një masë revokimit të regjistrimit të dy institucioneve mikrofinanciare në vitin 2019.

Grafik 88. Struktura e asetëve të sektorit mikrofinanciar (dhjetor 2021)


Burimi: BQK.


Kreditë përbëjnë 70.4 përqind të gjithsej asetëve të sektorit. Kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha vazhdojnë të jenë lizingjet, me pjesëmarrje prej 19.3 përqind (grafik 88). Kategoria e bilancit me bankat komerciale ka zvogëluar pjesëmarrjen në gjithsej asetet e sektorit për 5.5 pikë përqindje krahasuar me vitin e kaluar, në 5.4 përqind në fund të dhjetorit 2021. Kjo erdhi si rezultat i rimëkëmbjes së aktivitetit kreditues dhe rritjes së përsheptuar të lizingjeve

IMF-ve përfshihen edhe IFJB me aktivitet të transferit të parave/pagesave/këmbimit, e që kanë ndikuar në rritje të theksuar të numrit të institucioneve financiare në këtë sektor.

krahasuar me vitin e kaluar, pra kishte rialokim të mjeteve drejt investimeve me kthim më të lartë.

Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar financohet kryesisht nga huamarxhet, që përbëjnë 62.1 përqind të gjithsej detyrimeve dhe kapitalit, ndërsa vetëm financimi nga sektori i jashtëm përbën 60.1 përqind të gjithsej detyrimeve dhe kapitalit. Pas rënies vjetore prej 0.4 përqind në vitin 2020, financimi nga sektori i jashtëm u rikuperua dhe shënoi rritje vjetore prej 3.6 përqind në vitin 2021. Mjetet e huazuara nga jashtë u shfrytëzuan për rritjen e aktivitetit kreditor dhe të lizingjeve të sektorit, të cilat shënuan rritje krahas rikuperimit të shpejtë të kërkesës dhe ekonomisë në rrethanat e përmirësimit të gjendjes pandemike.

Grafik 89. Kreditë e sektorëve ekonomik sipas maturitetit




Burimi: BQK.

Gjithsej kreditë e lëshuara nga sektori mikrofinanciar arritën në vlerën prej 239.2 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 17.1 përqind (rënie vjetore prej 7.1 përqind në vitin 2020). Kreditimi si për ekonomitë familjare dhe korporatat jofinanciare shënoi rritje të theksuar në vitin 2021 krahasuar me tkurrjen gjatë vitit paraprak (që ishte si rezultat i pandemisë COVID-19, ashtu edhe revokimit të licencës së dy IMF/IFJB-ve). Kreditimi ndaj ekonomive familjare shënoi rritje për 16.7 përqind (rënie për 9.4 përqind në vitin 2020), duke arritur vlerën në 156.5 milionë euro. Kurse, kreditë ndaj korporatave jofinanciare shënuan rritje vjetore prej 17.8 përqind (rënie për 2.4 përqind në vitin 2020), duke arritur vlerën në 82.7 milionë euro. Sipas afatit të maturimit, kreditë e ekonomive

familjare dhe korporatave jofinanciare me afat maturimi ‘mbi 2 deri në 5 vite’ dominojnë strukturën e këtyre kredive, pasuar nga ato me maturim “mbi 1 deri 2 vite” (grafik 89).

Struktura e kreditimit ndaj korporatave jofinanciare sipas veprimtarive ekonomike mbeti e ngjashme me periudhat paraprake. Kreditimi ndaj sektorit të bujqësisë vazhdon të ketë pjesëmarrje më të madhe në kreditë e lëshuara nga sektori mikrofinanciar, pasuar nga kreditë e destinuar për sektorin e ndërtimitarisë, tregtisë dhe industrisë (grafik 90).


Grafik 90. Struktura e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve ekonomik (dhjetor 2021)



Burimi: BQK.

Aktiviteti kreditues, sipas sektorëve ekonomikë, reflekton trendin e përgjithshëm të kreditimit të korporatave jofinanciare, ku kemi rikuperim të rritjes në të gjithë sektorët pa përjashtim krahasuar me një vit më parë (grafik 91). Kreditimi ndaj sektorit të bujqësisë, tregtisë dhe shërbimeve tjera shënuan rritje më të theksuar, duke rikuperuar tkurrjen që kishte ndodhur në vitin e kaluar.

Grafik 91. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK.

Lizingjet vazhduan trendin e qëndrueshëm të zgjerimit të viteve të fundit, pavarësisht përballjes me krizën e pandeminë Covid-19 (grafik 92).

Në rritjen e lizingjeve, kontributin kryesor e kishin lizingjet për korporatat jofinanciare, përderisa kontributi i lizingjeve për ekonomitë familjare ishte më i limituar. Lizingjet ndaj korporatave jofinanciare kanë një pjesëmarrje prej 59.1 përqind në gjithsej lizingjet. Kjo kategori e lizingjeve shënoi rritje vjetore prej 23.2 përqind dhe arriti vlerën prej 38.7 milionë euro. Sipas maturitetit të lizingjeve për korporatat jofinanciare, pjesa më e madhe dominohet nga lizingjet afatmesme ‘mbi 2 deri në 5 vite’ me pjesëmarrje prej 80.9 përqind, pasuar nga lizingjet me afat maturimi ‘mbi 5 deri në 10 vite’ me pjesëmarrje prej 14.6 përqind.

Kurse, lizingjet ndaj ekonomive familjare, shënuan rritje më të ngadalësuar prej 3.6 përqind, duke arritur në 26.8 milionë euro në fund të vitit 2021. Në kuadër të lizingjeve për ekonomitë familjare, ‘lizingu hipotekar’, që përfaqëson kategorinë dominuese, shënoi rritje vjetore prej 1.0 përqind në vitin 2021 (6.3 përqind rritje vjetore në vitin e kaluar). Kjo kategori e lizingjeve kishte kontributin kryesor në ngadalësimin e lizingjeve ndaj ekonomive familjare, pasi që përfaqësojnë rreth 71.5 përqind të lizingjeve ndaj ekonomive familjare.


Grafik 92. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar



Lizingjet për ekonomitë familjare vazhdojnë të dominohen nga lizingjet afatgjata ‘mbi 10 vite’ të cilat kanë pjesëmarrje prej 53.9 përqind, pasuar nga lizingjet me afat maturimi ‘mbi 5

deri në 10 vite’ me pjesëmarrje prej 29.7 përqind.


Grafik 93. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Mesatarja e normës së interesit për kredi të lëshuara nga sektori mikrofinanciar vazhdoi trendin e rënies graduale të viteve të fundit, duke zbritur në 19.4 përqind nga 20.3 përqind sa ishte në dhjetor 2020 (grafik 93). Me rënie të normës mesatare të interesit në kredi u karakterizuan si sektori i korporatave jofinanciare, ashtu edhe ai i ekonomive familjare.

Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare u zvogëluar në 20.9 përqind në fund të dhjetorit 2021. Ndërsa, mesatarja e interesit në kreditë ndaj korporatave jofinanciare u zvogëluar në 17.4 përqind (grafik 93). Në kuadër të kredive ndaj korporatave jofinanciare, norma mesatare e interesit u zvogëluar për të gjithë sektorët kryesor ekonomik - më e theksuar për sektorin e shërbimeve (grafik 94).

Grafik 94. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik




6.3.2 Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar realizoi fitimin më të lartë vjetor që nga fillimi i operimit të tyre, në vlerë prej 14.1 milionë euro në vitin 2021. Rënia e përshpejtuar e shpenzimeve si dhe rritja e të hyrave të sektorit ka ndikuar në rritje të theksuar të fitimit të realizuar në këtë periudhë (grafik 95).

Të hyrat e sektorit mikrofinanciar arritën vlerën në 48.9 milionë euro, një rritje vjetore prej 6.2 përqind krahasuar me vitin e kaluar. Në kuadër të të hyrave, të hyrat nga interesi, që paraqesin kategorinë dominues të të hyrave (88.9 përqind), shënuan rritje vjetore prej 2.8 përqind (rënie për 20.1 përqind në vitin 2020), si rezultat i rikuperimit të aktivitetit kreditues. Megjithatë, kontributin kryesor në rritjen e gjithsej të hyrave e kishte kategoria e të ardhurave nga jointerеси (11.1 përqind të gjithsej të hyrave). Kjo kategori shënoi rritje për 45.2 përqind (rënie për 19.3 përqind në vitin 2020), kryesisht si rezultat i rritjes së të ardhurave tjera operative.


Grafik 95. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Shpenzimet e sektorit zbritën në vlerën 34.0 milionë euro, e që paraqet rënie vjetore prej 25.2 përqind. Rënia e shpenzimeve erdhi si rezultat i reduktimit të shpenzimeve të jointerесit (rënie për 37.1 përqind në vitin 2021), përkatësisht provizioneve për humbjet e mundshme në kredi, ngjashëm sikur tek sektori bankar. Edhe kategoria e shpenzimeve për interesa shënoi rënie vjetore (prej 8.5 përqind) por që ishte dukshëm më e ulët krahasuar me vitin 2020 (rënie prej 19.1 përqind), pasi që gjatë vitit 2020 kishte rënie

të huazimeve për financim të aktiviteteve të sektorit (kreditim dhe lizingje).

Grafik 96. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit mikrofinanciar u përmirësua dukshëm, duke u zvogëluar për 28.9 pikë përqindje, si rrjedhojë e rritjes së të hyrave në prezencë të rënies së theksuar të shpenzimeve. Në vitin 2021, ky indikator qëndroi në 71.1 përqind (grafik 95).

Rezultatet financiare gjatë vitit 2021 u reflektuan dhe në treguesit tjerë të profitabilitetit të sektorit, të cilat shënuan përmirësim të konsiderueshëm krahasuar me periudhën e kaluar. Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) qëndroi në nivel prej 4.6 përqind (0.2 përqind në vitin 2020), ndërsa Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) në 18.1 përqind (0.9 përqind në vitin 2020) (grafik 96).

Grafik 97. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore



Burimi: BQK.

Sektori mikrofinanciar vazhdon të ketë nivel relativisht të ulët të kredive joperformuese dhe mbulueshmëri të mirë

me provizione (grafik 97). Niveli i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive mbetet i ulët dhe është zvogëluar tutje për 0.6 pikë përqindje, në 2.4 përqind., Niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione në dhjetor 2021 qëndroi në 141.6 përqind (143.0 përqind në vitin 2020).

Sektori i ndihmësve financiarë përbën numrin më të madh të institucioneve financiare në vend, megjithëse menaxhon vetëm 0.3 përqind të gjithsej aseteve. Ky sektor përbëhet nga byrotë e këmbimit dhe agjencionet për transferim të parave (ATP). Vlera e aseteve të ndihmësve financiar në vitin 2021 arriti në 23.8 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 16.5 përqind.

Të hyrat e ndihmësve financiarë shënuan rritje vjetore prej 1.9 përqind dhe arritën vlerën në 10.2 milionë euro në fund të dhjetorit 2021. Struktura e të hyrave të ndihmësve financiarë dominohet nga të hyrat nga transferet (pjesëmarrje 66.7 përqind), të cilat u karakterizuan me rënie vjetore prej 10.7 përqind.

Ndërsa, kategoria e të hyrave tjera shënoi rritje vjetore prej 42.5 përqind në vitin 2021, dhe përfaqësoi rreth 33.3 përqind të gjithsej të hyrave të ndihmësve financiar. Shpenzimet shënuan rritje vjetore prej 21.7 përqind, duke arritur vlerën në 7.0 milionë euro, e që është kryesisht rezultat i rritjes së shpenzimeve të përgjithshme operative. Neto fitimi i realizuar nga këto institucione financiare në vitin 2021 zbriti në 3.2 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 24.4 përqind. Rritja e theksuar në vitin e kaluar e aktivitetit të sektorit dhe fitimeve të realizuara kishte ardhur si rezultat i dërgimit të remitencave përmes këtyre institucioneve financiare, në pamundësi të ardhjes fizike (mbylljes së kufijve tokësor dhe ajror në periudha të caktuara) për shkak të masave që ishin në fuqi për të luftuar pandeminë Covid-19. Kurse, gjatë vitit 2021, largimi i masave kufizuese të lëvizjes si rezultat i rritjes së vaksinimit ndikoi në rritjen e turizmit të diaposrës dhe rrjedhimisht rënien e pjesëmarrjes së remitencave të dërguara përmes ndihmësve financiar.

7. Infrastruktura financiare në Kosovë

7.1. Sistemi i pagesave

Sistemi i pagesave luan rol të rëndësishëm në sistemin financiar dhe ekonominë e një vendi, duke marrë parasysh që funksionimi efikas dhe i sigurt i tij paraqet një faktor shumë të rëndësishëm në ruajtjen dhe promovimin e stabilitetit financiar të vendit. Gjatë vitit 2021, me përmirësimin e gjendjes së pandemisë, e rrjedhimisht rimëkëmbjen e ekonomisë në vend, transaksionet e realizuara përmes sistemit të pagesave të BQK, si në numër ashtu edhe në vlerë, shënuan rritje të theksuar.

Në Kosovë funksionon një sistem i vetëm për pagesa ndërbankare, Sistemi i Pagesave Ndërbankare (SPN), operuar dhe mbikëqyrur nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Gjatë periudhës së pandemisë, sistemi i pagesave, pavarësisht kufizimit të lëvizjes dhe ndryshimit të orareve të punës së pjesëmarrësve, ka qenë vazhdimisht aktiv dhe i qasshëm për pjesëmarrësit, duke siguruar procesimin dhe shlyerjen pa pengesa të të gjitha transaksioneve të qytetarëve, ndërmarrjeve dhe qeverisë. Kjo ka dëshmuar qëndrueshmërinë, sigurinë dhe efikasitetin e sistemit edhe në kushte të operimit nga distanca. Gjithashtu, është dëshmuar se sistemi i pagesave ofron fleksibilitetin e nevojshëm për nevojat specifike të pjesëmarrësve - si rritja e numrit të sesioneve të kliringut dhe bashkëpunimit - për të mundësuar identifikimin dhe adresimin e hershëm të problemeve të mundshme.

Regjistri i Llogarive Bankare, sistem ky i mirëmbajtur nga BQK, në të cilin regjistrohen të gjitha llogaritë bankare nga ana e bankave, gjithashtu është dëshmuar efikas gjatë kësaj

periudhe, duke ndihmuar institucionet në pagesën e lehtë dhe të sigurt të mjeteve në kuadër të masave emergjente fiskale të ndërmarra nga qeveria.

Rimëkëmbja e fuqishme ekonomike në vend gjatë vitit 2021 u reflektua edhe në rritje të konsiderueshme të transaksioneve të realizuara përmes sistemit të pagesave, si në aspekt të numrit ashtu edhe vlerës së tyre. Rritja e numrit dhe vlerës së transaksioneve gjatë vitit 2021 kishte ritëm të përshtypshëm edhe në krahasim me periudhën para pandemike (vitin 2019). Numri i transaksioneve të përpunuara nga SPN në vitin 2021 arriti në 14.6 milionë (13.0 milionë në vitin 2020 dhe 12.4 milionë në vitin 2019), që përbën një rritje vjetore prej 12.9 përqind (4.7 dhe 8.1 përqind në vitin 2020 dhe 2019, respektivisht). Gjithashtu, në të njëjtën periudhë, vlera e gjithsej transaksioneve të realizuara u rrit në 17.1 miliardë euro (14.0 miliardë euro në vitin 2020 dhe 14.1 miliardë euro në vitin 2019), që paraqet një rritje vjetore prej 22.5 përqind (rënie vjetore prej 1.0 përqind në vitin 2020 dhe rritje vjetore prej 9.1 përqind në vitin 2019). Pagesat e rregullta masive dhe pagesat prioritare masive dominuan strukturën e numrit të transaksioneve të realizuara ndërbankare (tabela 13). Pagesat prioritare masive përfaqësojnë rreth 5.9 milionë transaksione të realizuara, kurse pagesat masive të rregullta, përfaqësojnë rreth 5.3 milionë transaksione të realizuara. Sa i përket vlerës së transaksioneve, pagesat prioritare janë kategoria me pjesëmarrjen më të lartë në transaksionet e realizuara, kategori që arriti vlerën 7.25 miliardë euro, pasuar nga kategoria bankë – bankë, që arritën vlerën prej 3.26 miliardë euro deri në fund të vitit 2021. Numri i gjithsej llogarive të vlefshme bankare⁶⁹ në vitin 2021 arriti në 2.38 milionë, që paraqet një rritje vjetore prej 4.0 përqind.

⁶⁹ Numri i gjithsej llogarive bankare përfshinë: numrin e llogarive rrjedhëse, të kursimit dhe të tjera në bankë.

Tabela 13. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SPN-së, në përqindje

Përshkrimi	Numri i gjithsej transaksioneve		Vlera e gjithsej transaksioneve	
	2020	2021	2020	2021
Të rregullta	12.5%	14.3%	10.8%	11.5%
Prioritare	3.4%	4.0%	38.4%	42.3%
Të rregullta - masive (pagesat nga tatimet, taksat, dogana, etj)	32.4%	36.3%	5.3%	5.5%
Prioritare - masive (pagat dhe pensionet nga qeveria)	46.8%	40.2%	11.7%	8.7%
Pagesat xhiro	4.6%	4.9%	7.8%	8.3%
Letrat me vlerë	0.0%	0.0%	5.8%	4.5%
Debitim direkt	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Bankë-bankë	0.0%	0.0%	20.0%	19.0%
Te kthyer	0.2%	0.2%	0.1%	0.1%

Burimi: BQK.

Trendi i shpejtë dhe i sigurt i zhvillimit të infrastrukturës virtuale ka vazhduar, i nxitur edhe nga rrethanat e krijuara nga gjendja pandemike. Bankat kanë rritur përpjekjet e përgjithshme për digjitalizim dhe automatizim të shërbimeve, në funksion të ofrimit të mundësive për realizim të shërbimeve duke ruajtur shëndetin e klientëve. Shumica e bankave kanë rritur limitin e pagesave pa kontakt që mund të bëhet përmes kartelave bankare. Llogaritë bankare E-banking, përmes

të cilave shërbimet bankare kryhen 'online', kanë vazhduar rritjen. Deri në fund të vitit 2021, numri i gjithsej llogarive E-banking arriti në 537.7 mijë⁷⁰ (tabela 14), që paraqet një rritje vjetore prej 30.7 përqind. Struktura e llogarive E-banking vazhdon të dominohet nga llogaritë individuale me pjesëmarrje prej 88.1 përqind të gjithsej llogarive E-banking, pasuar nga ato afariste me pjesëmarrje prej 11.9 përqind.

Tabela 14. Rrjeti i sektorit bankar

Përshkrimi	2017	2018	2019	2020	2021
Numri i degëve bankare	45	46	47	50	43
Numri i nëndegëve bankare	183	166	159	149	145
Numri i ATM-ve	512	491	497	513	516
Numri i POS-ve	11,501	13,183	13,769	13,421	13,836
Numri i llogarive 'e-banking'	301,841	250,733	337,693	411,346	537,733

Burimi: BQK.

Numri i gjithsej kartelave (kartela debiti dhe krediti) që ofrojnë shërbime për tërheqje të parave të gatshme dhe pagesa të ndryshme u rrit për 5.9 përqind. Numri i kartelave me funksion debiti shënoi rritje vjetore prej 6.6 përqind dhe arriti në afër 1.3 milion, kurse me funksion krediti shënoi rritje 0.8 përqind dhe arriti në 176.5 mijë.

Pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të kartelave sipas operatorëve e kishin kartelat

Visa (53.9 përqind) pasuar nga ato Master Card (42.2 përqind), kurse kartelat lokale kishin një pjesëmarrje prej 3.9 përqind. Infrastruktura bankare në vend është zgjeruar në kontekst të rrjetit të numrit të bankomatëve (angl. Automated Teller Machine: ATM) dhe të numrit të paisjeve POS (angl. Point-of-Sale) krahasuar me periudhën paraprake (tabela 14).

⁷⁰ Me hyrjen në fuqi të 'Rregullores për raportimin e statistikave të instrumenteve të pagesave' nga viti 2018 ka ndryshuar edhe metodologjia e raportimit të numrit të llogarive të qasshme (aksessueshme) nga interneti.

Ky numër paraqet numrin e llogarive rrjedhëse që kanë qasje në e-banking, kurse sipas metodologjisë së mëhershme kanë qenë të raportuara të gjitha llogaritë, duke përfshirë llogaritë rrjedhëse, të kursimit dhe të afatizimit.

Tabela 15. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela, në përqindje

Përshkrimi	2017	2018	2019	2020	2021
ATM tërheqje në para të gatshme	61.9%	58.9%	59.5%	62.7%	58.8%
ATM depozitime	29.3%	30.9%	29.9%	27.3%	30.8%
Kredit transference nëpërmjet ATM	0.0%	0.1%	0.1%	0.0%	0.0%
Tërheqje cash në terminale POS	0.2%	0.2%	0.2%	0.1%	0.2%
Pagesa me kartela në terminale POS	8.5%	9.8%	10.3%	9.8%	10.2%

Burimi: BQK.

Numri i depozitimeve në sektorin bankar përmes ATM-ve gjatë kësaj periudhe arriti në 2.3 milionë transaksione në vlerë prej 1.77 miliardë euro. Si rrjedhojë, 30.8 përqind nga gjithsej vlera e transaksionve me kartela përmes terminaleve ishin të ATM-ve me funksion depozitimi (tabela 15).

Në të njëjtën periudhë, numri i pagesave përmes pikave të shitjeve me kartela në терминаlet POS arriti në 18.4 milionë në vlerë prej 590.6 milionë euro. Vlera e pagesave përmes POS ndaj gjithsej transaksioneve me kartela në vitin 2021 kishte një pjesëmarrje prej 10.2 përqind.

8. Korniza për Makroprudencë

Qëllimi parësor i politikës makroprudenciale është të identifikojë, monitoroj dhe vlerësoj rrezikun sistemik të stabilitetit financiar, dhe të ndërmarrë masat që synojnë parandalimin apo reduktimin e rreziqeve sistematike dhe forcimin e qëndrueshmërisë së sistemit financiar ndaj këtyre rreziqeve. Përmes objektivave të ndërmjetëme synohet zbutja e rreziqeve sistematike që mund të shkaktohen nga zhvillimet në indikatorët e caktuar ekonomik.

Në vitin 2016, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-209 mbi Bankën Qendrore i cili mandaton BQK-në për përpilimin dhe implementimin e politikave për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend, ka adaptuar Politikën për Makroprudencë. Në funksion të mandatit makroprudencial, Komiteti Këshilldhënës për Makroprudencë (KKM) ka mbajtur takime të rregullta tremujore ku është raportuar mbi dinamikat e tregut dhe rreziqet ndaj stabilitetit financiar. Në baza të rregullta, ndër tjera, në KKM janë prezantuar rezultatet e dy instrumenteve të kalibruara për qëllime të mbikëqyrjes makroprudenciale që aplikojnë shtesa të kapitalit (anglisht: Capital based Buffers). Për të adresuar dinamikat në kuadër të

Perspektiva e stabilitetit financiar në eurozonë është përkeqësuar me rritjen e inflacionit, veçanërisht që nga fillimi i luftës në Ukrainë. Kjo ka nxitur vendet e eurozonës të jetë më aktive në aplikimin e masave përkatëse makroprudenciale apo aktivizimin e masave të reja përkitazi rreziqeve të rritura. Rreziqet e rritura në shumë dimensione dhe posaqërisht rreziku i rritur ndër vite nga tregu i pasurive të paluejtshme në eurozonë, ka ndikuar që shumë vende të fillojnë shtrëngimin e politikës makroprudenciale përmes rritjes së kërkesave

dimensionit ciklik të rrezikut sistemik, në KKM janë prezantuar rezultatet tremujore të Kapitalit Shtesë Kundërciklik, që kryesisht bazohet në parametrin e hendekut të kreditimit ndaj BPV-së (anglisht: Credit/GDP gap). Gjithashtu, për të adresuar dimensionin strukturor dhe ndër-sektorial të rrezikut, KKM ka analizuar edhe rezultatet tremujore të Kapitalit Shtesë bazuar në vlerësimin e bankave me rëndësi sistematike.

Përderisa ndryshimet përkatëse rregullative që do të adresojnë specifikisht mandatin makroprudencial të BQK-së janë në proces⁷¹, ndryshime që ndër tjera do të përcaktojnë edhe metodologjinë e këtyre instrumenteve dhe potencialisht të ridefinojnë nivelet e shtesave për kapital, instrumentet e kalibruara kanë shërbyer për monitorimin e dinamikave të këtyre rreziqeve dhe indikacionet që kanë dhënë janë prezantuar në nivelet më të larta ekzekutive.

Indikatorët tjerë relevant të paraqitur në tabelën 15 dhe të elaboruar në kuadër të kapitullit të rreziqeve të sektorit bankar në këtë raport, krahas hendekut të kreditimit, plotësohen tutje me informacione kualitative dhe gjykim të ekspertëve relevant, për të formësuar përfundimisht gjykimin për peshën e zhvillimeve specifike në rrezikun e përgjithshëm sistemik.

për shtesa të kapitalit kundërciklik, aktivizimit të shtesave (buffers) të reja të kapitalit bazuar në rrezikun sistemik sektorial (CRD V⁷²) si dhe aplikimin e masave të tjera makroprudenciale si kufizimet në kreditimin e ekonomive familjare⁷³.

Në vitin 2021, dinamikat e përgjithshme në tregues të zgjedhur të makroprudencës u karakterizuan me qëndrueshmëri, duke rezultuar në parametra lartë mbi kërkesat rregullative. Aktiviteti ekonomik në vend u karakterizua me rritje të lartë ekonomike, pas

⁷¹ Draft ligji i ri për banka është në proces të shqyrtimit dhe aprovimit, dhe kjo do të përcaktojë BQK-në si autoritetin e vetëm përgjegjës për mbikëqyrje makroprudenciale dhe ushtrim të mandatit për makroprudencë duke mundësuar njëkohësisht nxjerrjen e instrumenteve rregullative përkitazi me vlerësimet e rreziqeve sistematike.

⁷² Direktiva e 5të mbi kërkesat për kapital (CRD V), direktivë e bartur nën diskrecion të autoriteteve vendore të eurozonës, ka mundësuar aplikimin e

shtesave të kapitalit sipas rreziqeve specifike për vendet përkatëse, e ashtuquajtur shtesa për rrezikun sistemik sektorial.

⁷³ Instrumentet e aplikuar që nga fundviti 2021, nga vendet e eurozonës <https://www.ecb.europa.eu/pub/financial-stability/macprudential-measures/html/index.en.html>.

https://www.ecb.europa.eu/pub/financial-stability/fsr/shared/pdf/measures/Overvie%20measures_notified_to_ECB_April_2022.xlsx?129e7e6b656f325c6455ba0b4f28a06a

Tabela 16. Objektivat, indikatorët vlerësues të rrezikut sistemik dhe instrumentet e politikës makroprudenciale


	OBJEKTIVAT	INDIKATORËT E RREZIQEVE TË PËRCAKTUARA NGA OBJEKTIVAT	INSTRUMENTET MBËSHETËSE
1	Zbutjen dhe parandalimin e rritjes së tepërt të kreditimit dhe të levës	-Ambienti makroekonomik (BPV, Inflacioni) -Kreditimi sipas segmentëve dhe sektorëve ekonomik -Kapitalizimi -Hendeku Kredi/BPV	Masa bazuar në shtesa të kapitalit (capital based measures): 1. Kapitali shtesë kundërciklik (CCyB) 2. Kapitali shtesë sektorial 3. Shtaesa mbi raportin e levës Masat bazuar në huamarrësin (Borrower based measures): 1. Raporti i koleteralizimit të kredisë (Loan-to Value ratio LTV) 2. Raporti i borxhit dhe kështit të borxhit ndaj të hyrave (Debt-to-Income DTI& Debt-service-toIncome DSTI)
2	Të zbusë dhe të parandalojë mospërputhjet e mëdha të afateve të maturimit dhe jo likuiditetit në treg	-Treguesi i Likuiditetit (mjetet likuide ndaj detyrimeve afatëshkurtëra -Raporti Kredi/Depozitë -Rezervat e likuiditetit -Hendeku i likuiditetit	Masa bazuar në kërkesë për likuiditet (Liquidity based measures): 1. Treguesit të Mbulimit me likuiditet (Liquidity-coverage-ratio LCR) 2. Treguesit e Financimit të Qëndrueshëm Neto (Net-stable -funding-ratio NSFR) 3. Përcaktim të raportit kredi-depozitë (restrictions on funding resources) 4. Kufizimet në ekspozime ndaj depozitorëve më të mëdhenjë (large exposure limits)
3	Kufizimi direkt dhe indirekt i koncentrimit të ekspozimeve kreditore	-Koncentrimi i rrezikut kreditor (Ekspozimet e mëdha kreditore); raporti i ekspozimeve të mëdha kreditore ndaj kapitalit të klasit të parë	Masa tjera makroprudenciale (Other measures): 1. Kufizimet në ekspozimet e mëdha kreditore (Large exposure restrictions)
4	Kufizimin në ndikimin sistemik nga iniciativa jo-korrekte në mënyrë që të zvogëlojë rrezikun moral (moral hazard)	-Performanca financiare e bankave -Normat e interesit në kredi dhe depozita -Koncentrimi i Aseteve -Bankat me rëndësi sistematike	Masa bazuar në shtesa të kapitalit (capital based measures): 1. Shtesa për kapital ndaj bankave me rëndësi sistematike (SIFI capital surcharges OSII)

Burimi: Bordi Evropian i Rrezikut Sistemik (European Systemic Risk Board)

tkurrjes ekonomike që shënoi në vitin pandemik. Gjithsesi, përfundimi i fazës së ristrukturimeve, lëvizjet ciklike dhe ndryshimi i dinamikave të rreziqeve të përgjithshme (rritja e vazhdueshme e nivelit të çmimeve në vend dhe ngadalësimi ekonomik në vitin 2022) japin sinjale për akumulim potencial të rrezikut sistemik në muajt në vijim. Përderisa institucionet financiare pritet të vazhdojnë të

mbështesin rimëkëmbjen ekonomike dhe të kenë efekt kundërciklik në këtë fazë, politikat kreditore duhet të jenë të përshtatura drejtuar kredimarrësve ekonomikisht të qëndrueshëm. Hendeku i kreditimit ndaj bruto produktit vendor (anglisht: *credit to GDP gap*), është zvogëluar në vitin 2021, në 0.40 përqind nga 2.47 përqind, si rezultat i rikuperimit ekonomik nga viti pandemik që u shoqërua me

Grafik 98. Kapitali shtesë kundër-ciklik




Burimi: BQK.

tkurrje ekonomike dhe aktivitet të ngadalësuar kredidhënës (Grafik 98).

Në vitin 2021, sektori bankar rezulton të ketë pesë banka me rëndësi sistemike, ngjashëm me vitin paraprak. Kapitali shtesë ndaj bankave me rëndësi sistemike është kalibruar

dhe paraqitur në grafikun 99, bazuar në kornizën Basel III dhe metodologjinë e rekomanduar nga Autoriteti Bankar Evropian (EBA). Megjithatë këto dy metoda dhe instrumente përkatëse makroprudenciale⁷⁴, në mungesë të bazës ligjore, aktualisht përdoren vetëm si indikacion i nivelit të rreziqeve.

Grafik 99. Shkalla e rëndësisë sistemike dhe alokimi i kapitalit shtesë 1




Burimi: BQK.

⁷⁴ Metodologjia e të dy metodave gjendet në verzionet e kaluara të RSF.

9. Shtojca Statistikore


Shtojca 1. Harta e Stabilitetit Financiar - Dinamika e ndryshimit të rrezikut të treguesve dhe kontributi në rrezik nga komponentët përkatës

Figura 1. Ekonoimia e jashtme




Burimi: BQK.

Figura 2. Ekonomia e brendshme




Burimi: BQK.

Figura 3. Ekonomitë familjare




Burimi: BQK.

Figura 4. Ndërmarrjet




Burimi: BQK.

Figura 5. Qeveria




Burimi: BQK.

Figura 6. Struktura e sektorit bankar




Burimi: BQK.

Figura 7. Kapitalizimi dhe profitabiliteti



Burimi: BQK.

Figura 8. Likuiditeti dhe financimi



Burimi: BQK.

Tabela 1. Indikatorët e qëndrueshmërisë financiare, në përqind

Sektori bankar	Grupi bazë i indikatorëve	Dhjetor 2018	Dhjetor 2019	Dhjetor 2020	Dhjetor 2021
Mjaftueshmëria e kapitalit	Kapitali rregullativ ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	17.0	15.9	16.5	15.3
	Kapitali i klasit të parë ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	15.5	14.2	14.7	13.6
	Kreditë jo-performuese neto ndaj kapitalit	1.5	1.5	4.6	3.6
Cilësia e asetëve	Kreditë jo-performuese ndaj totalit të kredive	2.5	1.9	2.5	2.1
Shpërndarja sektoriale e kredive ndaj totalit të kredive	Korporatat tjera financiare	0.2	0.2	0.2	0.3
	Korporatat publike jofinanciare	0.00	0.00	0.00	0.0
	Korporatat tjera jofinanciare	63.4	63.3	63.3	62.3
	Ekonomitë familjare	36.3	36.4	36.4	37.4
	OJSHEF	0.01	0.03	0.03	0.0
	Jo-rezidente	0.0	0.0	0.1	0.0
	Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0
Profitabiliteti	Kthimi në asete (KNA)*	2.3	2.1	1.7	2.2
	Kthimi në kapital (KNK)*	18.3	17.2	14.0	17.6
	Margjina e interesit ndaj të hyrave bruto	78.4	80.6	79.2	76.0
	Shpenzimet e jo-nteresit ndaj të hyrave bruto	48.2	48.1	46.1	45.3
Likuiditeti	Asetet likuide (bazë) ndaj totalit të asetëve	29.0	28.8	30.1	28.9
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj totalit të asetëve	23.8	23.3	23.2	23.7
	Asetet likuide (bazë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	32.2	31.2	31.1	30.6
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	38.5	37.6	39.8	37.4
Senzitiviteti ndaj riskut të tregut	Pozicionet neto të hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit	3.8	4.7	3.5	3.2
	Grupi i zgjeruar i indikatorëve				
	Kapitali ndaj asetëve	12.2	11.2	11.7	11.1
	Ekspozimi kreditor ndaj kapitalit	65.9	81.8	89.5	100.3
	Shpenzimet e personelit ndaj shpenzimeve nga jointerеси	44.0	43.5	43.3	42.8
	Dallimi në mes të normës së interesit për kredi dhe depozita	4.5	4.8	4.7	4.5
	Depozitat e klientëve ndaj totalit të kredive (jo ndërbankare)	122.8	129.2	133.9	130.9
	Detyrimet në valutë të huaj ndaj gjithsej të detyrimeve	5.0	4.4	4.2	4.3



Rruga Garibaldi, Nr.33, Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org